



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA” për periudhën 30.06.2020 deri 31.12.2020, të auditimit të performancës sipas temave:

1. Mbi Ndotjen e Menjëhershme të Jonit dhe Adriatikut.
2. Mbi Efektivitetin e Politikave në Lëvizjen Migratore.
3. Mbi Eficiencën e Energjisë.
4. Mbi Efektivitetin e Procesit të Deinstitutionalizimit dhe Decentralizimit të Shërbimeve Shoqërore me Fokus Fëmijët Jetim.
5. Mbi Efektivitetin e koordinimit ndërinstitutional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në bashkimin evropian, për periudhën 2016-2019.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Prot. nr. 754/5, datë 05.07.2021, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në 2020” dhe në Udhëzimin të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”, të ushtruar në subjektet:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
2. Ministria e Brendshme;
3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
6. Instituti Statistikave;
7. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
8. Agjencia për Eficiencën e Energjisë,
9. Drejtoria e Përgjithshme Detare;
10. Shërbimi Social Shtetëror;
11. Bashkia Vlorë;
12. Bashkia Shkodër.

Auditimi u krye nga:

E. K (Përgjegjës grupi)
S. J
I. H
E. K
E. K.
M.L.
A.Gj

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

Periudha e auditimit: për auditimet e evaduara në periudhën 30.06.2020-31.12.2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Nr.	PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TEMAVE TË AUDITUARA PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE	Faqe
1	Përmbledhje ekzekutive	3-3
2	Mbi Ndotjen e Menjëhershme të Jonit dhe Adriatikut	4-24
3	Mbi Efektivitetin e Politikave në Lëvizjen Migratore	25-44
4	Mbi Eficencën e Energjisë.	45-61
5	Mbi Efektivitetin e Procesit të Deinstitutionalizimit dhe Decentralizimit të Shërbimeve Shoqërore me Fokus Fëmijët Jetim.	62-76
6	Mbi Efektivitetin e koordinimit ndërinstitucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për periudhën 2016-2019.	77-111
7	Anekset	112-116



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve më temë “Mbi Ndotjen e Menjëhershme të Jonit dhe Adriatikut në Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme Detare; me temë “*Mbi Efektivitetin e Politikave në Lëvizjen Migratore*” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme dhe Institutin Statistikave; me temë “*Mbi Eficiencën e Energjisë*” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë për Eficiencën e Energjisë; me temë “*Mbi Efektivitetin e Procesit të Deinstitutionalizimit dhe Decentralizimit të Shërbimeve Shoqërore me Fokus Fëmijët Jetim*” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe me temë “*Mbi Efektivitetin e koordinimit ndërinstitucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për periudhën 2016-2019*” në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Shkodër, rezultoi që nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e auditimit të KLSH.

Nga auditimi tematik “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH, për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2020, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutin Statistikave, Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencinë për Eficiencën e Energjisë, Drejtorinë e Përgjithshme Detare; Shërbimin Social Shtetëror; Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Shkodër, paraqitet si vijon:

Në 12 subjekte të audituara, nga KLSH, janë rekomanduar gjithsej **146** masa për përmirësim ligjor dhe organizativ, nga të cilat janë pranuar **142** masa ose **97.26 %** dhe nuk janë pranuar **4** masa ose **2.74 %**. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **34** prej tyre ose **24.94%**, janë zbatuar pjesërisht **16** ose **11.27%**, janë në proces zbatimi **52** masa ose **36.62%**, dhe nuk janë zbatuar **40** masa ose **28.17%**.

Analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara rezultoi se:

- a. Janë rekomanduar gjithsej **4 masa për përmirësim ligjor**, nga të cilat 2 masa ose 50% janë në proces zbatimi dhe 2 masa ose 50% nuk janë zbatuar.
- b. Janë rekomanduar **142 masa organizative** nga të cilat janë pranuar 138 masa ose 97.18% dhe nuk janë pranuar 4 masa ose 2.82%. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 34 prej tyre ose 24.64%, janë zbatuar pjesërisht 16 masa prej tyre ose 11.59%, janë në proces zbatimi 50 masa ose 36.23%, dhe nuk janë zbatuar 38 masa ose 27.54%.

Në përfundim, grupi i auditimit konkludoi se veprimtaria e 12 subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.

Të analizuar dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

I. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “NDOTJA E MENJËHERSHME E JONIT DHE ADRIATIKUT”

PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Durrës mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2020” për auditimin e kryer në vitin 2020, për periudhën 2017-2019 për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën e KLSH-së me nr. 754 prot, datë 05.07.2021 dhe Program Auditimi nr. 754/5 Prot, datë 05.07.2021, (administruar në AKMC me nr. nr. 1482/1 prot, datë 06.07.2021 dhe DPD me Nr. 13/4prot, datë 08.07.2021), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezultojnë se:

I. Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditë për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), ka kthyer përgjigje në KLSH, nëpërmjet shkresës Nr. 1357/1 prot., datë 17.11.2020, duke respektuar afatin 20 ditë. Po kështu rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD), ka kthyer përgjigje në KLSH, nëpërmjet shkresës Nr. 13/3 prot., datë 21.12.2020, në shkelje të afatit 20 ditë.

II. Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 muaj për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se AKMC dhe DPD nuk e kanë përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit në KLSH, në mospërputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. 10/13 prot, datë 30.10.2020 dhe Drejtorinë e Përgjithshme Detare me nr. 10/14 prot, datë 30.10.2020, nga KLSH-it janë rekomanduar gjithsej **9 masa** me karakter organizative.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH .

Sipas afatit 20 ditë nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezultojnë se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	9	8	1

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 754, datë 05.07.2021

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 754/5, prot., datë 05.07.2021 dhe njoftimit “Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve” nr. 754 prot., datë 05.07.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. E. K (Përgjegjës grupi)

2. S. J anëtare

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 10/13 prot, datë 30.10.2021 (AKMC) dhe me shkresën nr. 10/14 prot, datë 30.10.2021 (DPD), së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar AKMC dhe DPD në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 10/13 prot, datë 30.10.2020 (AKMC) dhe me shkresën nr. 10/14 prot, datë 30.10.2020 (DPD), rezulton se nga **9** masa të rekomanduara (*masa organizative*), janë pranuar nga subjekti në masën **8** masa ose **89 %** dhe **nuk është pranuar 1 masë ose 11%**.

Nga 8 masat e pranuar është zbatuar plotësisht **1** masë ose 12.50 % e tyre, janë në proces zbatimi **5** masa ose 62.50 % dhe janë pa zbatuar **2** masa ose 25.00 %. Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 12.50 %, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa Organizative	8	1	-	5	2

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është **13.50 %**, vlerësohet se rekomandimet e zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi zënë peshën me të madhe të rekomandimeve të lëna, por në vetvete ato përmbajnë shume nënpika dhe respektimi i afateve për secilën prej tyre nga subjekti i audituar në shume raste nuk varet vetëm nga vendimmarrja e drejtimit, por dhe nga miratimi në strukturat të tjera sipas shkallës së hierarkisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi nr. 1: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të koordinojë dhe bashkërendojë punën për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe rifreskimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, përfshirja në to e mbrojtjes së mjedisit në tërësi dhe ruajtjes së mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotjet e menjëhershme duke përcaktuar politikat dhe objektivat e zvogëlimit të risqeve nga fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë e për t’u rimëkëmbur.

Afati: Menjëherë

AKMC: Subjekti bashkëpunon strukturat përkatëse me Ministrinë e Mbrojtjes për hartimin dhe miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë” dhe “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. Kjo mbështet në shkresën me nr. 1088/2 prot., datë 14.10.2020 të AKMC-së për propozim të akteve për vitin 2021 dhe lista me aktet që propozohen bashkëlidhur kësaj shkrese, është miratuar Urdhëri i Kryeministrit me nr. 57, date 29.06.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”, e cila përcakton grupin ndërinstytucional të punës për hartimin e projektit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut (SKZRF), i cili ka përgjegjësi që të sigurojë se projekti SKZRF të përcaktojë bazat e politikave, të aktiviteteve të institucioneve dhe strukturave qendrore e vendore, të hartojë planin e punës për realizimin e SKZRF-se, të monitorojë punën e grupit teknik ndërinstytucional të punës dhe të dorëzojë SKZRF në MM deri në datën 15.11.2021. Në grupin ndërinstytucional AKMC mbulon rolin e Sekretariatit Teknik. Afati i miratimit sipas ligjit është deri në datën 15.11.2021, rrethanë që kushtëzon rishikimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile pas miratimit të SKZRF.

AKMC, me shkresën nr. 1088/2 prot, date 14.10.2020, ka dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë propozim për miratim të projekt akteve të vitit 2021 në fushën e mbrojtjes, projekt vendim nr Këshillit të Ministrave, “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”, në zbatim të nenit 10 pika 1 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, për miratimin në 4-mujori 2-te 2021 si dhe projekt vendim nr Këshillit të Ministrave, për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, në zbatim të nenit 14 pika 1 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” për miratimin në 4-mujorin e 2-te të vitit 2021. Dërgimi për miratim të SKZRF dhe PKEC, deri në miratimin e tyre akteve nënligjore vlerësohet konsiderohet me status nr proces zbatimi.

Rekomandimi lidhur me ruajtjen e mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotjet e menjëhershme, nuk mund të zbatohet nga subjekti, pasi bazuar VKM-në nr. 480, datë 25.7.2012 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave “Për reagimin ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë”, AKMC (ish -DPEC) nuk ngarkon me përgjegjësi këtë institucion për kontrollin dhe zbatimin e këtij plani kombëtar.

Statusi: Në proces

Rekomandimi nr. 2: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa në: (sipas nënparagrafave 2.1 -2.14)

Afati: Menjëherë e në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

2.1 Në përgatitjen e plotësimit me akte nënligjore të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre për planifikimin dhe përballimin emergjencave civile;

AKMC: Subjekti ka vijuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes/Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të përgatitjes së projekt programit të projekt akteve të vitit 2021, në zbatim edhe të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” duke propozuar listën me aktet që do të përgatiten gjatë vitit 2021. Nga ana e AKMC janë përgatitur të gjitha draftet fillestare të projekt akteve dhe janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes/Ministria e Mbrojtjes për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Kjo bazuar në praktikën shkresore: 1. Shkresa nr. 1088/2 prot., date 14.10.2020 e AKMC-së për propozim të akteve për vitin 2021 dhe 2. Lista me aktet që propozohen, e cila është së bashku me shkresën. Rekomandimi konsiderohet deri në miratimin e akteve të propozuara nga subjekti.

Statusi: Në proces

2.2 Në krijimin e drejtorive kryesore me sektorët përkatës, plotësimit me punonjës të agjencisë dhe krijimit të drejtorive rajonale;

AKMC: Subjekti në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Mbrojtjes ka vijuar procesin e rekrutimit për plotësimin e strukturës edhe në Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve me sektorët përkatës. Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve është përfshirë në dhënien e kontributeve në projekte të ndryshme nga BE, si dhe me organizata që aktivitetin e tyre e kanë në vendin tonë, të tilla si:

1. Programi PRONEWS “Parandalimi/Gatishmëria ndaj Përmbajtjeve dhe Menaxhimi i Fatkeqësive”. Ky projekt ka filluar më 11.01.2017 dhe pritet të mbarojë më 10.8.2021.
2. Projekti FIRE PREP në kuadrin e IPA CBC Greqi-Shqipëri: Periudha e zbatimit të këtij projekti është 2020-2022.
3. Projekti TO BE READY në kuadrin e IPA CBC Itali-Mali i Zi-Shqipëri. Data e fillimit 09/2019 – data e mbarimit 06/2022.
4. Projekti IPA FF “Mbështetje e BE-së për Parandalimin e Përmbajtjeve dhe Menaxhimin e Riskut nga Zjarret në Pyje në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – IPAFF”, i cili ka filluar në dhjetor 2020.
5. Projekti në bashkëpunim me World Vision “Ndërtimi i reziliencës dhe aftësive për Reduktimin e Riskut ndaj Fatkeqësive”, me qëllim zhvillimin e aktiviteteve në shkolla të ndryshme të vendit dhe trajnimin e stafit pedagogjik.

Mbështetur në PRO NEWS, Kontrata; FIRE PREP; Urdhri për ngritjen e grupit të punës; Memo për TO BE READY; Marrëveshje partneriteti; Letra mbi fillimin e projektit IPA FF dhe Memo për Projektin në bashkëpunim me World Vision, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

2.3 Të mundësojë koordinimin dhe dhënien e kontributeve në implementimin e suksesshëm të programeve dhe projekteve të ndryshme në fushën e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile.

AKMC në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Mbrojtjes ka vijuar procesin e rekrutimit për plotësimin e strukturës edhe në Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve me sektorët përkatës. Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

dhe Projekteve është përfshirë në dhënien e kontributeve në projekte të ndryshme nga BE, si dhe me organizata që aktivitetin e tyre e kanë në vendin tonë, të tilla si Programi PRONEWS “Parandalimi/Gatishmëria ndaj Përmbajtjeve dhe Menaxhimi i Fatkeqësive”, Projekti FIRE PREP në kuadrin e IPA CBC Greqi-Shqipëri, Projekti TO BE READY në kuadrin e IPA CBC Itali-Mali i Zi-Shqipëri, Projekti IPA FF “Mbështetje e BE-së për Parandalimin e Përmbajtjeve dhe Menaxhimin e Riskut nga Zjarret në Pyje në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – IPAFF”, Projekti në bashkëpunim me World Vision “Ndërtimi i reziliencës dhe aftësive për Reduktimin e Riskut ndaj Fatkeqësive”.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

2.4 Të mundësojë forcimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të institucioneve qendrore dhe vendore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe sigurisë së jetës së qytetarëve;

Në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 45/2019 ka qenë kontribuuese kryesore për hartimin e VKM-së nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile. Ky vendim ka fuqi detyruese për institucionet qendrore dhe vendore si për ngritjen dhe funksionimin e sektorëve për mbrojtjen civile dhe detyrimin për kapacitetet e parashikuara për emergjencë dhe angazhimin e tyre për çdo rast të ndodhjes së një fatkeqësie.

AKMC, nëpërmjet programeve të ndryshme ku ajo është përfutuese, sidomos në përfitimin e kapaciteteve në mjete dhe atyre teknike, të paralajmërimit të hershëm, bën shpërndarjen e tyre, sikurse dhe angazhimin e personelit të këtyre institucioneve në trajnime në fushën e mbrojtjes civile,

Në kuadër të projektit FIRE PREP, në kuadrin e IPA CBC Greqi-Shqipëri është parashikuar blerja e mjeteve, si dhe program trajnimi për forcat operationale zjarrfikëse në komponentë “Blerje automjetesh për shuarjen e zjarreve për terren urban dhe në pyje (4x4)” dhe “Program i përbashkët trajnimi mbi luftën ndaj zjarreve në pyje” për trajnimin e 25 zjarrfikësve të qarkut Vlorë, Berat, Korçë dhe Gjirokastër, në strukturat e Shërbimit Zjarrfikës Grek.

Në kuadër të projektit IPA FF, në komponentin 2 është parashikuar përmirësimi i parandalimit, gatishmëria dhe kapacitetet për t’iu përgjigjur zjarreve në pyje në nivelin qendror, rajonal dhe më gjerë. Pra kuadri ligjor është miratuar dhe nga AKMC mbetet detyrë zbatimi i tij

Statusi: Rekomandimi zbatuar

2.5 Të mundësojë forcimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe vendet e rajonit e më gjerë për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes civile dhe ndihmën e ndërsjellët në raste fatkeqësish;

AKMC: Subjekti ka një sërë marrëveshesh dhe memorandume bashkëpunimi si me vende të rajonit dhe më gjerë, ashtu dhe me organizata brenda vendit. Në AKMC është krijuar dhe sektori i bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili ka në fokus edhe bashkëpunimin me vende të tjera të rajonit për çështje të mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Aktualisht është në proces marrëveshja në fushën e emergjencave civile me Slloveninë, si dhe po zbatohen marrëveshjet e nënshkruara kur ka qenë e nevojshme.

Me organizmat brenda vendit është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Marin Barleti dhe memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi me Aeroportin e Kukësit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Aktualisht, AKMC është përfutuese në projektin RESPONSEE “Ushtrim në terren”, financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i këtij projekti/ushtrimi është të testohet gatishmëria e sistemit të mbrojtjes civile për tërmetet, Mbështetja e Vendit Pritës/HNS (Host National Suport), bashkëpunimi midis vendeve të Evropës Juglindore me ERCC, si dhe bashkëpunimi midis qeverive të këtyre shteteve, organeve të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara.

Në datat 6-7 korrik 2021 u zhvillua stërvitja online me pjesëmarrjen e institucioneve shqiptare, fusha e përgjegjësisë së tyre lidhet me çështje të emergjencave civile.

Dokumentacioni mbështetës korrespondenca (me mail) me autoritetet sllovene për negocimin e marrëveshjes në fushën e emergjencave civile, korrespondence me drejtorinë e Marrëveshjeve në MM për marrëveshjen me Slloveninë, Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Marin Barleti, Memorandum mirëkuptimi e bashkëpunimi me Aeroportin e Kukësit, Memo për Stërvitjen, nr. 437 Prot, datë 22.2.2021, Memo për Ministrin e Mbrojtjes për Stërvitjen, nr. 1192 Prot, datë 28.5.2021.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

2.6 Të mundësojë rishikimin e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki;

AKMC: Referuar nenit 23.3 të ligjit 45/2019 “Për emergjencat civile” AKMC-ja ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Referuar nenit 23 pika germa “a”, ajo zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, dhe në këtë përgjegjësi duhet të ushtroje funksionet e saj edhe në drejtim të rishikimit të planeve të emergjencave në 12 qarqet e vendit. Sa me sipër nga AKMC nuk është ushtruar funksioni mbikëqyrës dhe kontrollues në qarqet e vendit mbi rishikimin e planeve të emergjencave sipas rekomandimit të tone.

Statusi: Rekomandimi pazbatuar

2.7 Të mundësojë hartimin e hartave të rrezikut dhe hartave shumë të rrezikshme të riskut;

AKMC: Subjekti është pjesëmarrës në projektin “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmblytjet në Ballkanin Perëndimor”, i cili drejtohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) me mbështetjen e GIZ. Ajo ka kontribuar në dhënien e mendimit gjatë procesit të krijimit të Hartave të Rrezikut dhe Riskut nga përmblytjet për Basenin e Lumit Drin dhe udhëzuesit. Në takimet e grupit të punës të zhvilluara online, përfaqësuesit e AKMC-së kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe kontribuues gjithashtu. Deri në miratimin e Hartave të Riskut rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Statusi: Rekomandimi proces zbatimi

2.8 Të mundësojë bashkërendimin e punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;

Bazuar ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” ministritë kryejnë vlerësimin e humbjeve nga fatkeqësitë, sipas fushës së përgjegjësisë; bashkitë kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre. AKMC me kërkesën e institucioneve të ndryshme, delegon kërkesat për vlerësim dëmi tek institucione të specializuara, të tilla si Instituti Ndërtimit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. AKMC bashkëpunon me bashkitë dhe institucione të tjera qendrore për financimin dhe ndërhyrje në infrastrukturën e dëmtuar, ose



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

në parandalimin e fatkeqësive të pritshme. Sektori i Buxhetit dhe Financës, bazuar në ligjin 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, si dhe dispozitave ligjore në fuqi ka realizuar ndjekjen e transferimit të fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për dëmshpërblimin financiar në disa bashki të vendit për vitin 2020 miratuar nga Ministria e Financës me shkresën Nr. 23021/1 Prot. datë 02.12.2020, shkresa Nr. 7847 prot., datë 24.12.2019 drejtuar Institutit të Ndërtimit, shkresa Nr. 847 prot., datë 10.2.2020.

Bazuar në nenin 30 germa “gj” bashkitë kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre. Por shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie, (neni 41, ligji 45/2019). Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 % të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja, bazuar në VKM për këtë qellim. AKMC planifikon fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, kriteret dhe procedurat e akordimit të të cilave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 23 germa “d”).

Pra qëllimi i rekomandimit nuk është vetëm vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, por bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve për vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, me qëllim dëmshpërblim jo vetëm në vlerë por edhe në kohë.

Statusi: Rekomandimi në proces zbatimi

2.9 Në organizimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile;

AKMC: Për rregullimin e mënyrës së të dhënave nga pushteti vendor, bashkitë, prefekturat, ministratë e linjës, subjektet private është përgatitur drafti fillestar i VKM-së “Për krijimin dhe mënyrën e administrimit të bazës së të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë”, i cili është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes/Ministria e Mbrojtjes për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Kjo VKM finalizon marrjen e të dhënave nga fatkeqësitë të përqendruara në të gjithë territorin e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit të marrjes së të dhënave.

Bashkëngjitur:

AKMC nuk ka plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve për strukturën e posaçme “Sektori i bazës së të dhënave”. Ministratë dhe institucionet qendrore (AKMC) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësisë së tyre, të cilën e mirëmbajnë, e përditësojnë, si dhe shkëmbejnë informacione me AKMC-në; (Neni 22.2 germa “ç” ligji 45/2019). Marrja e të dhënave nga fatkeqësitë në të gjithë territorin e vendit tonë kërkon ngritjen e sistemit të marrjes së të dhënave. Përgatitja e projekt vendimit për nxjerrjen e VKM-së “Për krijimin dhe mënyrën e administrimit të bazës së të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë”, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes/Ministria e Mbrojtjes për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, pasqyron vullnetin tuaj për rregullimin e kuadrit ligjor të fushës së veprimit të autoritetit tuaj. Deri në miratimin e aktit nënligjor nga KM rekomandimi do të konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Rekomandimi në proces zbatimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

2.10 Në përpunimin dhe ndjekjen e programeve të edukimit publik dhe të trajnimit të strukturave, shtetërore dhe jo shtetërore në fushën e mbrojtjes civile ;

AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe më pas kjo e fundit me Departamentin e Administratës Publike (DAP) ka vijuar procesin e rekrutimit për plotësimin e strukturës organike në nivel qendror dhe vendor, përfshirë dhe Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, AKMC ka punuar dhe për trajnimin e personelit të rekrutuar nëpërmjet sektorëve përkatës të AKMC-së.

AKMC në procesin e ristrukturimit të saj në muajin qershor 2020 ka kryer trajnime, fillimisht për punonjësit me kontratë të cilët u punësuan në AKMC. Për këtë arsye u hartua dokumentacioni i nevojshëm, të tilla si, memo për Drejtorin e Përgjithshëm të AKMC-së “Mbi zhvillimin e seancave mësimore për punonjësit me kontratë”, “Programi mbi zhvillimin e seancave mësimore”, si dhe shkresa për vënien në dispozicion nga ana e drejtorive të tjera të Ministrisë së Mbrojtjes të sallës ku do të zhvillohej trajnimi. Me rastin e datës 13 tetor, si Dita Ndërkombëtare e Zvogëlimit të Riskut ndaj Fatkeqësive, AKMC në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, zhvilloi aktivitete në të gjitha prefekturat e vendit me qëllim sensibilizimin e publikut për njohjen dhe marrjen e masave mbrojtëse për rreziqet. AKMC u ka kërkuar informacion institucioneve qendrore dhe vendore lidhur me trajnimet e kryera dhe aktivitetet sensibilizuese në fushën e mbrojtjes civile.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

2.11 Në kontrollin e mënyrës përdorimit të burimeve materiale dhe financiare që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore për rastet e emergjencave civile, për organet qendrore dhe vendore.

Procesi i monitorimit të buxhetit të vitit 2020 dhe 2021 është finalizuar me shkresat Nr. 295 Prot., datë 29.05.2020 “Monitorimi i shpenzimeve të programit “Emergjencat Civile” për 4-mujorin e parë 2020”; Nr. 1058/1 Prot., datë 30.09.2020 “Monitorimi i shpenzimeve të programit “Emergjencat Civile” për 4-mujorin e dytë 2020”; Nr. 331 Prot., datë 11.02.2021 “Dërgim informacioni” bashkëlidhur raporti i monitorimit të shpenzimeve të programit “Emergjencat Civile” për 12-mujorin viti 2020 dhe shkresës Nr. 1175/1 datë 27.05.2021 “Monitorimi i shpenzimeve të programit “Emergjencat Civile” për 4-mujorin e parë 2021”. Megjithë dokumentacionet të paraqitur nga AKMC, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pa zbatuar, pasi sipas rekomandimit të lënë nuk u paraqit raportim mbi mënyrën kontrollit të përdorimit të fondeve dhe burimeve materiale nga buxheti i shtetit për emergjencat civile.

Statusi: Rekomandimi zbatuar pjesërisht.

2.12 Në udhëzimin e strukturave përgjegjëse për mënyrën e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të opinionit publik për emergjencat civile dhe mbrojtjen nga zjarri;

AKMC në mënyrë periodike kërkon nga prefekturat dhe bashkitë marrjen e masave për emergjencat e pritshme dimërore dhe zjarreve në pyje. Megjithëse ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi opinionit publik do të jete në vazhdimësi, bazuar në shkresën Nr. 787/1 Prot., datë 6.4.2021 “Për marrjen e masave për përballimin e emergjencave verore dhe informim”, drejtuar prefektit, e-mail drejtuar prefektëve për informacion mbi gjendjen e digave, shkresa me nr. 388 prot., datë 16.6.2020 “Plani i përbashkët i inspektimit”, rekomandimi është zbatuar plotësisht

Statusi: Rekomandimi zbatuar plotësisht



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

2.13 Në kontrollin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile, pranë subjekteve shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit;

AKMC, në dokumentacionin bashkëngjitur paraqet praktikën e ndjekur për një rast dëmtimi rruge në aksin Elbasan – Gramsh, në të cilin, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka ndërhyrë për marrjen e masave. Subjekti ka paraqitur Memo në lidhje me marrjen e masave, e-mail prefektëve për gjendjen e digave si dhe Memo për verifikim banesash.

Nga informacioni i grumbulluar nuk rezulton që AKMC të ketë kryer kontrollin mbi zbatimin e dispozitave të ligjit 45/2019, për të verifikuar zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese, në mospërputhje me nenin 67 pika 2 germa “a” të këtij ligji.

Statusi: Rekomandimi pa zbatuar

2.14 Në kontrollin e mënyrës përdorimit të burimeve, materiale e financiare, që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave civile, për organet, qendrore dhe vendore;

a. Në kontrollin e shpërndarjes dhe mënyrës përdorimit të mallrave rezervë emergjente;

AKMC: Nga subjekti nuk u paraqiten inspektime/ raporte mbi shpërndarjen dhe përdorimin e mallrave rezerve emergjencë.

Statusi: Rekomandimi pa zbatuar

b. Në hartimin e rregullores brendshme të AKMC-së;

AKMC në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ka hartuar rregulloren “Për metodat e brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel qendror dhe vendor”. Kjo rregullore është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 881, datë 25.6.2021

Statusi: Rekomandimi zbatuar

c. Të paraqitjes së planeve të emergjencave dhe mbrojtjes civile nga institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor.

AKMC: Nga dokumentacioni bashkëngjitur nuk rezulton të jene paraqitur plane të emergjencave civile nga të gjitha ministrinë, prefekturat dhe bashkitë.

Statusi: Rekomandimi pa zbatuar

Rekomandimi nr. 2 : Statusi në proces (trajtuar në pikat 2.1-2.14)

Rekomandimi nr. 3: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të mundësojë pozicionimin e saj në mbrojtje të mjedisit e veçanërisht mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotjet e menjëhershme në kuadër të bashkëpunimit me ministrinë e institucionet e varësisë tyre dhe prefekturat.

Afati :Menjëherë

AKMC: Ky rekomandim nuk pranohet nga subjekti, pasi dokumentet strategjike si dhe legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit detar, i kanë të përcaktuara fushat e zbatimit të tyre. AKMC ka përgjegjësitë e saj ligjore për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi por jo të mjedisit detar fushe e cila rregullohet nga Konventat Ndërkombëtare, Kodi Detar dhe legjislacion kombëtar për mjedisin detar.

Statusi: Rekomandimi nuk pranohet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 4: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për ndryshimin e fushave të përgjegjësisë në lidhje me emergjencat dhe mbrojtjen civile sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë ministrinë sipas emërtimeve të reja.

Afati: Menjëherë

Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përkatësisht, neni 22 dhe neni 72, parashikon ngritjen e sektorëve për mbrojtjen civile në çdo ministri. Nga AKMC është miratuar urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e drafteve fillestare të projektvendimeve të Këshillit të Ministrave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2020”.

Grupi i punës ka hartuar projektvendimit “Për përbërjen dhe detyrat e sektorëve të mbrojtjes civile në ministrinë e linjës”, si dhe e ka përcjellë atë për procedurë të mëtejshme në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes. *Rekomandimi është në fazë projekt vendimi dhe deri në miratim do të konsiderohet në proces zbatimi.*

Statusi: Rekomandimi në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 5: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për krijimin e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë.

Afati : Menjëherë

Ligji 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, nenin 25, përcakton se në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile, nën drejtimin e AKMC-së, krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (KTK), i cili këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive. VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”, dale në zbatim te nenit 25 të Ligjit 45/2019 përcakton se nën drejtimin e AKMC në MM krijohet dhe funksionon KTK i cili kryesohet drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në zbatim të këtij vendimi, në mbledhjet e thirrura (në rast se ka) prej Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, në cilësinë e drejtuesit të KTK , përfaqësuesve të ministrive, strukturave të varësisë dhe institucioneve, duhet t’ju ishte kërkuar ngritja dhe funksionimi i strukturave të sistemit të mbrojtjes civile pavarësisht se ato përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit (neni 20.4 e Ligjit 45/2019).

Për sa komentuam arsyetojmë se rekomandimi nuk është zbatuar

Statusi: Rekomandimi pa zbatuar

Rekomandimi nr. 6: Drejtoria e Përgjithshme e Detare në bashkëpunim me Portet Shëngjin, Durrës, Vlorë e Sarandë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe QNOD-në të mundësojnë:

Afati :Menjëherë e në vazhdimësi

6.1 Krijimin e një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare;

Referuar VKM 480/2012 pika 2.1, në bazë të Planit Kombëtar të Emergjencave Detare (për tre shkallët), QNOD ka për detyrë të sigurojë veprime të shpejta, për të marrë nën kontroll dhe ndaluar përhapjen e karburanteve dhe substancave të rrezikshme kimike në det.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjithashtu, bazuar Kreun IV, pika 2.d.ii, VKM 954 datë 30.09.2009 “Për Organizimin, Strukturën, Funkcionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det”, përcaktohet se QNOD drejton operacionet për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja. Në këtë akt nënligjor përcaktohet se institucionet e përfshira në QNOD bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, për një kontribut maksimal në përmbushje të misionit të qendrës, që nënkupton se bashkëveprimi përfshin edhe ndërveprimin tuaj për krijimin e një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare, pavarësisht nënshkrimit të kontratës së bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Sigurisë Detare (EMSA) lidhur me përdorimin e sistemit evropian satelitor “CleanSeaNet”, që shërben për zbulimin e anijeve që bëjnë ndotje nga hidrokarburet dhe ofron ndihmë për shtetet pjesëmarrëse lidhur me identifikimi dhe gjurmimi i ndotjes së naftës në sipërfaqen e detit, monitorimi i ndotjes aksidentale gjatë emergjencave si dhe kontribuon në identifikimin e ndotësve.

Gjithashtu, DPD në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe me financim të Bankës Botërore ka filluar projektin për instalimin dhe implementimin e sistemit VTMS (Vessel Traffic Monitoring & Information Service). Ky sistem do të mundësojë përfundimisht monitorimin e të gjitha lëvizjeve të mjeteve detare në hapësirën detare shqiptare dhe do të mundësojë parandalimin në kohë të incidenteve dhe aksidenteve në det. Ky do të jetë një sistem që do të përdoret nga personeli i DPD (Kapitaneritë e Porteve). Ka përfunduar faza e studimit të fizibilitetit dhe procesi është në fazën e prokurimit.

Pavarësisht sistemeve të sipërcituara njeri ndërkombëtar (evropian) dhe tjetri kombëtar, krijimi i një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare mbetet një alternative për tu vlerësuar nga organet kompetente, në rast se këto dy sisteme janë të pamjaftueshme për të minimizuar rrezikun e ndotjes së ujërave territoriale shqiptare, arsye për të cilën dhe statusi i këtij rekomandimi nga pa zbatuar bëhet në proces.

Statusi: Rekomandimi në proces

6.2 Sigurimin e veprimeve të shpejta dhe në kohën e duhur, për të marrë nën kontroll dhe ndaluar rrjedhjet e karburanteve dhe substancave të rrezikshme;

Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe kapitaneritë përkatëse të portit duhet të sigurojnë që të gjitha anijet që futen në detin territorial të Republikës së Shqipërisë, ujërat e brendshëm, porte, terminale, instalimet detare, siç kërkohet nga rregulloret e Organizatës Ndërkombëtare Detare, të kenë një plan emergjence ndaj ndotjes detare në bord (SOPEP). Referuar në VKM Nr. 480, datë 25.07.2012, pika 2.28. Kjo bën që të gjitha anijet me flamur të huaj apo shqiptar që përpunohen në portet e RSH dhe që janë inspektuar nga KSHF apo KSHP kanë rezultuar se janë të pajisura me planin e emergjencës ndaj ndotjes detare në bord (SOPEP).

Drejtoria e Përgjithshme Detare ka në strukturën e saj sektorët përgjegjës për monitorimin e trafikut të mjeteve detare për hyrje-dalje në porte dhe për inspektimin dhe verifikimin e gjendjes teknike të mjeteve detare. Ky funksion **kryhet** nga Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual për anijet me flamur të huaj, nga Sektori i Kontrollit Shtetëror të Flamurit për anijet me flamur shqiptar.

Në rast se konstatohet ndotja e detit dhe anija hyn në portet shqiptare inspektohet dhe verifikohet nga strukturat e sipërpërmendura, ku roli i DPD është inspektim dhe verifikim në vend, pra e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

drejta e veprimeve te shpejta për DPD-ne është e kufizuar deri ne port dhe rad . Me tej është kompetence e strukturave te tjera reaguese (Roja Bregdetare, etj)

Por përgjegjësinë kryesore është e QNOD-së sipas VKM 480/2012, paragrafi 2.5, 5.7 dhe 5.8, si edhe seksionin 16, për përgatitjen dhe zbatimin e planit ne nivel kombëtar, si dhe të gjitha aktivitetet në lidhje me përgatitjen për reagimin ndaj ndotjes detare të shkaktuar nga karburanti ose substancave të rrezikshme dhe helmuese në rast emergjence.

Statusi: Rekomandimi zbatuar.

6.3 Krijimin e mundësisë për prezencë me shërbim 24-orë me mjete, në të gjithë hapësirën detare shqiptare, si formë alternative për zbulimin e ndotjeve në kohë reale;

DPD: Sistemi i ri VTMS për monitorimin e trafikut detar ne ujerat territoriale shqiptare i cili është ne procedure implementimi dhe zbatimi, si dhe sistemi Shërbimi CleanSeaNet nëpërmjet imazheve satelitore Synthetic Aperture Radar (SAR), sigurojnë monitorimin 24 ore te ujerat territoriale shqiptare. Implementimi i sistemit te ri do te realizoje përfundimisht monitorimin e te gjitha lëvizjeve te mjeteve detare ne ujerat territoriale 12 milje duke siguruar shërbim 24-orë duke mundësuar parandalimin ne kohe te incidenteve dhe aksidenteve dhe grumbullimin ne kohe te informacioneve për mallrat qe transportohen me anije.

Statusi: Rekomandimi ne proces

6.4 Marrjen e masave administrative ndaj të gjitha subjekteve që shkelin ligjin e ndotjeve detare;

DPD, ne rast te konstatimit te kundërvajtjeve administrative nuk i referohet Ligjit 10109/2009 por referohet Kodit Detar, Pjesa e tete, Kreu II, neni 389 (Sanksionet) i cili përcakton sanksione për hedhjen e mbeturinave dhe ndotjen. Megjithëse ne raste te rralla (2018-2020 janë vendosur 5 gjoba), kur është konstatuar kundërvajtje administrative, kjo dispozite dispozitë ka gjetur zbatim nga Kapitaneria e Portit strukture varësie e DPD.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

6.5 Krijimin e laboratorëve sipas standardeve evropiane për të zbuluar shkaktarët e ndotjes;

VKM Nr. 480, datë 25.07.2012, shprehimisht përcaktohet:- “Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mban listën e laboratorëve të autorizuar për marrjen e mostrave dhe analizën e lëndëve të dëmshme e të rrezikshme. Ngritja e laboratorëve është detyre funksionale e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar pranë QNOD-se dhe jo e DPD-re.

Statusi: Rekomandimi pazbatuar

6.6 Shtimin dhe rinovimin e mjete lundruese që përdoren për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja e për të shkuar në vendin e ndotjes;

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se nga DPD ka në dispozicion vetëm dy mjete detare dhe ka parashikuar që të pajiset edhe me dy mjete të tjera detare, sipas PBA 2022-2024, për vitin buxhetor 2022 është programuar blerje dy motos kaf për Kapitanerinë e Portit Vlore dhe Sarande

Statusi: Rekomandimi në proces zbatimi

6.7 Vendosjen e përhershme të Koordinatorit Kombëtar të Mjedisit me prani të përditshme në QNOD, për ndjekjen e gjithë problematikave që lidhen me ndotjet detare;

QNOD-ja, referuar VKM 480/2012, pika 2.30, ushtron kontrollin e saj në incidentet e shkalles 3 nëpërmjet Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar, i cili do të jetë përfaqësuesi i ministrit së përgjegjëse për mjedisin pranë QNOD-së. Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar është përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm gjitha rastet e incidenteve potenciale me ndotje detare që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

kanë origjinë nga anijet apo instalimet det kërkojnë një reagim kombëtar. Koordinator i Përgjithshëm Kombëtar është personi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për aktivizimin e reagimit kombëtar duke përfshirë aktivizimin e këtij plani

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Koordinator i Përgjithshëm Kombëtar do të jetë përfaqësuesi i Ministrisë Përgjegjëse për Mjedisin pranë QNOD-së, pra nuk është përgjegjësi e DPD-re si strukture e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithsesi, vendosja e përhershme të Koordinatorit Kombëtar të Mjedisit me prani të përditshme në QNOD, për ndjekjen e gjithë problematikave që lidhen me ndotjet detare mbetet një rekomandim për tu zbatuar nga strukturat kompetente.

Statusi: Rekomandimi pazbatuar

6.8 Përmirësimin e mënyrës koordinimit me strukturat përkatëse të reagimit në momentet e aksidenteve apo katastrofave me ndotje detare;

Koordinimi i Strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme Detare me strukturat e tjera pranë QNOD bëhet nëpërmjet stafit të përhershëm 24ore/7ditë që DPD ka pranë QNOD, pra koordinimi institucional është i përditshëm dhe i vazhdueshëm, dhe nuk ka pengesa në funksionimin e tyre.

Në praktikë nuk ka ndodhur mos koordinim me strukturat përkatëse të reagimit në momentet kur është sinjalizuar për ndotje detare (p.sh rasti i datës 15.06.2021 kur u dyshua për ndotje në gjirin e Durrësit, dhe sipas dokumentacionit të paraqitur rezultoi koordinim dhe bashkëveprim në kohe midis strukturave)

Statusi: Rekomandimi zbatuar

6.9 Identifikimin e zonave me rrezikshmëri të lartë të aksidenteve me ndotje detare;

Është në kompetencë të QNOD-së përgatitja e një vlerësimi të detajuar të rrezikut në nivel rajonal dhe të përfshihet në planin rajonal të emergjencës.(pika 9.2 VKM 480/2012).

Roli i DPD-se në këtë proces është vetëm përcaktimi i kritereve të nevojshme dhe të domosdoshme për përcaktimin dhe nominimin e vendeve të strehimit. Me shkresën Nr. 1596 Prot, datë 31.08.2020 referuar VKM 480/2012, pika 12.2 DPD-re ka përcaktuar kriteret e vendstrehimeve, të cilat duhet të bashkëngjiten planit të Aneksit 24 të kësaj VKM-je.

Bashkëlidhur është përcjellë “Udhëzuesi për përcaktimin e vendstrehimit të anijeve në raste fatkeqësish”, i nxjerre nga DPD-re, udhëzues i nxjerre në bazë të Rezolutës A949(23) të Organizatës Ndërkombëtare Detare IMO si dhe praktikave më të mira të shteteve të tjera.

Mbetet detyrë e QNOD-se vlerësimi i kritereve dhe bashkëngjitja në planit të Aneksit 24 e cila nuk është reflektuar në VKM 480/2012 për të marrë fuqi juridike.

Për sa më sipër rekomandimi 6.9 është pranuar dhe konsiderohet në proces zbatimi deri në momentin e përfshirjes së kritereve të nevojshme të vendstrehimeve në VKM 480/2012

Statusi: Rekomandimi në proces zbatimi

6.10 Sigurimin dhe shtimin e ekzistencës paraprake të llojeve të përshtatshme të veglave/pajisjeve që do të përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme;

Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk e ka detyrim të zotërojë këto vegla/pajisje pasi ajo nuk ka rol reagues ndaj ndotjeve detare por, vetëm rol monitorues. Por në inspektimet që ky autoritet kryen në anijet detare, i kushtohet vëmendje e veçantë ekzistencës së Planit të Emergjencës së Anijes (SOPEK) dhe pajisjeve reaguese sipas planit të emergjencës të miratuara, si dokumentacion dhe pajisje detyrueshme në çdo anije.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Statusi: Rekomandimi zbatuar

6.11 *Rritjen e fondeve buxhetore me qëllim të:*

a. *blerjes dhe përmirësimit shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të specializuara për reagimin ndaj ndotjes;*

Drejtoria e Përgjithshme Detare, deri në këtë moment të auditimit nuk ka mjete të specializuara për reagimin ndaj ndotjes detare, arsye për të cilën nuk planifikon fonde buxhetore për blerjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

b. Sigurimit të mbështetjes logjistike të skuadrës së menaxhimit të incidentit;

VKM 480/2012, pika 16.1 përcakton se financimi i përgatitjes dhe kryerjes së aktiviteteve të reagimit në zbatim të planit të emergjencës do të planifikohet brenda buxhetit të miratuar për ministrinë, institucionet buxhetore, shërbimet kombëtare që marrin pjesë në QNOD, si edhe i pushtetit lokal që merr pjesë në këto operacione. Pra DPD nuk ka rol reagues por vetëm rol monitorues, për pasojë nuk planifikon fonde buxhetore të mbështetjes logjistike.

Për sa më sipër rekomandimi 6.10.b mbetet i pa zbatueshëm nga DPD

Statusi: Rekomandimi nuk pranohet

c. *Planifikimit të shpenzimeve në lidhje me marrjen e masave reaguese, kur ndotësi nuk është identifikuar apo nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet e reagimit;*

Si u shpreh edhe më lart, DPD nuk ka rol reagues por vetëm rol monitorues, për pasojë nuk planifikon fonde buxhetore të shpenzimeve në lidhje me marrjen e masave reaguese kur ndotësi nuk është identifikuar apo nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet e reagimit;

Statusi: Rekomandimi nuk pranohet

6.12 *Trajnimit të personelit që merr pjesë direkt në reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në mënyrë të vazhdueshme si dhe hartimin e planeve, metodikave dhe kurikulave të përditësuara për trajnim;*

Stafi DPD trajnohet nga EMSA në kuadër të ngritjes profesionale të punonjësve të cilët kanë detyrë funksionale inspektimin e anijeve, sipas metodikave dhe kurikulave të përditësuara për trajnim.

Pjesa e personelit të DPD pranë e QNOD-se i ushtrohet trajnimeve të planifikuara nga kjo struktura, sipas hartimit të planeve, metodikave dhe kurikulave të përditësuara për trajnim nga struktura përkatëse e këtij institucioni.

Për sa më sipër rekomandimi 6.12 mbetet i pa zbatueshëm pasi veprimet reaguese nuk janë detyrë funksionale nga DPD

Statusi: Rekomandimi nuk pranohet

6.13 *Kryerjen e ushtrimeve për reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave detare nga ndotjet detare me naftë apo substanca të rrezikshme.*

Si më sipër rekomandimi 6.13 mbetet i pa zbatueshëm pasi veprimet reaguese nuk janë detyrë funksionale nga DPD

Statusi: Rekomandimi nuk pranohet

Rekomandimi nr. 6: Statusi në proces (trajtuar nga 6.1 deri 6.13)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 7: Drejtoria e Përgjithshme e Detare të kryejë më shumë verifikime dhe kontrole në porte, instalime e pajisje datare që përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në kuadër të mbrojtjes së mjedisit detar.

Afati : **Menjëherë**

DPD: Pajisjet detare që përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në kuadër të mbrojtjes së mjedisit detar, normalisht posedojnë të gjithë ato subjekte që në aktivitetin e tyre u kërkohet një plan reagimi ndaj ndotjes. Sipas përcaktimit ligjor, të gjithë këto subjekte kanë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare kopje të planit të reagimit, të aprovuara nga Drejtori i QNOD-së pas konsultimeve me Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Ne zbatim të vendimit nr. 1104, date 28.12.2015 “*Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në det*”, Drejtoria e Përgjithshme Detare ka ngritur grupin e punës me qëllim verifikimin e instalimeve marrëse portuale të operatorit privat “xxxx”, mbi të cilin përgatit raporte përkatës me gjetje dhe rekomandime. Ky kontroll me grupe pune të DPD do të shtrihet edhe në operatore të tjerë (privat) që ushtrojnë veprimtari në grumbullimin e mbetjeve vajore dhe të ngurta në të gjitha portet e tjera të RSH, referuar shkresës nr. 988/2 prot, date 30.04.2021 dërguar në MIE dhe MTM, mbi verifikimin e kapaciteteve të instalimeve marrëse portuale të operatorit “xxxx”.

Ne zbatim të detyrave funksionale të DPD dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH, procesi i kontrollit të dorëzimit të mbetjeve vajore dhe të ngurta do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Pra procesi është në vijimësi.

Statusi: Rekomandimi zbatuar

Rekomandimi nr. 8: Drejtoria e Përgjithshme e Detare në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrinë e Mbrojtjes, QNOD-në, të mundësojë miratimin e reagimit të kombinuar ndaj ndotjeve detare jo vetëm me mjete detare por edhe me mjete ajrore të destinuara për zbulimin dhe eliminimin e ndotjeve vajore.

Afati : **Menjëherë e në vazhdimësi**

DPD referuar rekomandimit të grupit të auditimit, nuk e ka kompetencë të saj planifikimin e mjeteve të nevojshme lundruese apo dhe ajrore, por ka të drejtën të kërkojë pranë QNOD-së përmirësimin në numër dhe lloje të mjeteve ekzistuese bazuar në eksperiencat më të mira të vendeve fqinje, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që kryen DPD.

Për të vlerësuar situatën reale në raste ndotjesh detare një mjet efikas që parashikohet edhe në VKM 4802012, si dhe në praktikatat e mira (Malin e Zi), është e nevojshme mbikëqyrja me mjete avion/ helikopter.

DPD në observacionet e saj, ka sjelle dokumentacion të ri, me shkresën nr. 1359 prot, datë 21.07.2021, bashkëlidhur observacionit të saj me numër 1360/1 prot, datë 26.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 754/8 prot, datë 28.07.2021, me të cilën ka kërkuar në QNOD mundësimin e krijimit të një flote ajrore me avionë të specializuar dhe të përshtatshëm jo vetëm për zbulimin e ndotjes detare por edhe pastrimin e saj. Kjo shkresë e ndryshon statusin e rekomandimit të lënë nga pa zbatuar në proces zbatimi.

Statusi: Rekomandimi në proces



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 9: Prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier dhe Vlorë të bashkëpunojnë me AKMC, QNOD-në, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë e Mbrojtjes së Bregdetit, dhe Ministrinë e Brendshme, për të:

- 9.1 Mundësuar Rishqyrtimin e Planeve të Emergjencave për Mbrojtjen Civile dhe Planin e Emergjencave për Reagim ndaj ndotjeve detare;
- 9.2 Krijuar bazë të dhënash lidhur me ndotjen detare dhe mënyrat e ndërhyrjes në këto raste;
- 9.3 Përmirësuar strukturën e Mbrojtjes Civile në shkallë qarku;
- 9.4 Plotësuar dhe shtuar personelin me specialistë të fushës që trajtojnë emergjencat dhe mbrojtjen civile dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme mbrojtjen civile;
- 9.5 Marrë masa konkrete në pajisjen me mjetet e nevojshme për përballje të parë me rastet emergjente dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme;
- 9.6 Rritur fondet buxhetore për eliminimin e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme si në fazën e parë të situatës emergjente e deri në eliminimin e saj;
- 9.7 Përmirësuar dhe rritur numrin e trajnimeve të strukturave të mbrojtjes civile në shkallë qarku;
- 9.8 Marrë masa konkrete për shmangien e ndotjes së detit nga mbetjet urbane, ujërat e përdorura (zeza), nafta dhe nënproduktet e saj, mbetje të rrezikshme, etj., si rezultat i prurjes tyre nga ujërat e lumenjve;
- 9.9 Përmirësuar kushtet e punës në funksion të veprimtarisë tyre si:
 - a. Zyrë ose zyrë/sallë operationale, për marrjen, përpunimin dhe dërgimin e informacioneve, si dhe drejtimin e operationeve në rastet e situatave emergjente;
 - b. Pajisjet elektronike institucionale për komunikim, informim dhe përcjellje të situatave në kohë reale në të gjitha shkallët, qendrore e lokale;
 - c. Mjete transporti për ndjekjen e situatës në terren dhe dhënien e ndihmës në vendngjarje;
 - d. Uniformë të posaçme, dalluese për personelin e emergjencave dhe vullnetarët.

Afati : **Menjëherë e në vazhdimësi**

Nga AKMC nuk u paraqit dokumentacion mbi bashkëpunim ndërinstitutional, lidhur me rekomandimin e dhënë, i cili përshin shume prefektura dhe institucione. Referuar pikës 4, të VKM nr. 1020/2020 “Për Përbërjen, Funkcionimin dhe Detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për Zvogëlimin e Riskut ndaj Fatkeqësive”, **Komisioni Teknik Këshillimor** nën drejtimin e AKMC, ka përgjegjësi: a) të shqyrtojë strategjitë, politikat, programet dhe planet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit; b) të shqyrtojë dhe të rekomandojë për çështjet që lidhen me programet e edukimit/arsimit për strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe publikun e gjerë në fushën e mbrojtjes civile; c) të shqyrtojë dhe të analizojë planet për emergjencat civile, të përgatitura nga institucionet shtetërore e joshtetërore, dhe të japë rekomandimet përkatëse, sipas rastit; ç) të ndihmojë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes civile, vënien në efikasitet të plotë të tij, përcaktimin e prioriteteve, si dhe identifikimin e nevojave; d) të kontribuojë në rrugët e zgjidhjes për masat parandaluese, të rehabilitimit dhe të rimëkëmbjes për lloje të ndryshme fatkeqësish natyrore ose fatkeqësi të tjera; dh) të shqyrtojë ose të vlerësojë studime në fushën e mbrojtjes civile.

Mos bashkëveprimi institucional nuk na jep të dhëna mbi zbatimin e këtij rekomandimi

Statusi: Rekomandimi pa zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

1. Subjekti i Audituar AKMC paraqiti observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 754/12, datës 04.08.2021 duke observuar si me poshtë:

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 2.6 për rishikim e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki duke sqaruar se në kushtet aktual prefekturat kanë plane për emergjencë civile, por ato nuk janë rishikuar për arsye të mungesës së strategjive të DRR, dokumentet e vlerësimit të rrezikut nga katastrofat dhe Planit Kombëtar, që janë në proces hartimi, të cilat së fundmi janë duke u ndjekur nga AKMC me qëllim prodhimin e dokumenteve standard që do të përdoren në procesin e inspektimit, përfshirë dhe funksionin mbikëqyrës dhe kontrollues në qarqet e vendit mbi shqyrtimin e planeve të emergjencave.

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 2.11 mbi mosparaqitjen e raportimit mbi mënyrën e kontrollit të përdorimit të fondeve dhe burimeve materiale nga buxheti mbi emergjencat civile. AKMC nuk ka marrë në dorëzim mallra rezerve emergjente, pasi kjo kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave materiale të Shtetit.

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 2.13, mbi mos kontrollin nga AKMC të zbatimit të ligjit 45/2019, nën 67.2.a, për verifikimin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, duke sqaruar se inspektimi është një ndër përgjegjësitë funksionale të institucionit. Nga AKMC janë ushtruar kontrole por jo inspektime për faktin se kanë munguar formate të miratuara të proces verbaleve të inspektimit, dokumenteve standarde të cilat janë prodhuar së fundmi nga AKMC dhe mungesa e personelit përkatës, arsye që nuk është zbatuar ky rekomandim.

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 2.14.a, mbi kontrollin e shpërndarjes dhe mënyrës së përdorimit të mallrave rezervë emergjente, duke sqaruar se AKMC nuk ka marrë në dorëzim mallra rezervë emergjente. Ajo bashkërendon dhe koordinon punën me DPRMSH-në për ndërhyrje në mënyrë operative me mallra të emergjencës në raste fatkeqësish.

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 5, midis të tjerash ka sqaruese me shkresën nr. 1319/2 prot, datë 12.11.2020 ka dërguar për miratim projekt vendimin “Mbi përbërjen dhe detyrat e sektorit të mbrojtjes civile në ministrinë e linjës”, në zbatim në ligjit nr. 45/2019, nën 22 dhe nën 72. AKMC dhe Ministria e Mbrojtjes nuk detyron ngritjen e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie, por ministrinë janë të detyruara të ngrenë ato sipas ligjit dhe VKM-ve përkatëse. VKM 923/2020 ka trajtuar përgjegjësitë shtetërore të institucionit/ ministrive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore, nëpërmjet sektorit për mbrojtjen civile

➤ Në lidhje me rekomandimin nr. 9 qëndrimi subjektit është i njëjtë me rekomandimin nr. 2.6.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së sqaron se:

-lidhur me rekomandimin nr. 2.6 dhe rekomandimin nr. 9, AKMC ka detyrë të të mundësojë rishikimin e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki, referuar nenit 23.3 të ligjit 45/2019 “Për emergjencat civile” AKMC-ja ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Referuar nenit 23 pika germa “a”, ajo zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, dhe në këtë përgjegjësi duhet të ushtrojë funksionet e saj edhe në drejtim të rishikimit të planeve të emergjencave në 12 qarqet e vendit. Sa me sipër nga AKMC nuk është ushtruar funksioni mbikëqyrës dhe kontrollues në qarqet e vendit mbi rishikimin e planeve të emergjencave sipas rekomandimit tone, arsye për të cilën observacioni nuk pranohet.

-në lidhje me rekomandimin nr. 2.11, në kontrollin e mënyrës së përdorimit të burimeve materiale dhe financiare që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore për rastet e emergjencave civile, për organet qendrore dhe vendore. Bazuar në shkresat e dërguara me email dt 13.07.2021, cituar dhe në material, rezulton se procesi i monitorimit të buxhetit 2020 dhe 2021 konsiderohet i finalizuar nga subjekti. Por me gjithë dokumentacionin e paraqitur nga AKMC, ky



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pa zbatuar, pasi sipas rekomandimit të lënë nuk u paraqit raportim mbi mënyrën kontrollit të përdorimit të fondeve dhe burimeve materiale nga buxheti i shtetit për emergjencat civile, kjo sipas kërkesave të nenit 23.3 të ligjit 45/2019 “Për emergjencat civile”, arsye për të cilën observacioni nuk pranohet

-në lidhje me rekomandimin nr. 2.13, nga auditimi nuk rezultoi se AKMC të ketë kryer kontrollin mbi zbatimin e dispozitave të ligjit 45/2019, për të verifikuar zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese, në mospërputhje me nenin 67 pika 2 germa “a” të këtij ligji. Por grupi auditimit vlerëson hapat e ndërmarrja lidhur me miratimin dhe prodhimin e formateve të proces verbaleve të inspektimit dhe dokumenteve standarde nga AKMC, por deri përdorimin e tyre në kontrollin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile, pranë subjekteve shtetërore dhe private, statusi i rekomandimit nuk ndryshon, arsye që observacioni nuk pranohet.

- në lidhje me rekomandimin nr. 2.14.a, lidhur me kontrollin e shpërndarjes dhe mënyrës përdorimit të mallrave rezervë emergjente sqarojmë se AKMC nuk u paraqitën inspektime/ raporte mbi shpërndarjen dhe përdorimin e mallrave rezerve emergjencë. Referuar nenit 23.3 të ligjit 45/2019 “Për emergjencat civile” AKMC-ja ushtron kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki, autoritet që nuk është ushtruar nga kjo agjenci, arsye që observacioni nuk pranohet.

- në lidhje me rekomandimin nr. 5, rezultoi se AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes nuk ka marrë masa për krijimin e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë. Arsyetimi juaj se AKMC dhe Ministria e Mbrojtjes nuk detyron ngritjen e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie, por ministritë janë të detyruara të ngrenë ato sipas ligjit dhe VKM-ve përkatëse qëndron, por AKMC është lider në këtë proces që buron nga Ligji 45/2019, dhe akteve nënligjore dale në zbatim të tyre, dhe trajtuar në raport, fakt që nuk sjell argument të ri, dhe arsye që observacioni nuk pranohet.

IV KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare konstatohet se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), ka kthyer duke respektuar afatin 20 ditor, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD), ka kthyer përgjigje në shkelje të afatit 20 ditor.

Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecures së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se AKMC dhe DPD, nuk e kanë përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit në KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar AKMC dhe DPD në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 10/13 prot, datë 30.10.2020 (AKMC) dhe me shkresën nr. 10/14 prot, datë 30.10.2020 (DPD), rezultoi se nga **9 masa** të rekomanduara (masa organizative), janë pranuar nga subjekti **8 masa** ose 89 % dhe nuk është pranuar **1 masë** ose 11%.

Nga 8 masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 masë ose 12.50 % e tyre, janë në proces zbatimi 5 masa ose 62.50 % dhe janë pa zbatuar 2 masa ose 25.00 %. Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 12.50 %, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-se, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar ose e zbatuar pjesërisht. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

A. MASA ORGANIZATIVE:

Gjetje nr. 2: AKMC, me shkresën nr. 1088/2 prot, date 14.10.2020, ka dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë propozim për miratim të projekt akteve të vitit 2021 në fushën e mbrojtjes, projekt vendim në Këshillit të Ministrave, “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”, në zbatim të nenit 10 pika 1 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, për miratimin në 4-mujori 2-te 2021 si dhe projekt vendim në Këshillit të Ministrave, për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, në zbatim të nenit 14 pika 1 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” për miratimin në 4-mujorin e 2-te të vitit 2021. Dërgimi për miratim të SKZRF dhe PKEC, deri në miratimin e tyre akteve nënligjore vlerësohet konsiderohet me status në proces zbatimi.

Rekomandimi nr. 2: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të koordinojë dhe bashkërendojë punën për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe rifreskimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile,

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr. 3: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes nuk ka mundur rishikimin e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki; nuk ka mundur hartimin e hartave të rrezikut dhe hartave shumë të rrezikshme të riskut, nuk ka bashkërenduar plotësisht punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, të dërgojë për miratim në KM projekt vendimin për nxjerrjen e aktit nënligjor për krijimin dhe mënyrën e administrimit të bazës së të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë, nuk u paraqit raportim mbi mënyrën kontrollit të përdorimit të fondeve dhe burimeve materiale nga buxheti i shtetit për emergjencat civile, nuk rezultoi i verifikuar zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese, nuk ka kontroll mbi mënyrën e përdorimit të burimeve, materiale e financiare, për rastet e emergjencave civile,

Rekomandimi nr. 3: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të mundësojë rishikimin e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki, të mundësojë hartimin e hartave të rrezikut dhe hartave shumë të rrezikshme të riskut, të mundësojë bashkërendimin e punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, të mundësojë organizimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile duke siguruar miratimin e kuadrit rregullator, të jetë efikas në mënyrën e përdorimit të fondeve dhe burimeve materiale nga buxheti i shtetit për emergjencat civile, në kontrollin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile, pranë subjekteve shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit, të rrisë kontrollin mbi mënyrën e përdorimit të burimeve, materiale e financiare, për rastet e emergjencave civile, për organet, qendrore dhe vendore

Afati: Menjëherë e në vazhdimësi

Gjetje nr. 4: Nga AKMC është miratuar Urdhri nr. 86, datë 29.10.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e drafteve fillestare të projektvendimeve të Këshillit të Ministrave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2020”. Grupi i punës ka hartuar projektvendimit “Për përbërjen dhe detyrat e sektorëve të mbrojtjes civile në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

ministritë e linjës”, si dhe e ka përcjellë atë për procedurë të mëtejshme në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes

Rekomandimi nr. 4: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për ndryshimin e fushave të përgjegjësisë në lidhje me emergjencat dhe mbrojtjen civile sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë ministritë sipas emërtimeve të reja.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr. 5: VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”, dale në zbatim të nenit 25 të Ligjit 45/2019 përcakton se nën drejtimin e AKMC në MM krijohet dhe funksionon KTK i cili kryesohet drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Në zbatim të këtij vendimi, ende nuk është siguruar ngritja dhe funksionimi i strukturave të sistemit të mbrojtjes civile pavarësisht se ato përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, sipas nenit 20.4 e Ligjit 45/2019).

Rekomandimi nr. 5: AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për krijimin e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë.

Afati : Menjëherë

Gjetje nr. 6: Pavarësisht përdorimit të sistemit “CleanSeaNet” dhe implementimit të sistemit VTMS, njeri ndërkombëtar (evropian) dhe tjetri kombëtar, krijimi i një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare mbetet një alternative për tu vlerësuar nga organet kompetente, në rast se këto dy sisteme janë të pamjaftueshme për të minimizuar rrezikun e ndotjes së ujërave territoriale shqiptare, me qellim sigurim/monitorim 24 ore të zbulimit të ndotjes në kohë reale në ujërat territoriale shqiptare. Nga strukturat kompetente nuk janë marrë masa krijimin e laboratorëve sipas standardeve evropiane për të zbuluar shkaktarët e ndotjes. Nuk janë marrë masa për shtimin dhe rinovimin e mjete lundruese që përdoren për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja e për të shkuar në vendin e ndotjes. Nuk është vendosur në QNOD, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar. Megjithëse ky funksion nuk është atribut i drejtpërdrejtë i DPD, mungesa e tij mund të sjellë pengesa në nivel kombëtar, pasi ai është personi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për aktivizimin e reagimit kombëtar duke përfshirë aktivizimin e këtij plani në rast ndotje detare. Nga DPD janë hartuar dhe dërguar në QNOD kriteret e nevojshme dhe te domosdoshme për përcaktimin dhe nominimin e vendeve të strehimit, por nga kjo e fundit nuk është bërë vlerësimi dhe dërgimi për miratim në KM.

Rekomandimi nr. 6: Drejtoria e Përgjithshme Detare në bashkëpunim me QNOD të vlerësojnë krijimin e një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare. DPD të bashkërendojë punën me Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar pranë QNOD-se, për krijimin e laboratorëve sipas standardeve evropiane për të zbuluar shkaktarët e ndotjes, për shtimin dhe rinovimin e mjete lundruese që përdoren për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja e për të shkuar në vendin e ndotjes, të kërkojë vendosjen e përhershme të Koordinatorit Kombëtar të Mjedisit me prani të përditshme në QNOD për ndjekjen e gjithë problematikave që lidhen me ndotjet detare.

DPD të bashkëpunojë me QNOD për identifikimin e zonave me rrezikshmëri të lartë të aksidenteve me ndotje detare, për trajnimin e personelit që merr pjesë direkt në reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në mënyrë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

vazhdueshme si dhe hartimin e planeve, metodikave dhe kurikulave të përditësuara për trajnim, për kryerjen e ushtrimeve për reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave detare,

Afati: Menjëherë e në vazhdimësi

Gjetje nr. 7: DPD nuk e ka kompetencë të saj planifikimin e mjeteve të nevojshme lundruese apo dhe ajrore, por ka të drejtën të kërkojë pranë QNOD-së përmirësimin në numër dhe lloje të mjeteve ekzistuese bazuar në eksperiencat më të mira të vendeve fqinje, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që kryen DPD. Për te vlerësuar situatën reale ne raste ndotjesh detare një mjet efikas që parashikohet edhe në VKM 4802012, si dhe në praktikën e mira (Malin e Zi), është e nevojshme mbikëqyrja me mjete avion/ helikopter. DPD në observacionet e saj, ka sjelle dokumentacion të ri, me shkresën nr. 1359 prot, datë 21.07.2021, bashkëlidhur observacionit të saj me numër 1360/1 prot, datë 26.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 754/8 prot, datë 28.07.2021, me të cilën ka kërkuar në QNOD mundësimin e krijimit të një flote ajrore me avionë të specializuar dhe të përshtatshëm jo vetëm për zbulimin e ndotjes detare por edhe pastrimin e saj. Kjo shkresë e ndryshon statusin e rekomandimit të lënë nga pa zbatuar në proces zbatimi.

Rekomandimi nr. 7: Drejtoria e Përgjithshme e Detare në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrinë e Mbrojtjes, QNOD-në, të mundësojë miratimin e reagimit të kombinuar ndaj ndotjeve detare jo vetëm me mjete detare por edhe me mjete ajrore të destinuara për zbulimin dhe eliminimin e ndotjeve vajore.

Afati : Menjëherë e në vazhdimësi

Gjetje nr. 8: Nga AKMC nuk u paraqit bashkëveprim institucional lidhur me zbatimin e rekomandimit ndërmjet prefekturave Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier dhe Vlorë dhe AKMC, QNOD-në, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë e Mbrojtjes së Bregdetit, dhe Ministrinë e Brendshme, për të Rishqyrtimin e Planeve të Emergjencave për Mbrojtjen Civile dhe Planin e Emergjencave për Reagim ndaj ndotjeve detare, për të krijuar bazë të dhënash lidhur me ndotjen detare dhe mënyrat e ndërhyrjes, për të përmirësuar strukturën e mbrojtjes civile në shkallë qarku, për të shtuar personelin me specialistë të fushës, për masa konkrete në pajisjen me mjetet e nevojshme për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme, për të rritur fondet buxhetore për eliminimin e ndotjes detit, për të rritur numrin e trajnimeve të strukturave të mbrojtjes civile në shkallë qarku, për shmangien e ndotjes së detit nga mbetjet urbane si rezultat i prurjes tyre nga ujërat e lumenjve, për përmirësim të kushteve të punës në funksion të veprimtarisë tyre.

Rekomandimi nr. 8: AKMC, QNOD-në, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë e Mbrojtjes së Bregdetit, dhe Ministria e Brendshme të bashkëpunojnë me Prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier dhe Vlorë lidhur me Rishqyrtimin e Planeve të Emergjencave për Mbrojtjen Civile dhe Planin e Emergjencave për Reagim ndaj ndotjeve detare, për të krijuar bazë të dhënash lidhur me ndotjen detare dhe mënyrat e ndërhyrjes, për të përmirësuar strukturën e mbrojtjes civile në shkallë qarku, për të shtuar personelin me specialistë të fushës, për masa konkrete në pajisjen me mjetet e nevojshme për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme, për të rritur fondet buxhetore për eliminimin e ndotjes detit, për të rritur numrin e trajnimeve të strukturave të mbrojtjes civile në shkallë qarku, për shmangien e ndotjes së detit nga mbetjet urbane si rezultat i prurjes tyre nga ujërat e lumenjve, për përmirësim të kushteve të punës në funksion të veprimtarisë tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

IV. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I POLITIKAVE NË LËVIZJET MIGRATORE”

PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme dhe Institutin e Statistikave** mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2020” për auditimin e kryer në vitin 2020, për periudhën 2015-2019 për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën e KLSH-së me nr. 754/1 prot, datë 05.07.2021 dhe Program Auditimi nr. 754/5 Prot, datë 05.07.2021, (administruar në MFE me nr. 12260 prot, datë 07.07.2021, në MB me nr. 3565/1 Prot, datë 05.07.2021 dhe INSTAT me Nr. 102/6 prot, datë 07.07.2021), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- d. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- e. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- f. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4478/4 prot, datë 27.11.2020, protokolluar në KLSH me nr. 90/20 prot, datë 01.12.2020, duke respektuar afatin 20 ditor.

- Ministria e Brendshme ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7932/2 prot, datë 24.11.2020, protokolluar me nr. 90/18 prot, datë 24.11.2020, duke respektuar afatin 20 ditor.

- INSTAT ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 102/4 prot, datë 23.11.2020, protokolluar me nr. 90/18 prot, datë 23.11.2020, duke respektuar afatin 20 ditor. Në shkresën e dërguar konstatohet se nga INSTAT nuk janë përcaktuar afatet, detyrat dhe strukturat përkatëse të institucionit për të zbatuar.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecures së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjekteve të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me shkresën me nr. 10/13 prot, datë 30.10.2020 dhe Drejtorinë së Përgjithshme Detare me shkresën nr. 10/14 prot, datë 30.10.2020, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “*Subjekti i audituar, brenda 6*



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga subjektet e audituar, brenda afatit 6-mujor nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr. 90/17 prot, datë 30.10.2020; Në Ministrinë e Brendshme me nr. 90/16 prot, datë 30.10.2020 dhe në INSTAT me nr. 90/15 prot, datë 30.10.2020, nga KLSH-it janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **23 masa** me karakter organizative.

IV. Statusi i pranimi të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	23	20	3

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 754/1, datë 05.07.2021

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 754/5, prot., datë 05.07.2021 dhe njoftimit “Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve” nr. 754/1 prot., datë 05.07.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. E. K. (Përgjegjës grupi)

2. I. H. anëtar

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 90/17 prot, datë 30.10.2020 (MFE) dhe me shkresën nr. 90/16 prot, datë 30.10.2020 (MB) dhe me shkresën nr. 90/15 prot, datë 30.10.2020 (INSTAT) , së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar MB, MFE dhe INSTAT në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën me shkresën nr. 90/17 prot, datë 30.10.2020 (MFE) dhe me shkresën nr. 90/16 prot, datë 30.10.2020 (MB) dhe me shkresën nr. 90/15 prot, datë 30.10.2020 (INSTAT) rezulton se nga **23** masa të rekomanduara (*masa organizative*), nga subjekti janë pranuar **20** masa ose në masën **87 %** dhe nuk janë pranuar **3 masa ose 13%**.

Nga **20** masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **2** masa ose **10 %** e tyre, janë në proces zbatimi **18** masa ose **90 %** . Nga sa shikohet niveli i realizmit është në masën **10 %**, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa Organizative	20	2	0	18	0

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE :

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është mbi **10 %**, vlerësohet se rekomandimet në proces zbatimi zënë peshën me të madhe ose **85 %** të rekomandimeve të lëna, dhe respektimi i afateve nga subjekti i audituar në shume raste nuk varet nga vendimmarrja e drejtimit, por dhe nga miratimi në strukturat të tjera sipas shkallës së hierarkisë.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi nr.1: Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të informojnë nëpërmjet një relacioni zyrtar Këshillin e Ministrave, në lidhje me të gjithë problemet që hasen në zbatimin e Ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me qëllim që KM të propozojë ndryshime ligjore ose miratimin e një ligji të ri që rregullon emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

Afati: Menjëherë

MB dhe MFE: Ministria e Financave dhe Ekonomisë , Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme kanë dhënë kontribut për hartimin e drafteve teknike të neneve të ligjeve që lidhen me punësimin e të huajve, duke bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar dhe më pas Ligji i ri integral “Për të huajt”, i cili u miratua në KM në fillim të vitit 2021 dhe në seancën parlamentare të dt. 24.6.2021.

MB në muajin Gusht 2020 edhe në muajin Prill 2021, ka informuar MFE me shkresat nr. 5677/1 Prot, datë 31.08.2020 dhe nr. 1919/1 Prot, datë 26.04.2021, nevojën për rishikimin e ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” . Njëkohësisht MFE nuk ka kërkuar për ngritjen e grupit të punës në MB në cilësinë e autoritet kryesor koordinues i politikave migratore, me qëllim hartimin e një draft urdhër të përbashkët për vlerësimin e zbatueshmërisë së dispozitave të ligjit ekzistues të emigrimit për punësim, dhe propozimin e projekt dispozitave të reja në këtë ligj.

Statusi: Në proces zbatimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 2: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tjera të përfshira të ngrenë një grup pune, i cili do të vlerësojë në mënyrë periodike zbatimin e ligjit të emigrimit të shtetasve shqiptarë për motive punësimi dhe do të propozojë ndryshime të mundshme.

Afati: Pas zbatimit të rekomandimit paraardhës

MB dhe MFE: Me shkresat zyrtare të Ministrit të Brendshëm nr. 5677/1 Prot, datë 31.08.2020 dhe nr. 1919/1 Prot, datë 26.04.2021, drejtuar MFE, është evidentuar nevoja për rishikimin e 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”. Institucionet qendrore MB dhe MFE kërkojnë përmirësimi i legjislacionit për emigracionin, duke e vlerësuar këtë si prioritet të politik bërjes në këtë drejtim. Në këto kushte deri në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore në këtë drejtim, ky rekomandim konsiderohet ne proces përse i përket zbatimit të tij.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 3: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me autoritetet e tjera të fushës si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, të hartojnë programe që trajtojnë parandalimin e largimit të personave të kualifikuar drejt vendeve të tjera, në zbatim të detyrimit ligjor.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

MFE: Për parandalimin “Largimit të trurit”, ende nuk janë marrë nisma lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave dhe të ligjit 9668/2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me fokus “frenimin e largimit të trurit” për shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri dhe që dëshirojnë të emigrojnë apo kanë ndërmarrë veprime konkrete për të emigruar.

Rritja e pagave në fushën e shëndetësisë me 40% dhe të arsimit me 15% është një tregues për t’u vlerësuar në këtë drejtim, por ende kërkohen propozime të reja ligjore për këtë qëllim.

Në këto kushte deri në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore në këtë drejtim, ky rekomandim konsiderohet ne proces përse i përket zbatimit të tij.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 4: Ministria e Brendshme të hartojë një plan të brendshëm, me qëllim bërjen të mundur zbatimin në praktikë të detyrimit ligjor për regjistrimin e shtetasve shqiptarë, të cilët largohen për një kohë më të gjatë se 6 muaj nga vendbanimi i tyre në Shqipëri, të cilët duhet të deklarojnë vendbanimin dhe kohën e qëndrimit në shtetin ku ata shkojnë.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

MB: Sqaron se ligji nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” parashikon se “Programi i regjistrimit të adresës” është pjesë përbërëse e Regjistratit Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili përmban të dhëna për shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje ose për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, në një vit kalendarik.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 4.11.2020, “Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

vetëdeklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve.”

Vendimi parashikon se Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin e-Albania, sipas procedurës së përcaktuar në manualin që i bashkëlidhet vendimit.

Pavarësisht miratimit të ligjit nr. 14/2016 dhe VKM nr. 915, datë 04.11.2020, referuar praktikave të vendeve të tjera, statistikave mbi shtetasit shqiptarë që janë banorë në vende të tjera, mund të sigurohen edhe nëpërmjet përfaqësive tona diplomatike në këto vende por për këtë nevojitet hartimi një plan të brendshëm, me qëllim bërjen të mundur zbatimin në praktikë të detyrimit ligjor, në përputhje kjo dhe me rekomandim e KLSH-së

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 5: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkëpunojnë për të hartuar një kuadër për vlerësimin e detajuar të statusit të zbatimit të konventave të ratifikuara dhe ndikimit të tyre në garantimin e të drejtave të migrantëve.

Afati: Menjëherë

MB dhe MFE: Nga Ministria e Brendshme, sqarohet se për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin (2019-2022) dhe Planit të Veprimit, miratuar me VKM nr. 400, datë 19.06.2019, dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij dokumenti politik, si dhe me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), ka kryer një vlerësim të thelluar të kapaciteteve dhe nevojave institucionale për të siguruar një qeverisje efektive të migracionit në Shqipëri. Raporti i vlerësimit përfshin rekomandime për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve për të mundur dhe lehtësuar zbatimin e strategjisë, zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventat e Ratifikuara nga vendi ynë, por edhe mangësitë që mund të pengojnë këtë proces.

MFE jep informacion për konventat që kanë në fokus edhe punëtorët migrantë, dhe për nivelin e zbatimit të tyre në legjislacionin vendas dhe praktikën administrative. Rritja e njohurive të punonjësve të saj për të drejtat e migrantëve në kuadër të konventave ndërkombëtare dhe rolin e institucioneve të tyre në këtë fushë, ishte dhe pjesë e trajnimit të organizuar në kuadër të projektit të IOM, ASPA dhe projekti “Forcimi i kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit në Shqipëri” zhvilluar në periudhën qershor – korrik 2021.

Zyrtarë të MFE, MB, MEPJ dhe ASPA, u trajnuan dhe më pas kryen trajnime tek punonjësit e tjerë.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 6: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tjera të përfshira të bashkëpunojnë për të hartuar një kuadër për rishikimin e rregullt të ndikimit të akteve ligjore në mirëqeverisjen e migracionit. Kuadri duhet të përfshijë shprehimisht aktivitetet e nevojshme dhe indikatorët që vlerësojnë efektivitetin e masave të marra.

Afati: Deri në Dhjetor 2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MB dhe MFE: Nga Ministria e Brendshme sqarohet se përsa i përket këtij rekomandimi është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.6.2019. Rishikimi kërkuar është tashmë i parashikuar si një detyrim strategjik (Objektivi A, masa A.1.1.c) në VKM 400/2019.

Parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin nr. 79/2021, datë 24.06.2021, “Për të huajt”, i cili vinte si pjesë e një pakete ligjore, së bashku me ligjin për Azilin dhe ligjin për Shtetësinë, të miratuar përpara tij, por ende nuk janë draftuar projekt vendimet për miratimin e akteve nënligjore që do të mundësojnë zbatimin e tyre.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka qenë pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me urdhër të Kryeministrit për hartimin e ligjit të ri “Për të huajt”. MFE krahas detyrimeve për hartimin e akteve nënligjore të përbashkëta me MB dhe MEPJ ka dhe një sërë aktesh të tjera nën përgjegjësinë dhe fushën e saj të kompetencave për të hartuar gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021.

Sa më sipër rezulton se Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tjera kanë bashkëpunuar për të hartimin një kuadër ligjor, por ende nuk kanë dhe dërguar për miratim projekt vendime për zbatimin e këtij legjislacioni.

Lidhur me ligjin nr. 9668 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, tashmë ndihet më se e nevojshme se duhen të merren masa për rishikimin e ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me qëllim vlerësimin e zbatueshmërisë së tij, si dhe të parashikimeve lidhur me organizimin dhe përgjegjësitë institucionale.

Pavarësisht punës se deritanishme, shprehim qëndrimin tonë se deri në miratimin e “Udhërrëfyesit Kombëtar për Statistikat e Migracionit”, dhe dokumentet e indikatorëve të migracionit dhe të emërtimeve rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 7: Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me DAP, të marrë masat e nevojshme për të kryer një vlerësim të thellë të kapaciteteve institucionale për qeverisjen e efektshme të migracionit, duke parë edhe mundësinë e zgjerimit të burimeve njerëzore në dispozicion, në përputhje me parashikimet buxhetore të Strategjisë.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

MB: Ministria e Brendshme në bashkëpunim me përfaqësues nga DAP dhe ASPA, si edhe ekspertët e IOM, kanë filluar punën në Shkurt 2020, me qëllim zbatimin e projektit “Forcimi i kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit në Shqipëri”, financuar nga Fondi i Zhvillimit i IOM.

Në fillim të vitit 2021, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe institucionet e tjera përgjegjëse, me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), kanë kryer një vlerësim të thelluar të kapaciteteve dhe nevojave institucionale dhe kanë konkluduar me një Raport vlerësimi. Në raport theksohet sipas MB theksohet se akoma nuk është rekrutuar staf shtesë në Sektorin e Migracionit në MB. Ky fakt ka krijuar pengesa në koordinimin më të mirë të zbatimit të këtij dokumenti si edhe në organizimin dhe realizimin e disa aktiviteteve për zbatimin e masave. Duhet të merren masa për të rekrutuar staf shtesë për Sektorin e Migracionit në MB që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

të kryejë funksionet e tij në lidhje me monitorimin e strategjisë, zbatimin e masave dhe çështje të tjera migracioni.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 8: Instituti i Statistikave të publikojë të dhëna më të detajuara në lidhje me faktorët që i shtyjnë shqiptarët drejt emigracionit në botimet e përvitshme. Këto të dhëna të publikohen edhe në faqen Web të INSTAT, krahas të dhënave për migracionin.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

INSTAT: Ky rekomandim nuk pranohet nga subjekti me arsyetimin se INSTAT përdor Anketën e Forcave të Punës për mbledhjen e informacionit mbi migracionin, qëllimi i këtij moduli është të sigurojë të dhëna sasiore mbi emigrantët, imigrantët e një viti të caktuar. Gjithashtu, ky modul përmban edhe informacion mbi gjashtë arsye kryesore të cilat janë përcaktuar në linjë me rekomandimet, rregulloret si dhe në bashkëpunim me ekspertë të fushës. Të dhëna të detajuara mbi faktorët/arsyet nuk mund të kryhen me anë të AFP, por mund të sigurohen me burime të tjera të dedikuara për migracionin. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen e Web të INSTAT nëpërmjet publikimit të Diasporës në Shifra edhe pse nuk janë pjesë e indikatorëve të përfshirë në PSZ 2017-2021. Linku përkatës: <http://www.instat.gov.al/media/6547/diaspora-2019.pdf>.

Përsa më sipër INSTAT propozon rishikimin e rekomandimit për detajimi e arsyeve, duke mos qenë në linjë me rregulloren përkatëse, por mund të konsiderojë publikimin në databazën statistikore të arsyeve të emigracionit, pasi të përfshihen në PSZ 2022-2026.

Nga qëndrimi i INSTAT për rekomandimin e lënë, rezulton se subjekti nuk ka marrë masa në zgjerimin e moduleve identifikues mbi arsytet e largimit të emigrantëve. Diaspora përmes ministrit të diasporës, ministër pa portofol, ka pamundësi identifikimi të faktorëve shtytës të emigrimit, sepse ai është person i vetëm që funksionon në këtë ministri. Të dhënat e ministrit të diasporës janë orientuese dhe jo statistikore.

Bashkia Vlorë me shkresën nr. 10378/2 prot, datë 15.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 754/7 prot, datë 21.07.2021 me lende “Informacion mbi rekomandimet e lëna për efektivitetin e politikave në lëvizjet migratore”, vlerëson përgjigjen e bashkisë në lidhje me ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në këtë bashki, por pa ndikim në lidhje me rekomandimet e KLSH-se.

Në lidhje mos pranimin e këtij rekomandimi nga INSTAT, grupi auditimit mendon se rekomandimi duhet të pranohet dhe të zbatohet nga subjekti, me arsyetim se referuar Ligjit nr. 17/2018, neni 9.5, Plani Vjetor miratuar për INSTAT, mund përmirësohet në drejtim të zgjerimit të anketës së forcave të punës, me qëllim identifikimin e faktorëve dhe arsyeve që nxisin emigracionin përtej 6 arsyeve që përmban kjo ankete, të cilat aktualisht paraqesin të dhëna sasiore dhe jo motivet e emigrimit. Këto të dhëna, përveç faktorëve të tjerë, do të shërbejnë për politikëbërje më të mirë në drejtim të lëvizjes migratore.

Statusi: Mos pranim rekomandimi

Rekomandimi nr. 9: Instituti i Statistikave, brenda mundësive logjistike dhe në përputhje me Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare, të përfshijë edhe popullsinë shqiptare që jeton jashtë kufijve në grumbullimin e të dhënave në lidhje me emigracionin.

Afati: Pas ngritjes së Regjistrimit të emigrantëve nga strukturat përgjegjëse



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

INSTAT: Në lidhje me këtë rekomandim INSTAT, është në proces miratimi të një memorandumit të ri me DPGJC ku pjesë e këtij memorandumit do të jetë dërgimi i të dhënave për Shtetasit Shqiptarë me vendbanim jashtë vendit. *(Bashkëlidhur shkresën nr. Prot. 638/1 datë 11.06.2021 (Folderi: MoU/DPGJC).* Me gjithë masat e marra nga subjekti audituar, deri ne miratimin e memorandumit të ri, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 10: Ministria e Brendshme të marrë masa për të propozuar ndryshimet ligjore në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, si edhe ligjin nr. 9668, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë efekte mbi këto detyra ligjore, ku të përcaktohen drejtë detyrimet ministeriale për mbledhje, ruajtje dhe raportime në INSTAT. Çdo publikim mbi migracionin të jenë atribut i INSTAT.

Afati: Menjëherë

MB dhe INSTAT: Nga informacioni dhe dokumentacioni grumbulluar rezulton se MB dhe INSTAT kanë publikuar të dhëna mbi migracionin sipas legjislacionit përkatës.

Miratimi i ligjit për të huajt dhe rishikimi i ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, kërkojnë dhe përcaktimin e metodologjisë mbi raportimin statistikor mbi lëvizjen migratore, e cila edhe sipas INSTAT do të thellohet duke kërkuar arritjen e raportimit sipas EUROSTAT, dhe deri ne finalizim të këtij veprimi ndërinstitucional, rekomandimi konsiderohet ne proces zbatimi

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 11: Ministri i Brendshëm të marrë masa për emërimin e një zëvendësministri në pozicionin e drejtuesit të Grupit Drejtues për migracionin dhe të njoftojë ministrinë përgjegjëse për dërgimin e zëvendësministrave respektiv në këtë Grup Drejtues. MB të marrë masa për ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave për formulën e funksionimit të Komitetit Teknik dhe të përcaktojë qartë përbërjen e Sekretariatit Teknik dhe nivelin e domosdoshëm të specialistëve që kërkohet nga çdo ministri e institucion që merr pjesë në të.

Afati: Menjëherë

MB: Ministria e Brendshme në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.06.2019, Ministria e Brendshme ka hartuar dhe ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave, Projekt Urdhërin e Kryeministrit për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Drejtues për Migracionin. Grupi Drejtues për Migracionin (GDM) është ngritur me Urdhër Kryeministrit, nr. 35, datë: 10.03.2021. Pas miratimit të këtij urdhri institucionet e përfaqësuar kanë dërguar emrat e përfaqësuesve pranë Ministrisë së Brendshme.

Në Sekretariatit Teknik nuk ka përfaqësues nga institucionet e tjera, por në çdo institucion/agjenci drejtuese janë caktuar pikat e kontaktit dhe detyrat e tyre, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 400, si më poshtë:

Me urdhër të Kryeministrit nr. 99 datë 27.07.2020, është ngritur Komiteti Teknik për Migracionin (KTM), si një nga mekanizmat kryesorë përgjegjës për monitorimin e strategjisë. KTM udhëhiqet nga Zëvendësministri i Brendshëm që mbulon këtë fushë dhe përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve në secilën ministri apo institucion



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MB ende nuk ka marrë masa të përcaktojë qartë përbërjen e Sekretariatit Teknik dhe nivelin e domosdoshëm të specialistëve që kërkohet nga çdo ministri e institucion që merr pjesë në të, arsye për të cilën rekomandimi konsiderohet ne proces zbatimi

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 12: Ministri i Brendshëm të marrë masa për krijimin e një udhëzimi për mënyrën e mbajtjes së të dhënave për emigrantët, ku të përfshihen lloji i lejes së qëndrimit që ka në shtetin ku emigron, qytetin dhe shtetin ku jeton, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë që gëzojnë dyshtetësi. Ministri i Brendshëm të marrë masa për krijimin e një platforme on-line me qëllim lehtësimin e vetë deklaramit të emigrantëve shqiptarë, për të eliminuar vonesat në kufi, si edhe të krijoj akses në “e-Albania” për çdo emigrant shqiptar kudo në botë që dëshiron të vetëregjistrohet në regjistrin e emigrantëve. Ministri të marrë masa për ndryshime në sistemin FER-TIMS, ku të pasqyrohen të dhënat thelbësore për emigrantët si dhe aksesin e çdo platforme on-line për të lehtësuar vetëdeklarimin e emigrantëve, hedhjen e të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbi emigrantët, hedhjen e të dhënave nga çdo punonjës policie në komunitet dhe në pikat e kalimit kufitar. Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në formën e një regjistri për emigrantët.

Afati: Brenda datës 31.09.2020

MB: Lidhur me rekomandimin për vetëregjistrimin e emigrantëve në regjistrin e emigrantëve, është miratuar ligji nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Në zbatim të tij është hartuar dhe miratuar dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 915, datë 4.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve”. Ligji parashikon se “Programi i regjistrimit të adresës” është pjesë përbërëse e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, dhe në këtë drejtim është mundësuar nëpërmjet e-Albania deklarimi i adresës jashtë vendit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur rezulton se ende nuk janë marrë masa për ndryshime në sistemin FER-TIMS, ku të pasqyrohen të dhënat thelbësore për emigrantët, ende nuk ka bashkëpunim ne DPGJC mbi emigrantët, dhe hedhjen e të dhënave nga çdo punonjës policie në komunitet dhe në pikat e kalimit kufitar, ende nuk ka një regjistër kombëtar për emigrantet

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 13: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për të analizuar nevojat specifike për forcimin e kapaciteteve për qeverisjen e efektshme të migracionit dhe të propozojë e miratojë strukturë të plotë.

Afati: Menjëherë

MFE: Në Sektorin e Politikave të Punësimit dhe Migratore, rezulton të ketë ende vetëm një specialist trajton çështjet e e/imigracionit të punë . Ky kapacitet tregon se shtimi i numrit të stafit lidhur me çështjet e emigrimit të punës është i nevojshëm për të siguruar zbatimin e detyrave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit, arsye për të cilën MFE duhet të ri kërkojë zbatimin e këtij rekomandimi

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 14: Struktura përgjegjëse për emigracionin dhe imigracionin e punës pranë MFE të marrë masa për evidentimin e procesit të zbatimit të masave të Strategjisë Kombëtare për Migracionin duke hartuar periodikisht dokumente dhe duke i bërë ato transparente.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

MFE: MFE ka hartuar dhe miratuar metodologjinë e raportimit, duke përcaktuar formatin dhe procedurat e raportimit dhe komunikimit me agjencitë përgjegjëse për masat e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022. MFE ka hartuar dhe dërguar periodikisht në MB raportet e përditësuara mbi zbatimin e masave të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 15: MFE të marrë masa për bërjen funksional të regjistrit të emigraenteve, dhe bërjen transparente të të dhënave të sakta rreth shtetasve shqiptarë që duan të emigrojnë për qëllime punësimi, atyre që kanë marrë leje përkatëse për tu punësuar jashtë vendit dhe për shtetasit shqiptarë që janë kthyer, bazuar në ligjin Nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi”, neni 12 dhe Urdhrin Nr. 84 datë 06.06.2011.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

MFE: Subjekti audituar informon se me përfundimin e marrëveshjes së parë, gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021, është shprehur vullneti i MFE dhe GIZ për të vazhduar këtë bashkëpunim që ka në fokus mbështetjen e shtetasve shqiptarë në shërbime informimi dhe riintegrimin. Aktualisht po shqyrtohet drafti teknik i projekt marrëveshjes së re të zbatimit ndërmjet MFE dhe GIZ për projektin “Programi Migracionit për Zhvillim (PME III) dhe më pas do ndiqen procedurat e miratimit dhe ratifikimit të saj.

Aktualisht po shqyrtohet drafti teknik i projekt marrëveshjes së re të zbatimit ndërmjet MFE dhe GIZ për projektin “Programi Migracionit për Zhvillim (PME III) dhe më pas do ndiqen procedurat e miratimit dhe ratifikimit të saj

Sa me sipër rezulton se ende janë në fazë hartimi të projekt marrëveshjeve lidhur me mbështetjen e shtetasve për riintegrim social dhe ekonomik, njëkohësisht mbetet prioritet ndritja e grupit të punës për rishikimin e ligjit 9668/2011.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 16: MB dhe MFE në bashkëpunim me INSTAT, të formatizojnë formatet tip të të dhënave administrative dhe statistikore në funksion të hartimit të saktë të Profilit të Migracionit dhe Strategjisë Kombëtare të Migracionit si dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare të raportimeve të fushës.

Afati: Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

MB dhe MFE: Ministria e Brendshme në Maj të vitit 2021, me mbështetjen e IOM, institucionet shqiptare dhe INSTAT hartuan një Udhërrëfyes Kombëtar për Statistikat e Migracionit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

Ligji nr. 79/2021, datë 24.06.2021, "Për të huajt", parashikon që Profili vjetor i migracionit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës dhe Profili i zgjeruar i migracionit përgatitet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave statistikore për migracionin një herë në katër vjet, brenda 9-mujorit të vitit pasardhës dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

INSTAT informon se gjatë vitit 2021 u iniciua puna për standardizimin e formateve të të dhënave administrative në përputhje me rregulloren e EUROSTAT 862/2007 . Gjithashtu është përgatitur dhe një Udhërrëfyes për Statistikat e Migracionit në Shqipëri .Në vazhdim të standardizimit të të dhënave administrative janë hartuar formate tabelash dhe janë dërguar në institucionet përkatëse (MB/ Ministria e Brendshme dhe DKM/Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit) me shkresë zyrtare.

Ministria e Financave nuk paraqet te dhëna për ndjekjen e këtij rekomandimi si dhe nga të informacioni i INSTAT nuk rezulton te këtë korrespondence shkresore mbi standardin e ri të tabelave statistikore te hartuara prej saj.

Bashkëpunimi ndërinstitucional kërkon një standard te unifikuar për çdo institucion raportues

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 17: Në funksion të identifikimit dhe kryqëzimit të informacionit në kohë reale INSTAT, të krijojë strukturat lidhëse për të kryer testime në pikat kufitare, me qëllim etiketimin e motivacioneve të largimit të shtetasve Shqiptarë nga vendi.

Afati: Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

INSTAT: Bazuar në shkresën me nr. 102/2 datë 29.07.2020 dhe Nr. 102/4 Prot., më datë 23.11.2020 me lëndë "Komentet mbi projekt-raport auditimi nuk pranon rekomandimi i KLSH-it për këtë rekomandim me arsyetimin se:

Gjatë punës së tij kërkuese mbi përmirësimin e statistikave të migracionit dhe gjetjen e metodologjive inovativ për vlerësimin e statistikave të migracionit mund të thuhet se e ka ezauruar rekomandimin e sipër përmendur që në vitin 2017-2018.

INSTAT del në konkluzion se anketimi në pikat kufitare ishte i pamundur të realizohej. Takime pune me MB dhe DKM janë zhvilluar gjatë vitit 2017 edhe në vazhdim të 2018, me qëllim shfrytëzimin e kompetencave të punonjësve në PKK për mbledhjen e informacionit tip të hartuar nga INSTAT. DKM e ka parë këtë nismë jo të realizueshme. Gjithashtu, nëpërmjet takimeve dhe shkëmbimesh informacioni me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit pranë MB është diskutuar Regjistri i Hyrje – Daljeve (TIMS), për qëllimin e kryqëzimit të informacionit mbi statistikave të migracionit dhe ka rezultuar jo efikas. Përsëri kjo një nismë e INSTAT dhe e hulumtimeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare për praktikën më të mira të vlerësimit të statistikave të migracionit. Përsa më sipër INSTAT mendon se rekomandimi është i pamundur të realizohet nga ky institucion.

Sipas mendimit të grupit të auditimit, rekomandimi mund të pranohet dhe zbatohet nga subjekti audituar me arsyetimin se gjatë këtij auditimi rezultoi se MB do të përmirësoje sistemin FER-TIMS (trajtuar ne rekomandimin nr. 12 te këtij auditimi), i cili me modulet e reja që do të zhvillohen mund të mundësojnë qe këto evidenca të jenë të aksesueshme edhe nga INSTAT.

Statusi: Mos pranim rekomandimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 18: MB në bashkëpunim me strukturat e MPJ të hartojë dhe miratojë aktet në zbatim të Ligjit nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Afati: Brenda vitit 2020

MB: Lidhur me rekomandimin për vetëregjistrimin e emigrantëve në regjistrin e emigrantëve, është miratuar ligji nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është identifikimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Por përveç sa është trajtuar me sipër në lidhje me vetëregjistrimin e emigrantëve, sipas dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nuk rezulton që Ministria e Brendshme të ketë bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme sipas rekomandimit tonë.

Statusi: Pa zbatuar

Rekomandimi nr. 19: MFE në bashkëpunim me SHKP dhe INSTAT të hartojnë Memorandume bashkëpunimi, për të saktësuar tipologjinë e mbledhjes, raportimit dhe afateve të të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësisë në Profillin e Migracionit.

Afati: Brenda vitit 2020

MFE dhe INSTAT: Sipas informacionit të marrë rezulton se Ministria e Financave dhe Ekonomisë të dhënat administrative i mbledh nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Migracionit (AKPA). AKPA ka bashkëpunimin me INSTAT nëpërmjet një Memorandumi Bashkëpunimi përfshirë edhe ato të migracionit që janë përfshirë së fundmi në këtë memorandum. Në gjashtë muorin e parë të vitit 2021, u hartua projektin rajonal IPA II “Mbështetje Rajonale për Menaxhimin e Migracionit me fokus të mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, financuar nga BE, dhe veçanërisht komponentit të fuqizimit të kapaciteteve të mbledhjes, sistematizimit dhe analizës së statistikave të migracionit dhe përafrimit të tyre me Rregulloren 862/2007 të KE.

Por, në nivel kombëtar, ende nuk ka një standard të miratuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të migracionit dhe azilit, kjo në përputhje edhe me Rregulloren 862/2007 dhe udhëzimet e EUROSTAT.

Projekti “Përmirësimi i kuadrit të migrimit për punë në Shqipëri”, në të cilin MFE dhe INSTAT janë partnerë kryesorë mbi të dhënat dhe statistikave të migracionit për zyrtarët shqiptarë ende nuk ka përfunduar.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 20: INSTAT duke marrë parasysh eksperiencat e vendeve të tjera, të vlerësojë mënyra të reja për matjen e migracionit, si ajo e kryerjes së anketave specifike dhe përdorimin e statistikave pasqyrë.

Afati: Brenda 6 muorit të dytë të 2022 dhe në vazhdimësi

INSTAT: Bazuar në shkresën me nr. 102/2 datë 29.07.2020 dhe Nr. 102/4 Prot., më datë 23.11.2020 me lëndë “Komentet mbi projekt-raport auditimi **nuk pranon** rekomandimi i KLSH-it për këtë rekomandim me arsyetimin se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

INSTAT për vlerësimin e migracionit merr parasysh të dhënat pasqyrë të cilat konkretisht i disponon që prej vitit 2015 me Italinë, si një prej vendeve kryesore destinacion të emigrantëve shqiptarë. Rasti i Greqisë nuk u arrit të finalizohet shkëmbimi i informacionit për arsye të mos disponibilitetit të statistikave të migracionit dhe mungesës së regjistrave statistikor në Greqi.

INSTAT ka kryer 2 anketa specifike mbi analizimin e statistikave të migracionit, Anketa e të Kthyerve dhe Riintegrimi 2013 dhe Anketa e Migracionit në Familje 2019. INSTAT vazhdimisht në mbështetje të projekteve dhe palëve të treta merr iniciativë dhe është i angazhuar për përmirësimin e statistikave të migracionit.

Marrë parasysh kostot relativisht të larta të këtyre anketave si dhe bazuar në faktin që INSTAT sapo ka kryer një të tillë nuk e shikojmë të arsyeshme kryerjen e një ankete të re brenda këtij afati. Gjithashtu duhet pasur parasysh se INSTAT është në prag të kryerjes së Censit të radhës dhe angazhimi në aktivitete të reja të paplanifikuara është një barrë e madhe për stafin.

Si u trajtua edhe me lart, në nivel kombëtar, ende nuk ka një standard të miratuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të migracionit dhe azilit, kjo në përputhje edhe me Rregulloren 862/2007 dhe udhëzimet e EUROSTAT. Sigurisht që kjo kërkon kohe dhe buxhet por nuk përben shkak për mospranim rekomandimi, pasi si një domosdoshmëri për statistika të rregullta duhet të ndërmerren sa më shpejt të jete e mundur, hapat e nevojshëm për zotërim të statistikave sa me të përafërta për migracionin,

Grupi i auditimit arsyeton se referuar të dhënave të këtij auditimi, ekziston një memorandum bashkëpunimi midis AKPA dhe INSTAT, për ngritjen e grupit teknik në përbërje të të cilit ka përfaqësues të dy institucioneve, dhe kostot financiare për të kryer përmbushjen e detyrave specifike lidhur me statistikën pasqyrë, mund të jene përfshirë në dy projekt të sipërcituar (IPA II dhe IOM), rrethana të reja për të cilën rikërkojmë zbatimin e rekomandimit.

Statusi: Mos pranim rekomandimi

Rekomandimi nr. 21: INSTAT të vlerësojë nëpërmjet një raporti ku të cilësojë boshllëqet dhe vështirësitë në funksion të përmirësimit, mbledhjes, analizimit dhe ndarjes së të dhënave administrative për migracionin, duke i ndarë me të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për menaxhimin e migracionit në vend si dhe duke sugjeruar modeli të ri standard për mbledhjen e tyre.

Brenda 6 mujorit të parë të 2021

INSTAT: Nga INSTAT është përgatitur raporti mbi mangësitë dhe problematikat mbi statistikën e migracionit në kuadër të mbështetjes nga IOM me ekspertë ndërkombëtarë mbi përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të migracionit (Folderi: IOM/Final_ALB_April_29_RMap). Modeli i ri standard për mbledhjen e të dhënave jo-administrative për migracionin dhe karakteristikat bazë socio-demografike është hartuar dhe përdorur nga INSTAT (Folderi HMS/ Anketa e Migracionit në Familje 2019). Një modeli i ri standard për mbledhjen e të dhënave administrative për migracionin është hartuar nga INSTAT dhe dërguar institucioneve përkatëse (Shkresa nr. 1007 prot, dt 07.07.2021, dhe shkresa nr. 1073 prot, dt 29.06.2021).

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 22: INSTAT në funksion të përdorimit të informacionit real, të bashkëpunoj me MB për hartimin e modaliteteve të përdorimit të sistemit të përbashkët të të dhënave mbi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

popullsinë dhe migrantët duke zbatuar njëherësh edhe rolin e saj koordinues për Sistemin Kombëtar të Statistikave në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin prej nenit 13 të Ligjit nr. 17/2018 Për statistikën zyrtare.

Afati: Brenda vitit 2022 dhe në vazhdimësi

MB dhe INSTAT: Nga Ministria e Brendshme informohemi se të dhënat migratore mbi të huajt dërgohen pranë INSTAT, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Statistikat mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri, janë përfshirë për herë të parë në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 të INSTAT. Të dhënat dërgohen në zbatim të Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Institutit të Statistikave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për Shkëmbimin e statistikave zyrtare, që prej vitit 2017.

Në lidhje me këtë rekomandim INSTAT, është në proces miratimi të një memorandumi të ri me DPGJC ku pjesë e këtij memorandumi do të jetë dërgimi i të dhënave për Shtetasit Shqiptarë me vendbanim jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në përmirësimin e të dhënave mbi migracionin në përgjithësi. (Bashkëlidhur shkresa nr. Prot. 638/1 datë 11.06.2021 (Folderi: MoU/DPGJC).

Pavarësisht masave të marra nga subjektet e audituar, deri në miratimin e Memorandumit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, rekomandimi do të konsiderohet në proces zbatimi

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 23: INSTAT bashkëpunim me MB të hartojnë programe dhe metodologji mbi shkëmbimin e të dhënave midis vendeve pritëse të emigrantëve shqiptar si dhe të përgatiten procedurat për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara.

Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

MB dhe INSTAT: Sipas informacionit të ardhur nga Ministria e Brendshme në Maj të vitit 2021, në bashkëpunim me INSTAT dhe institucionet e tjera përgjegjëse është hartuar një Udhërrëfyes Kombëtar për Statistikat e Migracionit, i cili synon të përmirësojë ndjeshëm mbledhjen e të dhënave kombëtare. Dokumenti pritet të shërbejë për saktësinë e të dhënave të migrimit, sistematizimin dhe harmonizimin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Pavarësisht kësaj, deri në dakortësinë midis MB dhe INSTAT mbi hartimin e programeve dhe metodologji mbi shkëmbimin e të dhënave midis vendeve pritëse të emigrantëve shqiptar si dhe procedurave për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi

Ky rekomandim është për dy institucione dhe MB e pranon rekomandim, ndërsa INSTAT nuk e pranon. Për qëllime evidencë statistikore statusin e rekomandimit të cilësojmë të pranuar dhe në proces zbatimi

Statusi: Në proces zbatimi

IV KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti Statistikave, nuk e kanë përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit në KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar MB, MFE dhe INSTAT në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

me me shkresën nr. 90/17 prot, datë 30.10.2020 (MFE), me shkresën nr. 90/16 prot, datë 30.10.2020 (MB) dhe me shkresën nr. 90/15 prot, datë 30.10.2020 (INSTAT) rezulton se nga **23 masa** të rekomanduara (masa organizative), nga subjekti janë pranuar **20 masa** ose në masën 87% dhe nuk janë pranuar **3 masa** ose 13%. Nga 20 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **2 masa** ose 10 % e tyre, janë në proces zbatimi **18 masa** ose 90 %. Nga sa shikohet niveli i realizmit është në masën 10 %, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Gjetje nr. 1: Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kërkuar për ngritjen e grupit të punës në MB në cilësinë e autoritet kryesor koordinues i politikave migratore, me qëllim hartimin e një draft urdhër të përbashkët për vlerësimin e zbatueshmërisë së dispozitave të ligjit ekzistues të emigrimit për punësim, dhe propozimin e projekt dispozitave të reja në këtë ligj.

Rekomandimi nr. 1: Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të informojnë nëpërmjet një relacioni zyrtar Këshillin e Ministrave, në lidhje me të gjithë problemet që hasen në zbatimin e Ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me qëllim që KM të propozojë ndryshime ligjore ose miratimin e një ligji të ri që rregullon emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr. 2 : MFE nuk ka kërkuar për ngritjen e grupit të punës në MB në cilësinë e autoritet kryesor koordinues i politikave migratore, me qëllim hartimin e një draft urdhër të përbashkët për vlerësimin e zbatueshmërisë së dispozitave të ligjit ekzistues të emigrimit për punësim, dhe propozimin e projekt dispozitave të reja në këtë ligj.

Rekomandimi nr. 2: MFE, MB dhe MEPJ të marrin masa për ngritjen e grupit të punës në MB në cilësinë e autoritet kryesor koordinues të politikave migratore, me qëllim hartimin e një draft urdhër të përbashkët për vlerësimin e zbatueshmërisë së dispozitave të ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, duke propozuar projekt dispozita të reja në këtë ligj.

Afati: Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 3 : Për parandalimin “Largimit të trurit”, ende nuk janë marrë nisma lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave dhe të ligjit 9668/2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me fokus “frenimin e largimit të trurit” për shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri dhe që dëshirojnë të emigrojnë apo kanë ndërmarrë veprime konkrete për të emigruar.

Rekomandimi nr. 3: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me autoritetet e tjera të fushës si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, të hartojnë programe që trajtojnë parandalimin e largimit të personave të kualifikuar drejt vendeve të tjera, në zbatim të detyrimit ligjor.

Afati: Deri në Dhjetor 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje nr. 4: Pavarësisht miratimit të ligjit nr. 14/2016 dhe VKM nr. 915, datë 04.11.2020, statistikën mbi shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të sigurohen edhe nëpërmjet përfaqësive tona diplomatike në këto vende, ose praktikave të mira të vendeve të tjera, ose përmirësimit të modulit FER-TIMS me qëllim vetëdeklartimin e adresave të vendbanimit të emigrantëve shqiptarë.

Rekomandimi nr. 4: Ministria e Brendshme të hartojë një plan të brendshëm, me qëllim bërjen të mundur zbatimit në praktikë të detyrimit ligjor për regjistrimin e shtetasve shqiptarë, të cilët largohen për një kohë më të gjatë se 6 muaj nga vendbanimi i tyre në Shqipëri, të cilët duhet të deklarojnë vendbanimin dhe kohën e qëndrimit në shtetin ku ata shkojnë.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr. 5: Punonjësit që merren me zbatimin e strategjisë MFE, MB lidhur me drejtat e migrantëve në kuadër të konventave ndërkombëtare dhe rolin e institucioneve të tyre në këtë fushë, ende nuk kanë njohuritë e mjaftueshme të mundësuar zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Konventat e Ratifikuara nga vendi ynë, kryesisht në informimin e emigrantëve potencial lidhur me të drejtat dhe detyrimet në shtetin pritës si dhe sanksionet në rast shkeljeje legjislacioni të vendit pritës.

Rekomandimi nr. 5: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të bashkëpunojnë për të hartuar një kuadër për vlerësimin e detajuar të statusit të zbatimit të konventave të ratifikuara dhe ndikimit të tyre në garantimin e të drejtave të migrantëve.

Afati Menjëherë

Gjetje nr. 6: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tjera kanë bashkëpunuar për të hartimin një kuadër ligjor, por ende nuk kanë dhe dërguar për miratim projekt vendime për zbatimin e këtij legjislacioni. Lidhur me ligjin nr. 9668 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, tashmë ndihet më se e nevojshme se duhen të merren masa për rishikimin e ligjit nr.9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”. Nga MB, MFE dhe institucionet e tjera që merren me zbatimin e këtij legjislacioni, ende nuk kanë hartuar dhe miratuar dokumentet e indikatorëve të migracionit.

Rekomandimi nr. 6: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tjera të përfshira të bashkëpunojnë për të hartuar një kuadër për rishikimin e rregullt të ndikimit të akteve ligjore në mirëqeverisjen e migracionit. Kuadri duhet të përfshijë shprehimisht aktivitetet e nevojshme dhe indikatorët që vlerësojnë efektivitetin e masave të marra.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr. 7: MB akoma nuk ka rekrutuar staf shtesë në Sektorin e Migracionit në MB. Ky fakt ka krijuar mangësi në zbatimin VKM nr. 400, datë 19.6.2019, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019–2022”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 7: Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me DAP, të marrë masat e nevojshme për të kryer një vlerësim të thellë të kapaciteteve institucionale për qeverisjen e efektshme të migracionit, duke parë edhe mundësinë e zgjerimit të burimeve njerëzore në dispozicion, në përputhje me parashikimet buxhetore të Strategjisë.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 8: Subjekti nuk ka marrë masa në zgjerimin e moduleve identifikues mbi arsyet e largimit të emigranteve. Diaspora përmes ministrit të diasporës, ministër pa portofol, ka pamundësi identifikimi të faktorëve shtytës të emigrimit, sepse ai është person i vetëm që funksionon në këtë ministri. Të dhënat e ministrit të diasporës janë orientuese dhe jo statistikore. Referuar Ligjit nr. 17/2018, neni 9.5, plani vjetor miratuar për INSTAT, mund përmirësohet në drejtim të zgjerimit të anketës së forcave të punës, me qëllim identifikimin e faktorëve dhe arsyeve që nxisin emigracionin përtej 6 arsytë që ka kjo ankete, të cilat aktualisht paraqesin të dhëna sasiore dhe jo motivet e emigrimit. Këto të dhëna, përveç faktorëve të tjerë, do të shërbejnë për politikëbërje më të mirë në drejtim të lëvizjes migratore.

Rekomandimi nr. 8: Instituti i Statistikave të publikojë të dhëna më të detajuara në lidhje me faktorët që i shtyjnë shqiptarët drejt emigracionit në botimet e përvitshme. Këto të dhëna të publikohen edhe në faqen Web të INSTAT, krahas të dhënave për migracionin.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 9: INSTAT, është në proces miratimi të një memorandumit të ri me DPGjC ku pjesë e këtij memorandumit do të jetë dërgimi i të dhënave për Shtetasit Shqiptarë me vendbanim jashtë vendit.

Rekomandimi nr. 9: Instituti i Statistikave, brenda mundësive logjistike dhe në përputhje me Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare, të përfshijë edhe popullsinë shqiptare që jeton jashtë kufijve në grumbullimin e të dhënave në lidhje me emigracionin.

Afati: Pas ngritjes së Regjistrit të emigrantëve nga strukturat përgjegjëse

Gjetje nr. 10: MB dhe INSTAT kanë publikuar të dhëna mbi migracionin sipas legjislacionit përkatës. Miratimi i ligjit për të huajt dhe rishikimi i ligjit nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, kërkojnë dhe përcaktimin e metodologjisë mbi raportimin statistikor mbi lëvizjen migratore.

Rekomandimi nr. 10: Ministria e Brendshme të marrë masa për të propozuar ndryshimet ligjore në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar, si edhe ligjin nr. 9668, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë efekte mbi këto detyra ligjore, ku të përcaktohen drejtë detyrimet ministeriale për mbledhje, ruajtje dhe raportime në INSTAT. Çdo publikim mbi migracionin të jenë atribut i INSTAT.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr. 11: Me urdhër të Kryeministrit nr. 99 datë 27.07.2020 është ngritur Komiteti Teknik për Migracionin (KTM), si një nga mekanizmat kryesorë përgjegjës për monitorimin e strategjisë. KTM udhëhiqet nga Zëvendësministri i Brendshëm që mbulon këtë fushë dhe përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve në secilën ministri apo institucion. MB ende nuk ka



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

marrë masa të përcaktojë qartë përbërjen e Sekretariatit Teknik dhe nivelin e domosdoshëm të specialistëve që kërkohet nga çdo ministri e institucion që merr pjesë në të.

Rekomandimi nr. 11: Ministri i Brendshëm të marrë masa për emërimin e një zëvendësministri në pozicionin e drejtuesit të Grupit Drejtues për migracionin dhe të njoftojë ministrinë përgjegjëse për dërgimin e zëvendësministrave respektiv në këtë Grup Drejtues. MB të marrë masa për ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave për formulën e funksionimit të Komitetit Teknik dhe të përcaktojë qartë përbërjen e Sekretariatit Teknik dhe nivelin e domosdoshëm të specialistëve që kërkohet nga çdo ministri e institucion që merr pjesë në të.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr. 12: Ligji nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” parashikon se “Programi i regjistrimit të adresës” është pjesë përbërëse e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, dhe në këtë drejtim është mundur nëpërmjet e-Albania deklarimi i adresës jashtë vendit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur rezulton se ende nuk janë marrë masa për ndryshime në sistemin FER-TIMS, ku të pasqyrohen të dhënat thelbësore për emigrantët, ende nuk ka bashkëpunim me DPGJC mbi emigrantët, dhe hedhjen e të dhënave nga çdo punonjës policie në komunitet dhe në pikat e kalimit kufitar, ende nuk ka një regjistër kombëtar për emigrantët

Rekomandimi nr. 12: Ministri i Brendshëm të marrë masa për krijimin e një udhëzimi për mënyrën e mbajtjes së të dhënave për emigrantët, ku të përfshihen lloji i lejes së qëndrimit që ka në shtetin ku emigron, qytetin dhe shtetin ku jeton, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë që gëzojnë dyshtetësi. Ministri i Brendshëm të marrë masa për krijimin e një platforme on-line me qëllim lehtësimin e vetë deklarimit të emigrantëve shqiptarë, për të eliminuar vonesat në kufi, si edhe të krijoj akses në “e-Albania” për çdo emigrant shqiptar kudo në botë që dëshiron të vetëregjistrohet në regjistrin e emigrantëve. Ministri të marrë masa për ndryshime në sistemin FER-TIMS, ku të pasqyrohen të dhënat thelbësore për emigrantët si dhe aksesin e çdo platforme on-line për të lehtësuar vetëdeklarimin e emigrantëve, hedhjen e të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbi emigrantët, hedhjen e të dhënave nga çdo punonjës policie në komunitet dhe në pikat e kalimit kufitar. Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në formën e një regjistri për emigrantët.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr. 13: Sektorin e Politikave të Punësimit dhe Migratore, rezulton të ketë ende vetëm një specialist trajton çështjet e e/migracionit të punës. Ky kapacitet tregon se mbetet nevoja për shtimin e numrit të stafit lidhur me çështjet e emigrimit të punës është i nevojshëm për të siguruar zbatimin e detyrave sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit.

Rekomandimi nr. 13: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për të analizuar nevojat specifike për forcimin e kapaciteteve për qeverisjen e efektshme të migracionit dhe të propozojë e miratojë strukturë të plotë.

Afati: Deri në Dhjetor 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje nr. 14: Aktualisht po shqyrtohet drafti teknik i projekt marrëveshjes së re të zbatimit ndërmjet MFE dhe GIZ për projektin “Programi Migracionit për Zhvillim (PME III) dhe më pas do ndiqen procedurat e miratimit dhe ratifikimit të saj. Sa me sipër rezulton se ende janë në fazë hartimi të projekt marrëveshjeve lidhur me mbështetjen e shtetasve për riintegrim social dhe ekonomik, njëkohësisht mbetet prioritet ndritja e grupit të punës për rishikimin e ligjit 9668/2011.

Rekomandimi nr.14: MFE të marrë masa për bërjen funksional të regjistrit të emigranteve, dhe bërjen transparente të të dhënave të sakta rreth shtetasve shqiptare që duan të emigrojnë për qëllime punësimi, atyre që kanë marrë leje përkatëse për tu punësuar jashtë vendit dhe për shtetasit shqiptarë që janë kthyer, bazuar në ligjin Nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi”, neni 12 dhe Urdhrin Nr. 84 datë 06.06.2011.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 15: Ministria e Brendshme në Maj të vitit 2021, me mbështetjen e IOM, institucionet shqiptare dhe INSTAT hartuan një Udhërrëfyes Kombëtar për Statistikat e Migracionit. INSTAT informon se gjatë vitit 2021 u iniciua puna për standardizimin e formateve të të dhënave administrative në përputhje me rregulloren e EUROSTAT 862/2007. Gjithashtu është përgatitur dhe një Udhërrëfyes për Statistikat e Migracionit në Shqipëri. Në vazhdim të standardizimit të të dhënave administrative janë hartuar formate tabelash dhe janë dërguar në institucionet përkatëse (MB/ Ministria e Brendshme dhe DKM/Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit) me shkresë zyrtare. Ministria e Financave nuk paraqet te dhëna për ndjekjen e këtij rekomandimi si dhe nga të informacioni i INSTAT nuk rezulton te këtë korrespondencë shkresore mbi standardin e ri të tabelave statistikore të hartuara prej saj.

Bashkëpunimi ndërinstitutional kërkon një standard të unifikuar për çdo institucion raportues.

Rekomandimi nr.15: MB dhe MFE në bashkëpunim me INSTAT, të formatizojnë formatet tip të të dhënave administrative dhe statistikore në funksion të hartimit të saktë të Profilit të Migracionit dhe Strategjisë Kombëtare të Migracionit si dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare të raportimeve të fushës.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje nr. 16: Gjatë këtij auditimi rezultoi se MB do të përmirësoje sistemin FER-TIMS, i cili me modulet e reja që do të zhvillohen mund të mundësojnë që këto evidenca të jenë të aksesueshme edhe nga INSTAT.

Rekomandimi nr. 16: Në funksion të identifikimit dhe kryqëzimit të informacionit në kohë reale INSTAT, të krijojë strukturat lidhëse për të kryer testime në pikat kufitare, me qëllim etiketimin e motivacioneve të largimit të shtetasve Shqiptarë nga vendi.

Afati: Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 17: Në lidhje me vetëregjistrimin e emigranteve, sipas dokumentacionit që na është vene në dispozicion nuk rezulton që Ministria e Brendshme të ketë bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme sipas rekomandimit tonë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

Rekomandimi nr. 17: MB në bashkëpunim me strukturat e MPJ të hartoj dhe miratoj aktet në zbatim të Ligjit nr. 14/2016 Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Afati: Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 18: Në zbatim të projektit "Përmirësimi i kuadrit të migrimit për punë në Shqipëri", financuar nga Fondi i IOM për Zhvillim dhe projektit rajonal IPA II "*Mbështetje Rajonale për Menaxhimin e Migracionit me fokus të mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*", financuar nga BE, rezulton se ende nuk është saktësuar tipologjia e mbledhjes, raportimit dhe afateve të të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësisë në Profillin e Migracionit

Rekomandimi nr. 18: MFE në bashkëpunim me SHKP dhe INSTAT të hartojnë Memorandume bashkëpunimi, për të saktësuar tipologjinë e mbledhjes, raportimit dhe afateve të të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësisë në Profillin e Migracionit.

Afati: Brenda vitit 2021

Gjetje nr.19: Në nivel kombëtar, ende nuk ka një standard të miratuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të migracionit dhe azilit, kjo në përputhje edhe me Rregulloren 862/2007 dhe udhëzimet e EUROSTAT, mbi statistikave pasqyrë.

Rekomandimi nr.19: INSTAT duke marrë parasysh eksperiencat e vendeve të tjera, të vlerësoj mënyra të reja për matjen e migracionit, si ajo e kryerjes së anketave specifike dhe përdorimin e statistikave pasqyrë.

Afati: Brenda 6 mujorit të dytë të 2022 dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 20: INSTAT është në proces miratimi të një memorandumi të ri me DPGJC, ku pjesë e këtij memorandumi do të jetë dërgimi i të dhënave për shtetasit shqiptarë me vendbanim jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në përmirësimin e të dhënave mbi migracionin në përgjithësi.

Rekomandimi nr. 20: INSTAT në funksion të përdorimit të informacionit real, të bashkëpunoj me MB për hartimin e modaliteteve të përdorimit të sistemit të përbashkët të të dhënave mbi popullsinë dhe migrantët duke zbatuar njëherësh edhe rolin e saj koordinues për Sistemin Kombëtar të Statistikave në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin prej nenit 13 të Ligjit nr. 17/2018 Për statistikave zyrtare.

Afati: Brenda vitit 2022 dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 21: Ministria e Brendshme në Maj të vitit 2021, në bashkëpunim me INSTAT dhe institucionet e tjera përgjegjëse ka hartuar një Udhërrëfyes Kombëtar për Statistikat e Migracionit, i cili synon të përmirësojë ndjeshëm mbledhjen e të dhënave kombëtare. Dokumenti pritet të shërbejë për saktësinë e të dhënave të migrimit, sistematizimin dhe harmonizimin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Rekomandimi nr. 21: INSTAT bashkëpunim me MB të hartojnë programe dhe metodologji mbi shkëmbimin e të dhënave midis vendeve pritëse të emigrantëve shqiptar si dhe të përgatiten procedurat për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara.

Brenda vitit 2021 dhe në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

II. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFICIENCA E ENERGJISË”

PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në *Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë* dhe *Agjencinë për Eficiencën e Energjisë*, mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2020”, për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën e KLSH-së me nr. 754/3 prot, datë 05.07.2021, lidhur me auditimin e performancës me temë “Eficienca e Energjisë” kryer në vitin 2020, sipas raportit përfundimtar përcjellë me shkresën Nr. 49/5 prot., datë 30.10.2020, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- g. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- h. Nxjerrjen nga titullari i njësive publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- i. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar për njohje në KLSH, planin e veprimit nëpërmjet shkresës Nr. 3801/5 datë 31.12.2020, duke mos respektuar afatin 20 ditor të parashikuar.

- Agjencia për Eficiencën e Energjisë, nuk ka dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna duke mos respektuar në këtë mënyrë afatin 20 ditor të parashikuar.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjekteve të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

Nga subjektet e audituar, brenda afatit 6-mujor nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 49/5 prot, datë 30.10.2020, janë rekomanduar gjithsej:
b. Janë rekomanduar **42 masa** me karakter organizative.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	42	42	0

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 5451/1 prot, datë 07.07.2021 dhe njoftimit “Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve” nr. 754/3 prot., datë 05.07.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. E. K. Përgjegjës grupi
2. E. K. Anëtar

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 49/5 prot, datë 30.10.2020 për Ministrinë e Infrastrukturës së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar MIE dhe AEE, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën me shkresën nr. 49/5 prot, datë 30.10.2020, rezulton se nga **42** masa të rekomanduara (*masa organizative*), nga subjekti janë pranuar **42** masa ose në masën **100 %**.

Nga **42** masa të rekomanduara (masa organizative), nga subjekti janë pranuar **42** masa ose në masën 100 %. Nga 42 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **9** masa ose 21.43 % e tyre, janë në proces zbatimi **13** masa ose 30.95% dhe janë pa zbatuar **20** masa ose 47.62%. Nga sa shihet niveli i realizmit është i ulët ose në masën 21.43%, fakt i cili dëshmon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa Organizative	42	9	0	13	20

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE :

Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është 21 %, rekomandimet në proces zbatimi zënë rreth 31%, peshën më të madhe e zënë rekomandimet e pa zbatuara 48%. Mosrespektimi i afateve për rekomandimet e lëna, mund të ketë arsye objektive për shkak të miratimit sipas shkallës së hierarkisë, por në shumë raste varen nga vendimmarrja e subjekteve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi Nr.1 : Ministri i MIE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Afati: Dhjetor 2020

Grupi i auditimit: Subjekti i audituar MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin mbështetës.

Statusi : I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 2 : Drejtori i Përgjithshëm i AEE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Afati: Dhjetor 2020

AEE: AEE ka nisur procesin e hartimit Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr. 3 : MIE në bashkëpunim me AEE të marrë masa për hartimin dhe propozimin në Këshillin e Ministrave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes.

Afati: Dhjetor 2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MIE dhe AEE: MIE në bashkëpunim me AEE, morën masa për hartimin dhe miratimin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1094, datë 24.12.2020 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”.

Statusi : Zbatuar

Rekomandimi Nr.4: MIE të marrë masa për miratimin e “Programit Kompjuterik” bazuar në konceptet kryesore të MKLL.

2 muaj pas miratimit me VKM të MKLL

MIE: MIE nuk ka marrë masa për miratimin e Programit Kompjuterik edhe pse MKLL është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1094, datë 24.12.2020 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandim Nr.5: MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave “Procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modelin, përmbajtjen e kushteve të regjistrimit të certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave”.

Afati: Dhjetor 2020

MIE: Është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 958, datë 2.12.2020 “Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave”.

Statusi: Zbatuar

Rekomandim Nr.6 : MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi referuar Ligjit 116/2016 Për performancën e energjisë së ndërtesave, neni 4 pika 6.

Afati: Dhjetor 2020

MIE: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin mbështetës.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandim Nr.7: MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave “Kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave”.

Afati: Dhjetor 2020

MIE: Me propozimin e MIE është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave”.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi Nr.8 : MIE të marrë masa për të hartuar Strategjinë e Rinovimit të Ndërtesave Publike.

Afati: Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MIE: Referuar Urdhrit të Kryeministrit Nr. 52/2019, i cili parashikon krijimin dhe funksionimin e Komitetit Ndërmëtor të Energjisë dhe Klimës, me qëllim hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP), që mbulon periudhën dhjetë-vjeçare duke filluar nga 2021 deri në 2030, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e mbështetur nga Qeveria Gjermane (GIZ) dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në përmbushjen e mekanizmit të qeverisjes, po zhvillon planin kombëtar të integruar të energjisë dhe klimës (NECP), në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1999) dhe detyrimet e vendit për të zbatuar Marrëveshjen e Parisit dhe Rekomandimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2018/01 / MC-EnC, që pritet të miratohet në fund të vitit 2021.

Nëpërmjet miratimit të këtij plani do të vijohet në zbatim të tij me hartimin e Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave Publike, Planin Kombëtar për Rritjen e Ndërtesave me Performancë “afër zero energji” dhe ngritjen e një baze të dhënash kombëtare të përditësuar, lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtet në kursimin e saj. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe afateve të plotësimit të rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi nga subjekti.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.9: MIE të marrë masa për hartimin e Planit Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë “afër zero energji”, pjesë e PVKEE.

Afati: Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme

Grupi i auditimit: Subjekti i audituar nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin mbështetës.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.10: MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave “Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”

Afati: Dhjetor 2020

MIE: MIE është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 934, datë 25.11.2020 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi Nr.11: MIE të miratojë Rregulloren e hartuar nga AEE për Formatin e auditimit energjetik.

Afati: Tetor 2020

MIE: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka nxjerrë Urdhrin Nr. 5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores, për formatin e auditimit energjetik dhe pagesën e audituesit energjetik”.

Statusi: Zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi Nr.12: Ministri i MIE të miratojë udhëzimin mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit, mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 124/2015 “Për eficientë e energjisë”, Neni 15, pika 2 dhe 3.

Afati: Dhjetor 2020

MIE: MIE në bashkëpunim me AEE-në është në proces hartimi të Udhëzimit “Për miratimin e llojit dhe periodicitetin e informacionit”.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.13: AEE të marrë masat në ngritjen e një baze të dhënash kombëtare të përditësuar lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjen në kursimin e saj.

Afati: Në vazhdimësi

AEE dhe MIE: AEE dhe MIE në kuadër të projektit Open Regional Found for South-East Europe (ORF-EE) kanë qenë përfutuese të një programi i cili përdoret në disa vende të Evropës dhe Ballkanit që do të shërbejë si një data-bazë për grumbullimin e të dhënave. Nëpërmjet këtij programi të quajtur Monitoring and Verification Platform (MVP), Bashkitë dhe Konsumatorët e Mëdhenj do të raportojnë për Konsumin final të energjisë si dhe arritjet në kursimin final të ardhura nga implementimi i masave të eficientës energjetike. AEE është në fazën e përgatitjes së trajnimeve për punonjësit e Njësive të Qeverisjes Vendore dhe konsumatorët e mëdhenj të cilët do të duhet të trajnohen për përdorimin e programit.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.14: AEE të hartojë dhe të propozojë për miratim në MIE Udhëzimin për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

Afati: Dhjetor 2020

AEE: Mungesa e burimeve njerëzore ka cënuar procesin e hartimit të udhëzimit për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.15: AEE të monitorojë zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe PKVEE-ve pasardhëse.

Afati: Në vazhdimësi

AEE: AEE nuk ka dhënë informacion në lidhje me monitorimin e zbatimit të PKVEE 2017-2020. AEE është duke u punuar për hartimin e PKVEE së re e cila do të jetë një plan i integruar mes Planit Kombëtar të Veprimt për Eficencën e Energjisë dhe Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës. Në përfundim të këtij procesi AEE do të fillojë monitorimin e zbatimit të planit të ri.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.16: Ministri i MIE të miratojë një urdhër të veçantë mbi formën dhe shpeshësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE-ve.

Afati: Tetor 2020

MIE: MIE në bashkëpunim me AEE-në është në proces hartimi të Udhëzimit mbi formën dhe shpeshësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE-ve. Dokumenti i paraqitur është draft i pa miratuar akoma.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.17: Ministri i MIE të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe çdo vit për PKVEE-ve pasardhëse.

Afati: Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.18: Pas miratimit të VKM të MKLL-se dhe certifikimit të audituesve energjetike AEE të marrë masa për vënien në zbatim të plotë të ligjit nr. 124/2015 “Për Eficencën e Energjisë” dhe ligjit nr.116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” me qëllim realizimin e auditimeve energjetike.

Afati: Në vazhdimësi

AEE: AEE ka marrë masa për procesin e certifikimit të Performancës së Energjisë në Ndërtesa dhe Auditimin Energjetik. Për periudhën 2016-2019 nuk është bërë certifikimi për asnjë auditues energjetik.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.19: Pas përcaktimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, AEE të shikojë mundësinë për lidhjen e marrëveshjes vullnetare me ta.

Afati: Në vazhdimësi

AEE: AEE ka përcaktuar gjatë vitit 2020 Listën e Konsumatorëve të Mëdhenj të Energjisë dhe ka marrë raportimet e para të konsumeve vjetore. Por me ndryshimet e reja në Ligjin 124/2015, është ulur pragu i konsumit vjetor për klasifikimin si Konsumator të Mëdhenj. AEE megjithëse ka përcaktuar Listën e Konsumatorëve të Mëdhenj të Energjisë nuk ka lidhur ende asnjë marrëveshje vullnetare.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.20: AEE të ndërmarrë masa për vënien në zbatim të faturave të energjisë që përmbajnë krahasime në forme grafike mbi konsumin e vitit aktual me atë të mëparshëm, këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, numrin jeshil pa pagesë.

Afati: Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi

AEE: AEE ka realizuar një procedurë prokurimi me objekt “Projekt faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimit dhe trajnimit për Eficencën e Energjisë”. Është nënshkruar kontrata e cila është në fazë zbatimi me një afat realizimi 7 muajor.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.21: AEE të ndërmarrë fusha ndërgjegjësimi duke informuar konsumatorët fundore për metodat dhe praktikën e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

AEE: AEE ka realizuar një procedurë prokurimi me objekt “Projekt faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimit dhe trajnimit për Eficiencën e Energjisë”. Është nënshkruar kontrata e cila është në fazë zbatimi me një afat realizimi 7 muaj.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.22: AEE të marrë masa për të organizuar trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxheret e energjisë mbi legjislacionin për eficiencën e energjisë.

Afati: Mars 2021 dhe në vazhdimësi

AEE: AEE ka realizuar një procedurë prokurimi me objekt “Projekt faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimit dhe trajnimit për Eficiencën e Energjisë”. Është nënshkruar kontrata e cila është në fazë zbatimi me një afat realizimi 7 muaj.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr. 23 : AEE të realizojë sondazhe mbi të dhënat e konsumit të energjisë në sektorët rezidenciale, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.

Afati: Mars 2021 dhe në vazhdimësi

AEE: AEE është duke hartuar një plan pune për finalizimin e një marrëveshje bashkëpunimi me INSTAT me qëllim përmbushjen e rekomandimit.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.24: AEE të marrë masa për të iniciuar ndryshime në strukturën organizvative të saj duke krijuar një sektor të posaçëm lidhur me informacionet dhe statistikatat.

Afati: Dhjetor 2020

AEE: Me Urdhërin e Kryeministrit, Nr. 38, datë 17.03.2021, është miratuar struktura e re e AEE e cila ka në përbërjen e saj Sektorin e Programeve të Eficiencës dhe Analizës. Ky sektor ka pjesë përbërëse kryesore të funksioneve tij grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e informacioneve dhe statistikave.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi Nr. 25 : AEE të marrë masa për përfshirjen në strukturën e saj të nëpunësve të autorizuar në përputhje me Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 13 pika 3.

Afati: 6 muaj pas procesit të parë të certifikimit të audituesve energjetikë

AEE: AEE i ka propozuar Ministrit emërimin e Nëpunësve të Autorizuar, me shkresën Nr. 980, datë 19.05.2021. , dhe Ministri përgjegjës për Energjinë ka emëruar nëpunësit e Autorizuar në zbatim të Ligjit 116/2016.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi Nr. 26: AEE të marrë masa për aplikimin e kundërvajtjeve administrative referuar Ligjit 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, neni 26 pika 1 dhe Ligjit 116/2016 , Për performancës e energjisë së ndërtesave, Neni 15 pika 1, pasi të gjenerohen “Certifikatat e Performancës së Energjisë në Ndërtesa” nga audituesit energjetikë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Afati: Në vazhdimësi

AEE: AEE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.27: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE të kostoje aktivitetet që duhet të ndërmerren në përmbushje të objektivave të parashikuar në SKE dhe PKVEE për eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2020

AEE: AEE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.28: Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor(DEMPB) të Energjisë të trajtojnë në mënyrë të detajuar në raportet vjetore të monitorimit që përgatit për realizimin e buxhetit shkaqet dhe përgjegjësit për mosrealizimin në çdo rast.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.29: MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar buxhetimin faktik për eficiencën e energjisë, në mbështetje të aktiviteteve të kostuara për të garantuar përmbushjen e objektivave të SKE dhe PKVEE.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 30: MIE të të ndërmarrë masat e nevojshme për realizimin e buxhetit të eficiencës së energjisë në përputhje me buxhetin faktik.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.31: Drejtuesi i Ekipit të Projekteve të Energjisë të përgatitë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit me shifra dhe narrativ, për vitin 2019.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi Nr.32: AEE në bashkëpunim me MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të kostuar aktivitetet që ky institucion duhet të kryejë, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

Afati: Dhjetor 2020

MIE dhe AEE: Kostimi i aktiviteteve që duhet të ndërmerren në përmbushje të objektivave të parashikuara në SKE dhe PKVE për eficiencën e energjisë, në kuadër të financimeve nëpërmjet Planit Buxhetor Afatmësëm 2019-2021, MIE në bashkëpunim me AEE ka realizuar disa projekte (të kostuar në PBA) për përmbushjen e objektivave sa më sipër, të cilat janë evidentuar në Raportin e Monitorimit të zbatimit të Buxhetit.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi Nr.33: MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të alokuar buxhetin për AEE, mbështetur në rezultatet e kositimit të aktiviteteve, me qëllim funksionimin e plotë të AEE.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjegjës në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.34: Ministri i MIE të propozojë pranë Këshillit të Ministrave për miratim projekt vendimin “Për krijimin e Fondit për Eficiencën e Energjisë”.

Afati: Dhjetor 2020

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjegjës në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.35: MIE në përmbushje të rekomandimit të dhënë në SKE 2018-2030, të ndërmarrë masat e nevojshme për të aplikuar instrumentet financiare, me qëllim nxitjen e investimeve në eficiencën e energjisë.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjegjës në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr.36: MIE në bashkëpunim me AEE të sigurojë të dhëna të sakta mbi sipërfaqet totale të ndërtesave publike të rikonstruara gjatë periudhës 2016-2019 dhe në vazhdim lidhur me eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2020

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjegjës në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi Nr. 37: MIE të marrë masa për të përcaktuar një maksimum të periudhës së vetëshlyrjes për aprovimin/miratimin e projekteve/investimeve në eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2020

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 38: MIE të marrë masa që çdo project/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar objektiva që lidhen me çmimin njësi për energji të kursyer.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 39: MIE të marrë masa që çdo project/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar në kushtet kontraktuese realizimin e auditimeve energetike para dhe pas rinovimit të ndërtesave.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 40: MIE të marrë masa për zbatimin e termave të referencës së çdo projekti të cilin realizon.

Afati: Në vazhdimësi

Grupi i auditimit: MIE nuk është përgjigjur në lidhje me rekomandimin e lënë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues.

Statusi: I pa zbatuar

Rekomandimi Nr. 41: Pas miratimit të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes (MKLL) së performancës së energjisë në ndërtesa dhe certifikimit të audituesve të certifikuar të MIE (në rolin e Autoritetit Kontraktor) dhe AEE në rolin e Institucionit të “Përdoruesit” të këtij sistemi të bashkëpunojë për vendimin në përdorim të tij.

Afati: 3 muaj pas miratimit me VKM të MKLL dhe certifikimit të audituesve të energjisë
MIE dhe AEE: Software PEN është vendosur në përdorim që prej muajit Janar 2021.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi Nr. 42: MIE të kërkojë nga kontraktori realizimin e trajnimeve për stafin që do të përdorë Software PEN.

Afati: Dhjetor 2020

MIE: Stafi i AEE është trajnuar gjatë vitit 2020 për përdorimin e software PEN.

Statusi: Zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

IV KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të afatit për kthimin e përgjigjes në KLSH konstatohet se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë, nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditë të kthimit të përgjigjes sipas ligjit 154/2014.

Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se MIE dhe AEE, nuk e kanë përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit në KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar MIE dhe AEE, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën me shkresën nr. 49/5 prot, datë 30.10.2020 , rezulton se nga **42 masa** të rekomanduara (masa organizative), nga subjekti janë pranuar **42 masa** ose në masën 100 %. Nga 42 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **9 masa** ose 21.43 % e tyre, janë në proces zbatimi **13 masa** ose 30.95% dhe janë pa zbatuar **20 masa** ose 47.62%. Nga sa shihet niveli i realizimit është i ulët ose në masën 21.43%, fakt i cili dëshmon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Duke parë përpjekjet e pamjaftueshme të subjekteve në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëna, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Gjetje nr. 2 : MIE nuk ka Rregullore të Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Rekomandimi Nr. 2; MIE të nisë procedurën për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të institucionit.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr.3 : AEE nuk ka Rregullore të Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Rekomandimi Nr. 3: Drejtori i Përgjithshëm i AEE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr.4 Për periudhën 2016-2019 MIE nuk ka miratuar “Programin kompjuterik” bazuar në konceptet kryesore të MKLL.

Rekomandimi Nr.4: MIE të marrë masa për miratimin e “Programit Kompjuterik” bazuar në konceptet kryesore të MKLL.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 5 Kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi i Ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” neni 4 pika 6 nuk janë miratuar me VKM.

Rekomandim Nr. 5: MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi referuar Ligjit 116/2016 Për performancën e energjisë së ndërtesave, neni 4 pika 6.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 6: MIE nuk ka hartuar ende Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi Nr. 6: MIE të marrë masa për të hartuar Strategjinë e Rinovimit të Ndërtesave Publike në vijim procesit të nisur.

Afati: Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme

Gjetje Nr.7: Për periudhën 2016-2019 MIE nuk ka miratuar Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji, si pjesë e PVKEE.

Rekomandimi Nr. 7.1: MIE të marrë masa për hartimin e Planit Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë afër zero energji, pjesë e PVKEE.

Afati: Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme

Gjetje Nr. 8: Ministri i MIE nuk ka miratuar Udhëzimin mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit të bërë në Ligjin 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 15 pika 2 dhe 3.

Rekomandimi Nr. 8.1: Ministri i MIE të miratojë udhëzimin mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit, mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 124/2015 “Për eficiencë e energjisë”, Neni 15, pika 2 dhe 3.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 9: AEE nuk ka hartuar dhe propozuar për miratim në MIE, Udhëzimin për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

Rekomandimi Nr.9: AEE të hartojë dhe të propozojë për miratim në MIE Udhëzimin për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

Afati: Nëntor 2021

Gjetje nga auditimit nr. 9.1: AEE dhe MIE në kuadër të projektit Open Regional Found for South-East Europe (ORF-EE) kanë qenë përfutuese të një programi i cili përdoret në disa vende të Europës dhe Ballkanit që do të shërbejë si një data-bazë për grumbullimin e të dhënave. Nëpërmjet këtij programi të quajtur Monitoring and Verification Platform (MVP), Bashkitë dhe Konsumatorët e Mëdhenj do të raportojnë për Konsumin final të energjisë si dhe arrijtjet në kursimin final të ardhura nga implementimi i masave të efikasitetit energjetike. AEE është në fazën e përgatitjes së trajnimeve për punonjësit e Njësive të Qeverisjes Vendore dhe konsumatorët e mëdhenj të cilët do të duhet të trajnohen për përdorimin e programit.

Rekomandimi Nr. 9.2: AEE të marrë masat në ngritjen e një baze të dhënash kombëtare të përditësuar lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtjen në kursimin e saj.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 10: AEE nuk ka monitoruar zbatimin e PKVEE 2017-2020.

Rekomandimi Nr.10: AEE të monitorojë zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe PKVEE-ve pasardhëse.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 11: Ministri i MIE nuk ka miratuar një Urdhër të veçantë mbi formën dhe shpeshësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE 2017-2020

Rekomandimi Nr.11.1: Ministri i MIE të miratojë një urdhër të veçantë mbi formën dhe shpeshësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE-ve.

Afati: Tetor 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje Nr. 12: Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE 2017-2020.

Rekomandimi Nr.12: Ministri i MIE të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe çdo vit për PKVEE-ve pasardhëse.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 13: Deri më sot në Shqipëri nuk është bërë asnjë auditim energjetik dhe nuk është lëshuar asnjë certifikatë e performancës së energjisë në përputhje me Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Rekomandimi Nr.13: AEE të marrë masa lidhur me procesin e certifikimit të Performancës së Energjisë në Ndërtesa dhe Auditimin Energjetik.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 14: Deri më sot nuk është lidhur asnjë marrëveshje vullnetare midis AEE dhe Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë (KME).

Rekomandimi Nr.14.1: AEE të konsiderojë mundësinë për lidhjen e marrëveshjes vullnetare me konsumatorët e mëdhenj të energjisë.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 15: AEE nuk ka finalizuar ende procesin për vënien në zbatim të faturave të energjisë që përmbajnë krahasime në formë grafike mbi konsumin e vitit aktual me atë të mëparshëm, këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, numrin jeshil pa pagesë.¹

Rekomandimi Nr.15.1: AEE të marrë masa për vënien në zbatim të faturave të energjisë që përmbajnë krahasime në formë grafike mbi konsumin e vitit aktual me atë të mëparshëm, këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, numrin jeshil pa pagesë.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr.16: AEE nuk ka ndërmarrë ende fushata ndërgjegjësimi dhe nuk ka informuar konsumatorët fundorë për metodat dhe praktikën e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.

Rekomandimi Nr.16.1: AEE të ndërmarrë fusha ndërgjegjësimi duke informuar konsumatorët fundorë për metodat dhe praktikën e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 17: AEE nuk ka organizuar trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficientësinë e energjisë, si dhe për masat për implementimin e këtij legjislacioni.

Rekomandimi Nr. 17.1: AEE të marrë masa për të organizuar trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficientësinë e energjisë.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 18: AEE nuk ka kryer sondazhe mbi të dhënat e konsumit të energjisë në sektorët rezidencialë, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.

¹ PKVEE 2017-2020, fq 110.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi Nr. 18.1 : AEE të konsiderojë mundësinë e lidhjes së marrëveshjes me INSTAT, me qëllim realizimin e sondazheve mbi të dhënat e konsumit të energjisë në sektorët rezidenciale, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 19: AEE gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka aplikuar asnjë kundërvajtje administrative referuar Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 26 pika 1 dhe Ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 15 pika 1.

Rekomandimi Nr. 19.1: AEE të marrë masa për aplikimin e kundërvajtjeve administrative referuar Ligjit 124/2015 Për eficiencën e energjisë, neni 26 pika 1 dhe Ligjit 116/2016 , Për performancës e energjisë së ndërtesave, Neni 15 pika 1, pasi të gjenerohen “ Certifikatat e Performancës së Energjisë në Ndërtesa” nga audituesit energjetikë.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 20: Fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit për periudhën 2018-2019 janë rreth 14 herë më pak se fondet e nevojshme për të zbatuar aktivitetet e parashikuara për EE në Strategjinë Kombëtare të Energjisë deri në vitin 2020².

Rekomandimi Nr. 20.1: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE të kostoje aktivitetet që duhet të ndërmerren në përmbushje të objektivave të parashikuara në SKE dhe PKVEE për eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 21: Niveli i realizimit të fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit për EE, për vitin 2017, ishte 19%. Subjekti nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë pikë.

Rekomandimi Nr.21.1: Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor(DEMPB) të Energjisë të trajtojnë në mënyrë të detajuar në raportet vjetore të monitorimit që përgatit për realizimin e buxhetit shkaqet dhe përgjegjësit për mosrealizimin në çdo rast.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 22: Në 2018, fondet e alokuara për eficiencën e energjisë ishin rreth 53% më pak se fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit. %. Subjekti nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë pikë.

Rekomandimi Nr.22.1: MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar buxhetimin faktik për eficiencën e energjisë, në mbështetje të aktiviteteve të kostuara për të garantuar përmbushjen e objektivave të SKE dhe PKVEE.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 23: Për vitin 2019, grupi i auditimit arriti të analizojë vetëm nivelin e realizimit të financimeve të brendshme, i cili ishte në nivelin 58%. Subjekti nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë pikë.

Rekomandimi Nr. 23.1: MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për realizimin e buxhetit të eficiencës së energjisë në përputhje me buxhetin faktik.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 24: Në qershor 2020, MIE ende nuk ka të dhëna zyrtare mbi nivelin e realizimit të financimeve të huaja për projektet në EE gjatë vitit 2019.³ Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit

² Shënim i G.A: Në këtë llogaritje nuk është përfshirë viti 2020.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

Financiar, ende nuk ka marrë të informacione nga Drejtuesi i Ekipit të Projekteve të Energjisë mbi nivelin e realizimit të buxhetit për fondet e huaja, për vitin 2019. Subjekti nuk ka dhënë informacion lidhur me këtë pikë.

Rekomandimi Nr. 24: Drejtuesi i Ekipit të Projekteve të Energjisë të përgatitë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit me shifra dhe narrativ, për vitin 2019.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 25: Në vitin 2017 nuk janë alokuar fonde për AEE, megjithëse ky institucion është krijuar në vitin 2016⁴. Subjekti nuk ka dhënë informacion në lidhje me këtë pikë.

Rekomandimi Nr. 25.1: AEE në bashkëpunim me MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të kostuar aktivitetet që ky institucion duhet të kryejë, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

Afati: Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 26: Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i alokuar për AEE është rreth 55% më pak se buxheti i nevojshëm për funksionimin e plotë të këtij institucioni, referuar PKVEE 2017-2020. Subjekti nuk ka dhënë informacion në lidhje me këtë pikë.

Rekomandimi Nr.26.1: MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të alokuar buxhetin për AEE, mbështetur në rezultatet e kostimit të aktiviteteve, me qëllim funksionimin e plotë të AEE.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 27: Fondi i Eficiencës së Energjisë i parashikuar në Ligjin nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" Kreu V, nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar ndonjëherë.

Rekomandimi Nr. 27: Ministri i MIE të propozojë pranë Këshillit të Ministrave për miratim projekt vendimin "Për krijimin e Fondit për Eficiencën e Energjisë".

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 28: Në vendin tonë, përveç granteve, nuk është aplikuar asnjë instrument tjetër financiar për të mbështetur investimet në Eficiencën e Energjisë.

Rekomandimi Nr.28: MIE në përmbushje të rekomandimit të dhënë në SKE 2018-2030, të ndërmarrë masat e nevojshme për të aplikuar instrumentet financiare, me qëllim nxitjen e investimeve në eficiencën e energjisë.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 29: MIE nuk ka të dhëna mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rikonstruktuar gjatë periudhës 2016-2019 lidhur me eficiencën e energjisë.

Rekomandimi Nr. 29 MIE në bashkëpunim me AEE të sigurojë të dhëna të sakta mbi sipërfaqet totale të ndërtesave publike të rikonstruktura gjatë periudhës 2016-2019 dhe në vazhdim lidhur me eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2021

³ Udhëzimi standard nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe Udhëzimi Nr. 22 datë 17/11/2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit.

⁴ VKM nr. 852 dt. 07.12.2016 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje Nr. 30: MIE nuk ka të përcaktuar një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin e investimeve në eficiencën e energjisë.

Rekomandimi Nr. 30: MIE të marrë masa për të përcaktuar një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin/miratimin e projekteve/investimeve në eficiencën e energjisë.

Afati: Dhjetor 2021

Gjetje Nr. 31: Projekti GALET nuk ka të përcaktuar objektiva që lidhen me çmimin njësi për energji të kursyer.

Rekomandimi Nr. 31: MIE të marrë masa që çdo projekt/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar objektiva që lidhen me çmimin njësi për energji të kursyer.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 32: Në projektin GALET nuk është realizuar auditim energjetik pas rinovimit të tre godinave (Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastrë, Biblioteka Korçë) sepse nuk ka qenë e detyrueshme në kushtet kontraktuese.

Rekomandimi Nr. 32: MIE të marrë masa që çdo projekt/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar në kushtet kontraktuese realizimin e auditimeve energjetike para dhe pas rinovimit të ndërtesave.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje Nr. 33: Struktura menaxhuese e projektit “Auditimi energjetik i stokut të ndërtesave publike” nuk është krijuar në përputhje me termat e referencës.

Rekomandimi Nr. 33: MIE të marrë masa për zbatimin e termave të referencës së çdo projekti të cilin realizon.

Afati: Në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

III. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I PROCESIT TË DEINSTITUCIONALIZIMIT DHE DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE ME FOKUS FËMIJËT JETIM”

PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ushtroi auditim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e parë të vitit 2020”, për auditimin e kryer në vitin 2020, periudha 01.01.2016- 01.01.2019 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 8/4 prot., datë 13.05.2020 (administruar në subjekt me nr. 8/10 prot., datë 30.10.2020), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse.
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative.
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezultoi se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të shkronjës “j”, të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

- MSHMS dhe SHSSH janë informuar me shkresën nr. 8/10 prot., datë 30.10.2020 dhe kanë kthyer përgjigje me shkresën nr. 42/6 prot., datë 19.11.2020 duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna për MSHMS-në dhe SHSSH me shkresën nr. 8/10 prot., datë 30.10.2020, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga ana e strukturës përgjegjëse në MSHMS është përgatitur informacioni mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, (referuar e-mailit zyrtar dhjetor 2020), por ky raport nuk ka ndjekur rrugën e mëtejshme të miratimit zyrtar nga instancat superiore dhe nuk është përcjellë zyrtarisht në KLSH. Nga subjektet e audituara, brenda afatit 6-mujor nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 8/10 prot., datë 30.10.2020 dhe në MSHMS me nr. 42/5 prot., datë 30.10.2020, janë rekomanduar gjithsej **19 masa** nga të cilat:

c. Janë rekomanduar **4 masa për përmirësim ligjor.**

d. Janë rekomanduar **15 masa organizative.**

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për përmirësim ligjor	4	4	-
2	Organizative	15	15	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 67, datë 23.06.2020 (nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020).

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 754/5, prot., datë 05.07.2021 dhe njoftimit “Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve” nr. 754/2 prot., datë 05.07.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. M. L. (Përgjegjës grupi)

2. A. G. Anëtar

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 8/10 prot., datë 30.10.2020, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti MSHMS, SHSSH, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 8/10, datë 30.10.2020, rezulton se nga **19** masa të rekomanduara (*përmirësim ligjor, organizative*), janë pranuar nga subjekti **19** masa ose në masën 100%. Nga 19 masa të pranuar janë zbatuar plotësisht **8** masa ose 42.11 %, janë në proces zbatimi **9** masa ose 47.37% dhe janë pa zbatuar **2** masa ose 10.53%. Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 42.11 %, fakt i cili dëshmon se subjektet nuk e kanë vlerësuar drejt procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa për përmirësim ligjor	4	-	-	2	2
2	Masa Organizative	15	8	-	7	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE :

Niveli i zbatimit të rekomandimeve mbi 42% tregon për angazhimin e subjekteve për disa nga masat, por MSHMS dhe SHSSH nuk kanë mundur ndjekjen e procedurave të duhura për realizimin 100% të tyre, si për shkak të epidemisë por edhe të miratimit në strukturat tjera sipas shkallës së hierarkisë.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Në lidhje me respektimin e afatit 20 ditor dhe 6-mujor për informimin dhe raportimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve rezulton se afati 20 ditor është zbatuar dhe KLSH është informuar me shkresën nr. 42/6 protokoll, datë 19.11.2020 për planin e masave mbi rekomandimet dhe me shkresën nr. 515 datë 07.05.2018 raport mbi zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH, ndërsa respektimi i afatit 6-mujor është bërë pjesërisht. Nga ana e strukturës përgjegjëse në MSHMS është përgatitur informacioni mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, (referuar e-mailit zyrtar dhjetor 2020), por ky raport nuk ka ndjekur rrugën e mëtejshme të miratimit zyrtar nga instancat superiore dhe nuk është përcjellë zyrtarisht në KLSH. Për zbatimin e masave rezultoi se: nga **19** masa të rekomanduara gjithsej me shkresën nr. Nr. 8/10 Prot., datë 30.10.2020 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi Nr. 115, datë 30.10.2020, të Kryetarit të KLSH-së, janë marrë në konsideratë dhe realizuar plotësisht **8** masa, janë në proces **9** masa dhe nuk janë realizuar **2** masa, veprim në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c. Një pjesë e rekomandimeve janë lënë përsëri pasi problematikat nuk janë ezauruar për shkak të situatës pandemike.

A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE:

Nga KLSH i janë lënë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 4 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë në proces zbatimi 2 (dy) dhe 2 (dy) të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 1: MSHMS të marrë të gjitha masat e duhura që në zbatim të pikës 29, neni 3 të ligjit 121/2016, të miratojë vendimin për përcaktimin e kritereve për llojet e ndryshme të shërbimeve.

Afati: Menjëherë

Është hartuar drafti i parë i PVKM, jo i miratuar zyrtarisht, mbi kriteret për përcaktimin e tarifave të shërbimeve sociale, draft i cili nuk u dakortësua me grupet e interesit që ofrojnë shërbime sociale. Miratimi i këtij projekt akti është parashikuar në një fazë të dytë, pasi në kuadër të zbatimit të reformës së decentralizimit, eprorët e MSHMS mendojnë që tarifat mund të vendosen në varësi të nevojave për shërbime pranë çdo bashkie.

Nga ana tjetër, me miratimin e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” një kapitull i veçantë është parashikuar për procedurat e prokurimit të shërbimeve sociale. Aktualisht, APP në bashkëpunim me MSHMS është duke draftuar VKM “Për përcaktimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike dhe miratimin e rregullave për prokurimin e tyre”, ku për të përmbushur detyrimin e autoritetit kontraktor për garantimin e cilësisë së shërbimit, bazuar në raportin kosto- efektivitetit, lind detyrimi i përcaktimit të koston për njësi shërbimi, çka do ta bëjë më të lehtë përcaktimin e tarifave të shërbimeve.

Nga MSHMS kërkohet shtyrja e afatit, për realizimin e këtij rekomandimi, për vitin 2022.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 2: MSHMS dhe SHSSH të ndërmarrë të gjitha iniciativat e nevojshme për të rishikuar Ligjin nr. 8153, datë 31 tetor 1996, “Mbi statusin e jetimit”, të ndryshuar, duke reflektuar në të ndryshimet përkatëse në terminologji dhe kriteret e përfitimit të statusit, nisur nga fakti se termi “jetim” nuk përmendet në asnjë dokument ndërkombëtar dhe as në Kodin e Familjes.

Afati: Brenda vitit 2021

Është duke u kryer një analizë ligjore e nënligjore e të gjitha akteve normative që lidhen me statusin e jetimit, si dhe është hartuar drafti i parë për mbi ndryshimin e Ligjit. Nga ana tjetër, me iniciativën e Kryeministrit, në kuadër të nismës për mbështetjen financiare dhe morale që shteti duhet t’i japë fëmijëve të mitur të personave të rënë në krye të detyrës apo edhe që kanë kryer veprime vetëmohimi në mbrojtje të integritetit të vendit, është duke u hartuar projektligji “Statusi i fëmijëve të Republikës”. Ky projektligj ka pikë prerje me ligjin për statusin e jetimit, si dhe ligje të tjera (statusi i dëshmorit, apo për fëmijët e policëve të rënë në detyrë), miratimi i të cilit do të autorizojë ndryshimet e disa ligjeve ekzistuese (të sipërcituara), përfshirë dhe atë të jetimit. Nga MSHMS kërkohet që rishikimi i ligjit të jetimit, të finalizohet në një moment të mëvonshëm, brenda vitit 2022, pasi të jenë qartësuar ndërhyrjet e mundshme që implikon miratimi i projektligjit në fjalë.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 3: MSHMS, në bashkëpunim me NJVQV, të vlerësojë mundësinë e rishikimit të VKM nr. 149, datë 13.03.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje”, sa i takon masës së financimit për familjet kujdestare në varësi të kostove të ndryshme të jetesës në qytete të ndryshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Afati: Qershor 2021

Në kuadrin e rishikimit të gjithë kuadrit ligjor dhe nënligjor të shërbimeve të kujdesit social, në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, si dhe në kuadër të asistencës teknike të projektit IPA II “Përfshirja sociale”, do të merret parasysh propozimi i bërë për suportin buxhetor. Aktualisht ka përfunduar analiza ligjore e ligjit 18/2017 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, si dhe të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, nga UNICEF, në kuadër të reformës së De-I, dokument i cili do të konsultohet me grupet e interesit, ku do të reflektohen sugjerimet, dhe më pas do të hartohet një plan konkret ndërhyrjesh. Nga MSHMS kërkohet shtyrje e afatit të realizimit të rishikimit të mundshëm të VKM 149, brenda vitit 2022.

Statusi: I pazbatuar

Rekomandimi nr. 4: MSHMS të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim rishikimin e VKM nr. 149, datë 13.03.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje”, sa i takon reflektimit të impaktit të inflacionit në masën e financimit për familjet kujdestare.

Afati: Qershor 2021

MSHMS ka hartuar/miratur Udhëzimin Nr. 689/2019 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, i cili shfuqizon udhëzimin e vitit 2012. Ky udhëzim ka marrë parasysh masën e inflacionit të vitit të miratimit. Sqarojmë se ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka përditësuar herë pas here masën e financimit në varësi të indeksit të inflacionit. Nga MSHMS kërkohet shtyrje e afatit të realizimit të këtij rekomandimi, brenda vitit 2022.

Statusi: I pazbatuar

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 15 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 8 (tetë) masa organizative, janë në proces zbatimi 7 (shtatë) masa organizative dhe nuk ka masa të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

Rekomandimi nr. 1: MSHMS, SHSSH dhe NJVQV të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përfshirë fëmijët jetim në proceset e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave/programeve për ta, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor.

Afati: Në vazhdimësi

Politikat dhe reformat institucionale për fëmijët diskutohen dhe merren vendime të rëndësishme në Këshillin Kombëtar për të Drejtat e Mbrojtjes së Fëmijës, ku janë anëtarë përfaqësues të institucioneve publike politikbërës dhe zbatues të tyre, grupet e interesit dhe shoqëria civile, dhe së fundmi me Udhëzimin e ministrit nr. 378, datë 06.05.2019 “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të fëmijëve në Këshillin Kombëtar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, këtij organi organi të lartë këshillimor i janë bashkuar dhe 10 fëmijë, të cilët do të marrin pjesë në çdo mbledhje të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

Këshillit me statusin e vëzhguesit dhe kanë një mandat dy vjeçar. Ata janë zgjedhur nga Qeveritë e Nxënësve dhe grupet e fëmijëve nga organizata të ndryshme.

Konkretisht:

1. Në datën 16 qershor 2021 u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, i cili është pjesë e mekanizmave institucionale përgjegjës për realizimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas Ligjit Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" dhe funksionon sipas Rregullores të miratuar me VKM. Nr. 54, datë 31.01.2018.

Qëllimi i takimit ishte prezantimi platformës së raportimit www.alo116.al për raportimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar, neglizhuar dhe shfrytëzuar. Gjatë vitit të fundit ALO 116111 më mbështetjen e zyrës UNICEF dhe Bashkimit Evropian ka punuar intensivisht për të sjellë dy mekanizma risi për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri, me qëllim raportimin në një formë sa më të sigurt, të shpejtë dhe konfidenciale të rasteve të dhunës, abuzimit dhe çdo shqetësimi që ata përballen.

Në takim morën pjesë edhe fëmijë, të cilët janë zgjedhur sipas pikës 7, nenit 35 të ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Ata marrin pjesë në çdo mbledhje të këtij Këshilli me statusin e vëzhguesit, por në të njëjtën kohë përcjellin zërin e tyre për të gjitha çështjet në lidhje me to.

2. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, është i pari dokument strategjik ku është përcjellë zëri i fëmijëve, që pasqyron sfidat që ata ndeshin në jetën e tyre të përditshme, e që kanë të bëjnë me plotësimin e të drejtave që ju takojnë. Fëmijët vetë kanë shprehur rëndësinë që ka informimi i tyre lidhur me zbatimin e dokumentave strategjike të hartuar, në mbështetje të promovimit dhe garantimit të të drejtave të tyre.

Aktualisht është në proces hartimi draft Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, ku së shpejti do fillojë edhe procesi i konsultimit të këtij dokumenti me grupe të ndryshme interesi, përfshirë dhe fëmijët.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 2: MSHMS dhe SHSSH në bashkëpunim me NJVQV të veprojnë me qëllim ngritjen e sistemit të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore.

Afati: Brenda vitit 2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sqaron se ky objektivi (C1), "Ngritja e sistemit të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore", i parashikuar në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2015-2020, detajohet me një sërë masash, duke filluar nga përcaktimi i politikave të qarta lidhur me reformën e shërbimeve; përcaktimi i detyrave të qarta lidhur me aktorët e reformës, pra përcaktimi i kuadrit institucional; hartimi i një kuadri legjislativ; hartimi i metodologjive dhe instrumenteve (një manual) për planifikimin (planet sociale) e shërbimeve, apo krijimi i Fondit Social, si dhe rregullimi i procedurave të prokurimit të shërbimeve shoqërore.

Konkretisht, bazuar dhe në raportin e monitorimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015-2023, për realizimet e vitit 2020, raport i cili u dakortësua në mbledhjen e IMPG, 30.06.2021, rezulton se:

Gjatë vitit 2020 morën shërbime rreth 16.054 personave në 218 qendrat e kujdesit shoqëror, nga këto 1,708 përfitues në 76 qendrat e përkujdesit shoqëror rezidencial dhe 14 346 përfitues në 147



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

qendrat ditore. Indikatori bazë për 2020 ishte 0.4% kundrejt vlerës bazë prej 0.02% të vitit 2012. Përpjesëtuat me numrin e popullsisë aktuale në Shqipëri (2.829,741), rezulton se ky indikator është arritur në masën 0,56%, duke tejkaluar dhe kufirin bazë të përcaktuar për vitin kalendarik 2020.

Një ndër indikatorët kryesor në këtë objektiv specifik ishte dhe zgjerimi i bashkive që ofrojnë shërbime social komunitare për të paktën tre kategori (PAK, fëmijë vulnerabël dhe të moshuarit). Në pasaportën e indikatorëve, është parashikuar që të ketë një rritje me 5(pesë) bashki që ofrojnë këto shërbime, duke e çuar numrin e tyre nga 10 (Tirana, Durrës, Elbasan, Fier, Sarandë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë, Lushnjë) në 15 bashki. Gjatë vitit 2020, bashkitë që kanë ofruar për herë të parë të paktën tre shërbime të mbrojtjes sociale janë: Bashkia Kavajë, Krujë, Gjirokastrë, Lezhë dhe Berat. Edhe në këtë rast, ky indikator është arritur në masën 100%.

Krahas ofrimit të kujdesit dhe mbrojtjes sociale, një vëmendje e veçantë në strategji i kushtohet dhe rritjes së numrit të fëmijëve që përfitojnë nga planet e deinstitutionalizimit. Për vitin 2020 si vlerë bazë është parashikuar që të përfitojnë 54 fëmijë, nga të cilët:

- 19 fëmijë rikthim në familjen biologjike
- 15 fëmijë në kujdes alternativ
- 15 fëmijë të birësuar
- 5 fëmijë jetesë të pavarur.

Gjatë vitit 2020, nga inspektimet në terren të SHSSH janë identifikuar 114 fëmijë të cilët janë në rrezik për tu ndarë nga familjet biologjike.

Në këtë vit nga IPSH-të publike për fëmijë janë rikthyer në familje biologjike 12 fëmijë dhe 3 persona me AK. Janë birësuar 27 fëmijë nga IPSH publike. Gjithashtu, për shkak të situatës së Covid -19, janë rreth 38 raste (20 djem dhe 18 vajza) për të cilat është shtyrë bashkimi biologjike me familjet e tyre.

Ulja e numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga IPSH publike vjen si rrjedhojë e sistemit të tyre si rast emergjente dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor për t’u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje. Në përmbledhje të të dhënave të mësipërme, vlerësohet se ky indikator është i arritur pjesërisht, me rreth 75% arritje të treguesve bazë.

Në vitin 2020 për herë të parë u shpërnda fondi i parë i financimit të projekteve për ngritjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për 14 bashki.

Në strategji është parashikuar një tendencë në rritje përsa i përket punësimit të punonjësve psiko-social në arsimin para-universitar. Sipas urdhrat të fundit të MASR, parashihet punësimi i një psikologu shkolle ose një punonjësi social për 500-700 nxënës, ndërsa shkollat me më shumë se 700 nxënës duhet të kenë dy psikologë ose punonjës socialë. Një psikolog/punonjës social do të ketë çdo shkollë me të paktën 10 nxënës me aftësi të kufizuara, si dhe çdo shkollë speciale, ndërsa një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla me më pak se 500 nxënës duke ofruar mbështetje psiko-sociale për fëmijët.

Sipas të dhënave të raportuara nga MASR numri punonjësve psiko-social të punësuar, viti shkollor 2019/2020, në institucionet publike para-universitare është 552 persona.

Raporti në momentin që do të marrë formën finale do të publikohet në faqen zyrtare të MSHMS, në linkun e publikimit.

Statusi: Zbatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 3: MSHMS dhe SHSSH në bashkëpunim me NJVQV të marrin masa për të vënë plotësisht në funksionim regjistrin elektronik kombëtar.

Afati: Menjëherë

Duke ju referuar raportimit të monitorimit të SMS, viti 2020, të dhënat e mbledhura tregojnë, së në të 61 bashkitë në nivel vendi, me mbështetjen e UNICEF, i gjithë stafi që punon në shërbimet e mbrojtjes sociale, kanë kryer trajnimet bazë dhe kanë filluar hedhjen e të dhënave dhe trajtimin e rasteve të para përmes SMI.

Edhe pse stafi bazë është trajnuar mbi përdorimin e sistemit dhe ka filluar trajtimi rasteve të para, akoma bashkitë nuk e kanë të mundur të gjenerojnë në mënyrë masive rastet aplikuese.

Nga MSHMS kërkohet shtyrje e afatit për realizimin plotësisht të rekomandimit, brenda 6-mujorit të parë 2022, duke patur parasysh që është dhe një nga indikatorët e projektit IPA II “Përfshirja sociale”, për të përfituar suportin buxhetor.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 4: NJVQV të veprojnë për të miratuar vendimin për tarifat e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Afati: Menjëherë

Është hartuar drafti i parë i PVKM, jo i miratuar zyrtarisht, mbi kriteret për përcaktimin e tarifave të shërbimeve sociale, draft i cili nuk u dakortësua me grupet e interesit që ofrojnë shërbime sociale. Miratimi i këtij projekt akti është parashikuar në një fazë të dytë, pasi në kuadër të zbatimit të reformës së decentralizimit, eprorët e MSHMS mendojnë që tarifat mund të vendosen në varësi të nevojave për shërbime pranë çdo bashkie.

Nga ana tjetër, me miratimin e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” një kapitull i veçantë është parashikuar për procedurat e prokurimit të shërbimeve sociale. Aktualisht, APP në bashkëpunim me MSHMS është duke draftuar VKM “Për përcaktimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike dhe miratimin e rregullave për prokurimin e tyre”, ku për të përmbushur detyrimin e autoritetit kontraktor për garantimin e cilësisë së shërbimit, bazuar në raportin kosto- efektivitetit, lind detyrimi i përcaktimit të koston për njësi shërbimi, çka do ta bëjë më të lehtë përcaktimin e tarifave të shërbimeve.

Nga MSHMS kërkohet shtyrja e afatit, për realizimin e këtij rekomandimi, për vitin 2022.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 5: MSHMS dhe SHSSH të kryejnë një studim me qëllim evidentimin e përfitimeve financiare të deinstitutionalizimit.

Afati: Dhjetor 2020

Grupi teknik i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar draft metodologjinë për vlerësimin e burimeve financiare të shpenzuara për funksionimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror. Vlerësimi në terren nuk ka filluar ende si rezultat i pandemisë Covid 19. Vlerësimi do të fillojë në muajin shtator 2021. Nga MSHMS kërkohet shtyrja e afatit për realizimin plotësisht të rekomandimit, brenda vitit 2022.

Statusi: Në proces zbatimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 6: MSHMS, SHSSH dhe NJVQV të kryejnë analiza financiare dhe të burimeve njerëzore lidhur me deinstitutionalizimin sipas komponentëve të parashikuar nga Udhëzuesi i përbashkët Evropian për kalimin nga kujdesi institucional në kujdesin me bazë komunitare.

Afati: Qershor 2021

Grupi teknik i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar draft metodologjinë për vlerësimin e burimeve aktuale njerëzore për funksionimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror. Vlerësimi në terren nuk ka filluar ende si rezultat i pandemisë Covid 19. Vlerësimi do të fillojë në muajin shtator 2021. Nga MSHMS kërkohet shtyrja e afatit për realizimin plotësisht të rekomandimit, brenda vitit 2022

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 7: MSHMS dhe NJVQV të marrin masa për hartimin e programeve proaktive për rritjen e përgjegjshmërisë prindërore, parandalimin e ndarjes së familjes, mbështetjen e nevojshme financiare të tyre për të garantuar mosbraktisjen e fëmijës, si dhe promovimin e riintegritit të konceptit të familjes.

Afati: Qershor 2021

Grupi teknik i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar draft kurrikulën për prindërimin, e cila do të akreditohet nga QKEV e më pas do të pilotohet në bashkitë Korçë dhe Vlorë. Gjithashtu janë hartuar dhe pilotuar, udhëzimet procedurale për ribashkimin e fëmijës me familjen biologjike, si edhe Modeli i mbështetjes financiare për familjet që kanë fëmijë në IPSH. Të dy dokumentet e hartuar po pilotohen. Procesi do të monitorohet në vazhdimësi.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 8: MSHMS dhe NJVQV të marrin masa për ofrimin e qendrave të këshillimit psiko - social që në maternitet për nënat që rrezikojnë të braktisin fëmijët.

Afati: Brenda vitit 2020

Në strategjinë e re për shëndetin parësor⁵ është parashikuar punësimi i punonjësve social në çdo qendër shëndetësore, ku një nga funksionet është puna me gratë dhe vajzat shtatzëna në rrezik për të braktisur fëmijën/ët. Gjithashtu në maternitet kryesore janë punësuar punonjës socialë të cilët punojnë me gratë dhe vajzat dhe nënat shtatzëna duke ofruar këshillim psiko-social.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 9: MSHMS dhe NJVQV të ndërmarrin fushata agresive sensibilizuese për nxitjen e kulturës së ofrimit vullnetar të familjeve kujdestare të përkohshme por edhe të përhershme.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Grupi teknik i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar draft modelin e shërbimit të kujdestarisë

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/20/405>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

profesionale, i cili po pilotohet në Korçë dhe në Vlorë. Nga grupi i ekspertëve, të kontraktuar nga UNICEF, janë hartuar curriculat dhe do të fillojë në shtator 2021, trajnimi i stafëve sociale lidhur me ofrimin e këtij shërbimi. Duke marrë parasysh dhe kufizimet nga pandemia COVID 19, bazuar në fushatën e komunikimit që është duke u hartuar, për zbatimin e gjithë planit të De-I, do të fillojë, nga shtatori e në vazhdim fushata sensibilizuese për të gjithë procesin e De-I, përfshirë dhe nxitjen e kulturës së ofrimit vullnetar të familjeve kujdestare. Nga MSHMS kërkohet shtyrja e afatit për realizimin plotësisht të rekomandimit, brenda vitit 2021.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 10: MSHMS dhe NJVQV të marrin në vlerësim mundësinë e ngritjes së kapaciteteve të nevojshme për kalimin e çështjeve të dhënies së kujdestarisë nga gjyqësore në administrative.

Afati: Qershor 2021

Në kuadrin e rishikimeve të Kodit të Familjes, nga ekipi i ekspertëve për reformën e De-I janë hartuar rekomandimet dhe ende nuk ka një feedback nga Ministria e Drejtësisë.

Nga sa më sipër Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke qenë se nuk është autoriteti kompetent për miratimin e këtyre ndryshimeve, mund të përgatisë propozimin për Ministrinë e Drejtësisë.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 11: MSHMS të marrë masa për miratimin dhe vënien në zbatim të menjëhershëm të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 - 2023.

Afati: Menjëherë

Me VKM nr. 706/2020 është miratuar Plan i Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022, si dhe është hartuar raporti i parë i monitorimit i cili është dakortësuar në Komitetin Drejtues të ngritur me Urdhër Ministri për sigurimin e zbatimit të këtij plani, dhe do të botohet në faqen zyrtare të MSHMS.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 12: SHSSH në bashkëpunim me NJVQV përkatëse të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin në administrim të plotë të tre IPSH – ve që janë ende në varësi të SHSSH.

Afati: Qershor 2021

Në kuadër të zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit, SHSSH ka marrë nismën për transferimin e IPSH-ve rezidenciale bashkive përkatëse gjatë viti 2021.

Me shkresë Nr. 1266 prot, datë 23.06.2021 SHSSH i është drejtuar Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për transferimin e Qendrës së Zhvillimit për PAK e cila është në administrimin e SHSSH.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi nr. 13: Të gjitha NJVQV, krahas hartimit të planit të mbrojtjes së fëmijës, të marrin të gjitha masat e duhura për të hartuar edhe planet e zhvillimit individuale të tyre, SHSSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

të mbështesë dhe të monitorojë hap pas hapi të gjithë procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të tyre, duke ndihmuar në këtë mënyrë kalimin gradual në administrim të NJVQV.

Afati: Qershor 2021

Në kuadër të zbatimit të planit të deinstitutionalizimit, SHSSH është pjesë e bashkëpunimit me MSHMS dhe NJVQV për implemetimin e planit të veprimit.

SHSSH në bashkëpunim me partnerët e organizatave jofitimprurëse ka realizuar vlerësimin e të gjithë fëmijëve të akomoduar në 9 (nëntë) institucione të përkujdesit shoqëror dhe familjeve të tyre biologjike dhe janë hartuar planet individuale të zhvillimit për çdo fëmijë. Procesi i vlerësimit është kryer nga Nisma/Arsis, Bethany me mbështetjen e UNICEF dhe SAVE the CHILDREN bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet MSHMS dhe dy organizatave ndërkombëtare.

Pas miratimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, ka hyrë në fuqi moratoriumi për dy IPSH-të 0- 5 vjeç Korçë dhe Vlorë, për mospranimin e rasteve të reja të fëmijëve.

Pasi ka përfunduar vlerësimin e fëmijëve të cilët janë potencial për kthim në familjen biologjike, aktualisht organizata Nisma/Arsis po vijon punën me partneritet me strukturat vendore me ndërhyrje direkte në fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve për të zbatuar planet e ribashkimit të fëmijëve me familjen biologjike.

Bashkia Korçë dhe Vlorë në partneritet me Nisma/Arsis po zbatojnë me mbështetjen e Fondit Social ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fuqizimin e familjeve.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 14: Të gjitha NJVQV, në bashkëpunim me SHSSH, të promovojnë kujdestarinë alternative duke vendosur theksin tek mbështetja financiare e ofruar nga shteti shqiptar për familjet kujdestare.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Në kuadër të Projektit të EUD me fshatin S.O.S lidhur me promovimin e shërbimit të kujdestarisë, Bashkia Korçë dhe Vlorë ka qenë pjesë e kësaj fushate.

Më poshtë prezantimi mbi zbatimin e këtij projekti.

Statusi: Zbatuar

Rekomandimi nr. 15: Të gjitha NJVQV, në bashkëpunim me SHSSH, të kërkojnë me këmbëngulje të gjithë mbështetjen e nevojshme nëpërmjet trajnimeve apo asistencës teknike me qëllim përdorimin e Regjistrisë Kombëtare Elektronike dhe adresimin e kërkesave për fondin social.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Referuar raportimeve nga zyrat rajonale të SHSSH, i gjithë stafi që punon në shërbimet e mbrojtjes sociale në nivel Bashkie, është trajnuar dhe ka filluar hedhjen e të dhënave dhe trajtimin e rasteve të para, por Bashkitë akoma kanë problematika teknike dhe nuk e kanë të mundur të gjenerojnë në mënyrë masive rastet aplikuese. Zyrat Rajonale të SHSSH si edhe SHSSH nuk kanë akses për të parë rastet e hedhura në sistem. Gjatë periudhës së raportimit vetëm 24 bashki arritën të kishin plane sociale të buxhetuara dhe miratuara, ku 14 prej tyre aplikuan për Fondin Social me projekte konkrete të buxhetuara - krijimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të Thirrjes së Parë të Propozimit, Mars 2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Pra, rezulton se 14 bashki u financuan nga Fondi Social në vitin 2020 për të krijuar 14 shërbime të reja, me një fond që arrin në 61,412,587 lekë dhe qëllimi është që të financohen 35 bashki deri në fund të vitit 2022. Përparësi iu dha bashkive ku nuk ofrohej asnjë shërbim social. Për vitin 2021, thirrjes së lançuar nga MSHMS ju përgjigjën 40 Bashki, me projekte konkrete të buxhetuara për ngritjen e shërbimeve të kujdesit social. Gjatë procesit të vlerësimit nga Komisioni i ngritur me Urdhër Ministri u kualifikuan për financim 16 Bashki dhe 13 shërbimeve të specializuara në nivel qarku.

Statusi: Zbatuar

IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën me shkresën nr. 8/10 prot, datë 30.10.2020 , rezulton se nga 19 masa të rekomanduara (masa për përmirësim ligjor dhe masa organizative), nga subjekti janë pranuar 19 masa ose në masën 100 %. Nga **19 masa** të pranuar janë zbatuar plotësisht **8 masa** ose 42.11 %, janë në proces zbatimi **9 masa** ose 47.37% dhe janë pa zbatuar **2 masa** ose 10.53%. Nga sa shikohet niveli i realizmit është në masën 42.11%, fakt i cili dëshmon se subjektet nuk e kanë vlerësuar drejt procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** si më poshtë:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Gjetje Nr. 1: Në Ligjin Nr. 8153, datë 31 tetor 1996, “Mbi statusin e jetimit”, i ndryshuar, nuk bëhet një diferencim i qartë i kategorive të ndryshme të fëmijëve jetim biologjik dhe social. Gjithashtu në këtë ligj nuk përcaktohen saktë kriteret për kategoritë që përfitojnë statusin e jetimit.

Rekomandimi nr. 1: MSHMS dhe SHSSH të ndërmarrë të gjitha iniciativat e nevojshme për të rishikuar Ligjin nr. 8153, datë 31 tetor 1996, “Mbi statusin e jetimit”, të ndryshuar, duke reflektuar në të ndryshimet përkatëse në terminologji dhe kriteret e përfitimit të statusit, nisur nga fakti se termi “jetim” nuk përmendet në asnjë dokument ndërkombëtar dhe as në Kodin e Familjes.

Afati: Brenda vitit 2022

Gjetje Nr. 2: Në kundërshtim me pikën 29, neni 3 të Ligjit Nr. 121/2016, Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar vendimin për përcaktimin e kriterëve për llojet e ndryshme të shërbimeve.

Rekomandimi Nr. 2: MSHMS të marrë të gjitha masat e duhura që në zbatim të pikës 29, neni 3 të ligjit 121/2016, të miratojë vendimin për përcaktimin e kriterëve për llojet e ndryshme të shërbimeve.

Afati: Brenda vitit 2022

Gjetje Nr. 3: Kosto vjetore e mbajtjes së fëmijës në qendër rezidenciale ka diferenca ndër rrethe: kosto për një fëmijë në Tiranë është shumë më e lartë nga kostoja për fëmijë në rrethe të tjera, duke mos pasqyruar drejtë koston e jetesës në rrethe të ndryshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 3: MSHMS, në bashkëpunim me NJVQV, të vlerësojë mundësinë e rishikimit të VKM nr. 149, datë 13.03.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje”, sa i takon masës së financimit për familjet kujdestare në varësi të kostove të ndryshme të jetesës në qytete të ndryshme.

Afati: Brenda vitit 2022

Gjetje Nr. 4: Vlera e masës së financimit për familjet kujdestare nuk ka ndryshuar në vite duke mos reflektuar impaktin e inflacionit.

Rekomandimi nr. 4: MSHMS të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim rishikimin e VKM nr. 149, datë 13.03.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje”, sa i takon reflektimit të impaktit të inflacionit në masën e financimit për familjet kujdestare.

Afati: Brenda vitit 2022

B. MASA ORGANIZATIVE:

Gjetje Nr. 1: Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezultoi se:

-Në lidhje me respektimin e afatit 20 ditor dhe 6-mujor për informimin dhe raportimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve rezultoi se afati 20 ditor është zbatuar dhe KLSH është informuar me shkresën nr. 42/6 protokoll, datë 19.11.2020 *për planin e masave mbi rekomandimet dhe me shkresën nr. 515 datë 07.05.2018 raport mbi zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH. ndërsa respektimi i afatit 6-mujor është bërë pjesërisht.* Nga ana e strukturës përgjegjëse në MSHMS është përgatitur informacioni mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, (referuar e-mailit zyrtar dhjetor 2020), por ky raport nuk ka ndjekur rrugën e mëtejshme të miratimit zyrtar nga instancat superiore dhe nuk është përcjellë zyrtarisht në KLSH. Për zbatimin e masave rezultoi se: nga 19 masa të rekomanduara gjithsej me shkresën nr. Nr. 8/10 Prot., datë 30.10.2020 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi Nr. 115, datë 30.10.2020, të Kryetarit të KLSH-së, janë marrë në konsideratë dhe realizuar plotësisht 8 masa, janë në proces 9 masa dhe nuk janë realizuar 2 masa, veprim në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c. Një pjesë e rekomandimeve janë lënë përsëri pasi problematikat nuk janë ezauruar për shkak të situatës pandemike.

Rekomandimi nr. 1: MSHMS dhe SHSSH të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje Nr. 2: Nuk është ngritur sistemi i informacionit në nivel rajonal dhe qendror për të identifikuar nevojat për shërbime të përkujdesjes shoqërore deri në 2018.

Rekomandimi nr. 2: MSHMS dhe SHSSH në bashkëpunim me NJVQV të marrin masa për të vënë plotësisht në funksionim regjistrin elektronik kombëtar.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje Nr. 3: Numri i fëmijëve jetim që kanë përfituar statusin ndër vite si rezultat i lindjes jashtë martese është më i lartë krahasuar nga kategoritë e tjera të jetimëve. Procesi i përfitimit të shërbimeve sociale nis pranë PMF në NJVQV me referimin e rastit dhe vlerësohet për vendimmarrje pranë SHSSH-së. Nuk është ngritur sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e përzgjedhura deri në 2017 dhe në nivel kombëtar deri në 2020, kur detyrimi ligjor ishte deri në 2018.

Rekomandimi nr. 3: NJVQV të veprojnë për të miratuar vendimin për tarifat e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Afati: Deri në vitin 2022

Gjetje nr. 4: MSHMS, SHSSH dhe NJVQV nuk kanë kryer asnjë analizë financiare dhe të burimeve njerëzore sa i takon deinstitutionalizimit sipas komponentëve të parashikuar nga Udhëzuesi i përbashkët Evropian për kalimin nga kujdesi institucional në kujdesin me bazë komunitare.

Rekomandimi nr. 4: MSHMS dhe SHSSH të kryejnë një studim me qëllim evidentimin e përfitimeve financiare të deinstitutionalizimit.

Afati: Brenda vitit 2022

Gjetje nr. 5: Edhe për realizimin e procesit të decentralizimit evidentohet mungesa e burimeve njerëzore të përshtatshme dhe të nevojshme në nivel vendor për të kryer analizën e nevojave me qëllim hartimin e planeve sociale.

Rekomandimi nr. 5: MSHMS, SHSSH dhe NJVQV të kryejnë analiza financiare dhe të burimeve njerëzore lidhur me deinstitutionalizimin sipas komponentëve të parashikuar nga Udhëzuesi i përbashkët Evropian për kalimin nga kujdesi institucional në kujdesin me bazë komunitare.

Afati: Brenda vitit 2022

Gjetje nr. 6: MSHMS dhe NJVQV nuk kanë ndërmarrë fushata agresive sensibilizuese për nxitjen e kulturës së ofrimit vullnetar të familjeve kujdestare të përkohshme por edhe të përhershme.

Rekomandimi nr. 6: MSHMS dhe NJVQV të ndërmarrin fushata agresive sensibilizuese për nxitjen e kulturës së ofrimit vullnetar të familjeve kujdestare të përkohshme por edhe të përhershme.

Afati: Brenda vitit 2021

Gjetje nr. 7: MSHMS nuk ka hartuar masa konkrete dhe as një udhëzues se si do të kryhet procesi i deinstitutionalizimit. MSHMS dhe NJVQV nuk kanë kryer një planifikim se si do të kryhet mbështetja e individëve gjatë tranzicionit nga institucioni në përkujdesje alternative kur numri i fëmijëve të rikthyer në familjet biologjike apo të birësuar ka ardhur në rënie ndërkohë që numri i fëmijëve të institucionalizuar ka ardhur në rritje.

Rekomandimi nr. 7: MSHMS dhe NJVQV të marrin në vlerësim mundësinë e ngritjes së kapaciteteve të nevojshme për kalimin e çështjeve të dhënies së kujdestarisë nga gjyqësore në administrative.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje nr. 8: Tre prej IPSH-ve janë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe 6 janë në varësi të dyfishtë midis SHSSH dhe njërive të vetë qeverisjes vendore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 8: SHSSH në bashkëpunim me NJVQV përkatëse të marrë të gjitha masat e nevojshme për kalimin në administrim të plotë të tre IPSH – ve që janë ende në varësi të SHSSH.

Afati: *Menjëherë dhe në vazhdimësi*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

IV. PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, PËR PERIUDHËN 2016-2019”

PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Shkodër** mbi “Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e dytë të vitit 2020” për auditimin e kryer në vitin 2020 me temë “Efektiviteti i koordinimit ndërinstitucional në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në bashkimin evropian, për periudhën 2016-2019”, për periudhën 2016-2019 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me 754/4 prot., datë 05.07.2021 dhe programin e auditimit me nr. 754/5 prot., datë 05.07.2021 (administruar në subjektin MEPJ me nr. 8297 prot., datë 07.07.2021, Bashkia Vlorë nr. 10378/1 prot., datë 08.07.2021, Bashkia Shkodër nr. 11474/1 prot., datë 12.07.2021), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- j. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- k. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- l. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka kthyer përgjigje në KLSH duke mos respektuar afatin 20 ditor. Bashkia Vlorë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 10001/1 prot., datë 23.11.2020 dhe shkresën nr. 10001/2 prot., datë 25.01.2021, duke respektuar afatin 20 ditor. Bashkia Shkodër, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 3064/6 prot., datë 12.11.2020 duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecursisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjekteve të audituar nuk janë marrë masat për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 132/12 prot., datë 30.10.2020, dhe shkresën nr. 132/14 prot., datë 30.10.2020 në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga subjektet e audituar, brenda afatit 6-mujor nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 132/12 prot., datë 30.10.2020 në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me nr. 132/12 prot., datë 30.10.2020 në Bashkinë Vlorë dhe me nr. 132/14 prot., datë 30.10.2020 në Bashkinë Shkodër, janë rekomanduar gjithsej:

e. Janë rekomanduar 53 **masa me karakter organizative**.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas këtij vendimi i cili i është përcjellë KLSH sipas afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	53	53	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si dhe manualit *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”*, miratuar me shkresën nr. 67, datë 23.06.2020 (nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020).

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 754/5, prot., datë 05.07.2021 dhe njoftimit *“Për fillim projekt auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve”* nr. 754/4 prot., datë 05.07.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. E. K. (Përgjegjës grupi)

2. E. K. anëtare

Auditimi ka filluar më, datë 09.07.2021

Auditimi ka përfunduar më, datë 21.07.2021

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 132/12 dhe 132/14 prot., datë 30.10.2020, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet MEPJ, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Shkodër në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 754/4, datë 05.07.2021, rezulton se nga **53** masa të rekomanduara (*masa organizative*), janë pranuar nga subjekti **53** masa ose 100 %. Nga 53 masa të pranuarat janë zbatuar plotësisht **14** masa, ose 26.42 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **16** masa ose 30.19%, janë në proces zbatimi **7** masa ose 13.21% dhe janë pa zbatuar **16** masa ose 30.18%. Nga sa shikohet niveli i realizmit është në masën 26%, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa Organizative	53	14	16	7	16

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE :

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është mbi 25 %, vlerësohet se rekomandimet pjesërisht të zbatuara dhe në proces zbatimi zënë peshën me të madhe ose 36 % të rekomandimeve të lëna, dhe respektimi i afateve nga subjekti i audituar në shume raste nuk varet nga vendimmarrja e drejtimit, por dhe nga miratimi në strukturat e tjera sipas shkallës së hierarkisë.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: MEPJ nuk ka marrë hapa konkret dhe efektiv lidhur me hartimin e PKIE dhe bashkëpunimin mes strukturave të integritit, pasi nuk ka një metodologji/Udhëzues të miratuar për hartimin e këtij plani.

1.1. Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sipas kërkesave VKM nr. 32, datë 19.01.2018, “Për përcaktimin e funksioneve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturave të shërbimit të jashtëm në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ngrejë një grup pune që të hartojë dhe më pas të miratohet metodologjia dhe/ose udhëzimi për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtarë për Integritimin Evropian.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

MEPJ: MEPJ inicion procesin e hartimit të PKIE në tremujorin e fundit të çdo viti kalendarik, duke i vënë në dispozicion strukturave të Ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera kontribuuese metodologjinë për hartimin e PKIE. MEPJ inicion procesin e hartimit të PKIE në tremujorin e fundit të çdo viti kalendarik, duke i vënë në dispozicion strukturave të Ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera kontribuuese metodologjinë për hartimin e PKIE. Për hartimin e Metodologjisë/Udhëzimit të hartimit (rishikimit) të PKIE të trevjetorit pasues, Drejtoria e BE-së bazohet: në udhëzuesin e PKIE-së së mëparshme, në komentet/sugjerimet e dala prej asistencave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

teknike/SIGMA-s në çdo nevojë për risi të sistemit të koordinimit apo të lindur nga zbatimi i PKIE-së mëparshme. DBE nuk ngre grup pune, po çdo produkt draft që del nga Dr. BE, bihet dakord në nivel të koordinatorëve, brenda Dr. BE, si dhe kalon për miratim në linjë hierarkike në strukturën për negociatat e anëtarësimit të ngritur me VLK 749/2019. Siç kemi raportuar, gjatë vitit 2019, objekt auditimi, metodologjia dhe orientimet mbi hartimin e PKIE 2020-2022, u miratuan në Komitetin Teknik të GNPIE-ve (të ngritur sipas Urdhrit 93/2018 të KM). Draft metodologjia e PKIE 2021-2023 u miratua në Grupin Negociator (të ngritur nga VKM 422/2020) me datë 8 tetor 2020. Me marrjen e miratimit në këtë organ kolegjal, metodologjia/udhëzuesi i PKIE 2021 -2023 iu përcoll GNP-ve/institucioneve të linjë për zbatim në hartimin e draft PKIE 2021-2023. E njëjta praktikë do të ndiqet edhe për PKIE 2022-2024. Procesi i hartimit dhe miratimit të Metodologjisë/Udhëzuesit për PKIE 2022-2024 do të kryhet gjatë periudhës shtator-tetor 2021.

Statusi: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: MEPJ nuk ka bashkëpunuar për rishikimin vjetor dhe koordinimin e PKIE me GNP-të për periudhën 2016-2019.

2.1. Rekomandimi: MEPJ të bashkëpunojë dhe bashkërendojë me strukturat e tjera të integritetit dhe me Grupet Ndërinstitucionale të Punës për rishikimin sa më efektiv të PKIE-së, takimet dhe mbledhjet mos të jenë vetëm ato që janë programuar paraprakisht, por sa herë të jetë e nevojshme, si dhe për të përfshirë në mënyrë sa më të saktë rekomandimet e KE (për këtë të mbahen dokumente verifikues)

Afati: Në vazhdimësi

MEPJ: Përfshirja e grupeve ndërinstitucionale të punës është parakusht për hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Urdhri i Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05. 2019, “Për ngritjen Përfshirja e grupeve ndërinstitucionale të punës është parakusht për hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Urdhri i Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05. 2019, “Për ngritjen përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” përcakton se grupet ndërinstitucionale të punës janë të ngarkuara me përcaktimin e përgjegjësisë për harmonizimin e legjislacionit, përgatitjen e analizave të mangësive ligjore dhe veçanërisht (gërma “k” e pikës 2) të bashkërendojnë procesin e hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Më tej, metodologjitë e përdorura për hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, pavarësisht ndryshimeve që kanë pësuar në vite, kanë theksuar gjithmonë se Plani Kombëtar për Integrimin Evropian hartohet i strukturuar sipas kapitujve negociues, duke bërë të pashmangshëm përfshirjen e grupeve ndërinstitucionale të punës në hartimin e tij. Procesi i monitorimit, po ashtu, është kryer bazuar në ndarjen e kapitujve negociues dhe grupeve ndërinstitucionale të punës korresponduese. Kontaktet me GNP-të, që nga momenti që u përcillet metodologjia e hartimit të PKIE-së, realizohen në bazë të një kalendari që përcakton vetë metodologjia. Kështu po ti referohemi Udhëzuesit për Hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023, koordinimi me GNP-të është kryer gjatë tetorit 2020 për analizën e zbatimit të PKIE 2020-2022 si dhe për hartimin e versionit shqip/anglisht të PKIE 2021-2023. GNP-të gjithashtu angazhohen dhe koordinohen prej MEPJ-së për finalizimin e versionit shqip/anglisht të PKIE-së si dhe gjatë periudhës së konsultimit publik e ndërinstitucional të draft PKIE që më pas miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, puna për hartimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

e PKIE 2021-2023 ka nisur nga një qarkore e Kryenegociatorit e datës 3 gusht 2020 me nr. protokolli 4011 ku udhëzohet që MEPJ të nxjerrë brenda gjysmës së parë të shtatorit 2020 draft udhëzimin për përgatitjen e PKIE 2021-2023. Me 26 gusht 2020, MEPJ njofton të gjitha GNP-të dhe negociatorët për nisjen e procesit të hartimit të PKIE 2021-2023 dhe identifikimin e iniciativave ligjore dhe masave zbatuese në PKIE 2021-2023, të institucioneve bashkëpunuese dhe zbatuese, kostimin dhe burimet financiare. Draft metodologjia e PKIE 2021-2023 iu përcoll KN dhe Grupit Negociator me 4 shtator 2020. Me 8 tetor 2020, draft metodologjia e PKIE 2021-2023 dhe kalendari i hartimit dhe miratimit të saj miratohen në mbledhjen e Grupit Negociator të datës 8 tetor 2021. Po në mbledhjen e datës 8 tetor të Grupit negociator është kërkuar nga negociatorët dhe GNP-të analiza e Raportit 2020 të Komisionit Evropian lidhur me rekomandimet dhe masat që do të merren për plotësimin e tyre, duke shpjeguar nëse këto masa do të përfshihen në PKIE 2021. Udhëzohen GNP dhe negociatorët të kryejnë takime të GNP-ve për sa më lart brenda afatit të përfshirjes së propozimeve në PKIE 2021. Në periudhën tetor-dhjetor 2020, GNP-të janë mbledhur për të diskutuar sa më lart. Koordinatorët e Kapitujve janë anëtarë të GNP dhe marrin pjesë. Komunikimi edhe me email dëshmon jo vetëm koordinimin nga MEPJ po dhënien e udhëzimeve të qarta për planifikimin, përfshirë në aspektet e plotësimit të rekomandimeve të KE. Me shkresën 12018, datë 12.10.2020 MEPJ përcjell metodologjinë e miratuar të PKIE 2021-2023 për të gjitha GNP-të dhe udhëzon: Strukturimin e saj sipas kapitujve negociues

Statusi: Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë hartimit dhe rishikimit vjetor të PKIE-së, nuk mban parasysh rekomandimet e dhëna nga shërbimet e Komisionit Evropian.

3.1. Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përkatësisht Drejtoria e BE-së, Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial, të hartojnë një plan konkret pune për të arritur objektivat lidhur me procesin e Integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Afati: Deri në Shtator 2020

MEPJ: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund të hartojë një plan pune për Integrimin Evropian, jo vetëm sepse integrimi përfshin disa aspekte, por sepse është në rolin e koordinatorit dhe punën reale për integrimin e bëjnë institucionet e linjës. I vetmi plan kombëtar për integrimin që ekziston është Plani Kombëtar për Integrimin Evropian trevjeçar. Ky është plani i punës për të arritur objektivat që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe përgatitja për negociatat e ardhshme.

PKIE nuk është plan i MEPJ, është plan kombëtar, siç ka edhe përcaktimin. MEPJ vetëm e mbledh dhe rishikon cilësinë e tij sikurse edhe e propozon me një draft vendim të Këshillit të Ministrave. Plani Kombëtar për IE miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe angazhon të gjithë administratën shtetërore. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është planifikimi i zbatimit të rekomandimeve të BE- në procesin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit që përbën kuadrin e vetëm angazhues për integrimin evropian, për momentin. PKIE gjithashtu shërben dhe do të shërbejë për prioritizimin e përafrimit me legjislacionin e BE-së me nisjen e procesit të negociatave. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian përfshin si orientime:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

- Planifikimin sa më të saktë të transpozimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në kuadrin ligjor shqiptar;
- Planifikimi të bazohet në plotësimin sa më të lartë të rekomandimeve të shërbimeve të Komisionit Evropian (konsistenca me rekomandimet e Komisionit);
- Planifikimi të synojë hapjen sa më të shpejtë të negociatave të anëtarësimit dhe mbështetjen e këtij procesi;
- Planifikimi të kryhet duke marrë në konsideratë prioritetet e reformave në Shqipëri, strategjitë dhe politikat kombëtare (konsistenca me dokumentet e tjera strategjike, programin e projekt akteve të Këshillit të Ministrave, etj.);
- Planifikimi të kryhet duke marrë në konsideratë mundësitë financiare dhe planifikimet buxhetore (konsistenca me planifikimin buxhetor);
- Koordinimi sa më i mirë ndërinstytucional në përcaktimin e prioritetëve, në përcaktimin e akteve që do të përgatiten për përafrimin e legjislacionit dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar;
- Koordinimi sa më i mirë ndërinstytucional për monitorimin e zbatimit të Planit dhe zgjidhjen e problemeve të ndeshura.

Gjithashtu MEPJ, ka hartuar dhe harton Plane pune tematike ose që i shërbejnë një pjese të procesit. Kështu, në vite ka pasur plane pune për zbatimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave, ashtu sikurse u bë një Plan për përmbushjen e 15 kërkesave të Këshillit të marsit, autorësinë e të cilit nuk e ka MEPJ, po Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (Kuvendi dhe aktorë të tjerë). Dr. BE nxjerr edhe një kalendar vjetor përkthimi, me priorizime që vijnë nga GNP-të dhe nga parashikimet afatmesme në PKIE.

Statusi: Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: MEPJ nuk ka hartuar asnjë plan pune konkret për procesin e Integritimit të Shqipërisë në BE, ku të jenë të përcaktuara objektivat, planifikimi dhe zbatimi që do të ndiqet përgjatë gjithë procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.

- Duke qenë që masat zbatuese mbështetëse të tilla si përkthimi i legjislacionit, trajnime, forcim kapacitetesh administrative, investime, logjistikë, etj. Sipas MEPJ do të përfshihen gjithashtu në PKIE, pra deri më tani këto kërkesa në Planin Kombëtarë për Integritimin Evropian nuk janë zbatuar.

4.1. Rekomandimi: MEPJ bashkë me GNP-të të përfshijnë gjatë rishikimit të PKIE-së së vitit të ardhshëm të gjitha masat zbatuese mbështetëse, për një dokument të plotë për procesin e integritetit në BE.

Afati: Deri në Mars 2021

MEPJ: Plani Kombëtar për Integritimin Evropian 2021-2023, e miratuar VKM 90, datë 17.02.2021.

Statusi: I zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka hartuar një rregullore për funksionimin dhe organizimin e saj.

- Drejtoritë të cilat janë pjesë e këtij procesi nuk kanë të përcaktuara dhe miratuara detyrat funksionale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

5.1. Rekomandimi: MEPJ, të ngrejë një grup pune për të hartuar një rregullore të brendshme funksionimi dhe organizimi, ku të jenë të mirë-përcaktuara detyrat dhe funksionet e gjithsecilit, dhe të miratohet nga struktura përgjegjëse e ministrisë.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

MEPJ: MEPJ do ta vlerësoj procesin në vijim.

Statusi: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë nuk ka një strukturë përgjegjëse për integrimin, edhe pse kjo ka qenë një kërkesë e hershme dhe e rëndësishme, kjo jo vetëm për rëndësinë që sjell ky proces;

6.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të krijojë një grup pune, i cili të hartojë rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e institucionit, si dhe më pas të procedohet me miratimin e saj.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

Grupi i auditimit: Lidhur me zbatimin e rekomandimit sqarojmë se, përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë nuk janë shprehur.

Statusi zbatimit: I Pazbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: MEPJ nuk e ka venë në dukje ose të gjenerojë një informacion për mungesën e një strukture përgjegjëse për integrimin Evropian për Bashkinë Vlorë, duke mos respektuar kërkesën e VKM nr. 450, datë 09.05.2018.

7.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marri masat që të formatojë organizimin e institucionit dhe të ngrejë një strukturë përgjegjëse për integrimin Evropian sipas kërkesave eksplicite të VKM nr. 450, datë 26.07.2018, “Për Bashkërendimin dhe Koordinimin e Procesit të Integritit Evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe VKM nr. 246, datë 09.05.2018 “Për Miratimin e Planit Kombëtar Për Integrimin Evropian 2018-2020”.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

Bashkia Vlorë: Me vendim nr. 26, datë 08.06.2020, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve Vartëse-2020, është miratuar Drejtoria e Integritit Evropian dhe Investimeve të Huaja. Kjo drejtori ka në përbërje të saj një drejtor dhe dy specialistë.

Statusi zbatimit: I zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Vihet re që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përkatësisht Bashkia Vlorë nuk ka pasur bashkëpunim me Qeverisjen Qendrore, si dhe nuk ka kërkuar asnjëherë nga MEPJ që të marrë të dhëna dhe të informohet lidhur me këtë proces.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë iniciativa në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, të informojë MEPJ, si dhe sa herë të jetë e nevojshme të kërkojë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informacion të detajuar për të qenë sa me përditësuar me procesin.

Afati: Në vazhdimësi

Bashkia Vlorë: Bashkia Vlorë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe ka raportuar pranë MEPJ për projektet në të cilat është partnere.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

9. Gjetje nga auditimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për procesin e integritetit ka dërguar ftesa për takim apo aktivitet që janë organizuar vetëm për vitin 2018, dhe për asnjë periudhë tjetër.

- Rritja e bashkëpunimit midis strukturave të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është një kërkesë e parashikuar në PKIE, e cila nuk ka gjetur zbatim dhe rezultate të dukshme, për vitet 2016-2019.

- MEPJ nuk ka marrë asnjë hap për të informuar strukturat përkatëse, për të siguruar pjesëmarrjen përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore në forumet strukturat konsultuese për procesin e integritetit evropian dhe të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces.

9.1 Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si institucioni përgjegjës kryesor për koordinimin dhe informimin ndërinstitucional, të marrë hapa konkret dhe të ndërveprojë me Njësitë e Qeverisjes Vendore, si dhe të kërkojë periodikisht si dhe kur është e nevojshme informacion për procesin e integritetit.

Afati: Në vazhdimësi

MEPJ: MEPJ ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Brendshme, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Delegacionin e BE për situatën e ngritjes së NJIE nëpër bashkitë e vendit. Po MEPJ nuk ka asnjë tagër mbi qeverisjen vendore dhe nuk është ministria përgjegjëse për menaxhimin e saj MEPJ organizon gjithmonë dite informuese në kuadër të shpalljeve të thirrjeve për Projekt propozime për çdo program dhe gjithmonë fton NJQV për të marrë pjesë në këto sesione por në asnjë rast nuk mund ti detyrojë të jenë pjesë e tyre. Mbetet në kompetencën dhe mundësinë e NJQV-se për të marrë pjesë. Nuk është parashikuar masë ligjore për shtrëngimin e tyre për të qenë pjesë e trajnimeve dhe aq më pak kjo masë nuk mund të merret nga MEPJ e cila është vetëm në rolin koordinues për këto programe.

Referuar raportit të auditimit, MEPJ gjatë viteve objekt auditimi, nuk i janë drejtuar NJQV lidhur me procesin e integritetit, si dhe nuk ka bashkërenduar e kërkuar që të marrë një informacion as nga NJQV, që procesi të ndiqej vazhdimisht e të krijohet një frymë bashkëpunimi, për të zgjidhur problematikat dhe ngërçet e hasura. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i pazbatuar*.

Statusi zbatimit: *i pazbatuar*.

10. Gjetje nga auditimi: Raportimi si një proces i rëndësishëm mbi aktivitetet e qeverisë nuk rregullohet, koordinohet ose zbatohet në mënyrë koherente dhe është ende i kufizuar.

- MEPJ në raportimet që kryen, paraqet vetëm arritjet që janë realizuar nga kushtet që BE i ka vendosur Shqipërisë, por rezultatet dhe problematikat nuk i konsideron që të raportohen sipas detyrimeve, për një proces sa me transparent dhe të përshtatshëm.

- Vihet re që nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk përmbushet plotësisht kushti i raportimit çdo 3 muaj sipas kërkesave ligjore.

10.1 Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, duhet të marrë masat të raportojë sipas periudhave të caktuara nga PKIE, për zbatimin e kësaj të fundit, duke caktuar praktikë pune për të raportuar çdo 3 muaj, dhe në raste të nevojshme të tjera.

Afati: Në vazhdimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MEJ: PKIE ndahet në katër tremujorë për efekt planifikimi MEPJ (DR. BE) raporton çdo javë për monitorimin që i bën realizimit të tremujorëve të PKIE. Në çdo tre, gjashtë, nëntë dhe 12 muaj, MEPJ nxjerr një format monitorimi që u përcillet me shkresë Kryenegociatorit, Grupit Negociator, Sekretarëve të Përgjithshëm të institucioneve, Këshillit të Ministrave për ndjekjen dhe nxitjen e realizimit dhe dëshmimit të realizimit.

Statusi zbatimit: I zbatuar .

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë, ka mangësi në realizimin e një raportimi efektiv lidhur me procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk kërkon që ky detyrim për raportim të plotësohet nga NJQV.

11.1 Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të nxisë qeverisjen vendore të zbatojë kërkesat nga Bashkimi Evropian, duke qenë organi kompetent për koordinimin e PKIE, duke ushtruar detyrat funksionale, atë të llogaridhënies dhe llogari-marrjes nga strukturat përgjegjëse për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Afati: Në vazhdimësi

MEPJ: Në Urdhrin e Kryeministrit nr. 113, datë 30 gusht 2019 për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, parashikohet se në tryezat e diskutimit që do ngrihen për secilin kapitull mund të ketë përfaqësues edhe nga pushteti vendor, (parashikuar në pikën III.2.2 dhe III.2.4 të Urdhrit të KM.) Pjesëmarrja në këto tryeza do të mundësojë përfshirjen në diskutime të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me agjendën e integritetit në çdo GNP. Tryezat nuk janë krijuar të gjitha dhe procesi i ngritjes së Njësive të IE nëpër bashki nuk ka përfunduar. Kjo nuk mundëson institucionalizimin e përfshirjes, bazuar edhe në detyrimin e ministrive të linjës për koordinimin me pushtetin lokal (VKM 450/2018)

Statusi zbatimit: Në proces zbatimi.

12. Gjetje nga auditimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk përmbush rekomandimet e Komisionit Evropian dhe shprehimisht konsideron që “Vlerësimi i Komisionit nuk është konkret në lidhje me raportimet dhe koordinimin ndërinstitutional për procesin e integritetit, por është një vlerësim i përgjithshëm mbi analizën e punës institucionale publike.

12.1 Rekomandimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të tregohet e përgjegjshme për të zbatuar rekomandimet e KE në raportet vjetore për Shqipërinë, duke kryer raportimet sipas kërkesave, me të gjithë elementet e raportimit, duke përfshirë në të arritjet, rezultatet, mangësitë dhe pengesat e mundshme.

Afati: Deri në Dhjetor 2020

MEPJ: Përgjatë gjithë vitit 2020, MEPJ ka koordinuar dhe përcjellë në Komisionin Evropian katër kontribute kombëtare (me kontributin e institucioneve /GNP-ve kontribuese) për Raportin 2020 për Shqipërinë, i cili u publikua nga Komisioni Evropian me 6 tetor 2021. Për vitin 2021, MEPJ ka koordinuar dhe përcjellë në Komisionin Evropian dy kontribute kombëtare për Raportin 2021 të Komisionit Evropian. MEPJ ka koordinuar dhe përcjellë në Komisionin Evropian gjatë vitit 2020, kontribute kombëtare sektoriale për të gjitha takimet e përbashkëta të MSA, nënkomitete, Komitet të Stabilizim Asocimit dhe Këshill të Stabilizim Asocimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Ndërkohë nga 1 janar 2021 e deri tani, MEPJ ka koordinuar dhe përcjellë në Komision kontribute kombëtare sektoriale për dy nënkomitete të SA. Raportimi bazohet në formatet e pyetjeve të Komisionit dhe për këtë arsye raportohet si për arritjet edhe për mosarritjet. Po qëllimi parësor i kontributeve kombëtare është dëshmimi i realizimeve, por dobësitë, mosarritjet nuk mund të mbulohen sepse në shumë raste nuk raportohen zhvillime. Që do të thotë që ka ngecje, të cilat shpjegohen ose jo. MEPJ ka evidentuar në kontributet e fundit kombëtare, në çështje për të cilat nuk ka zhvillime, se kur është raportuar për herë të fundit dhe nëse ky mosraportim ka të bëjë me një problematikë të ezauruar apo me një çështje që nuk ka zhvillim. Në këtë qasje janë shkruar dy kontributet kombëtare për Raportin e ardhshëm 2021 për Shqipërinë të Komisionit Evropian. MEPJ ka evidentuar edhe masën e realizimit të prioritetëve afatshkurtra të Raportit 2020 për Shqipërinë dhe ka njoftuar për këtë Grupin Negociator.

Statusi zbatimit: I zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Përfshirja e punonjësve të njësive të dedikuara integritetit në Grupet Ndërinstitucionale të punës, bën të nevojshëm sintonizimin edhe profesional e formativ të tyre me këto grupe. Në një kohë kur çelja e negociatave është hapi më i afërt i procesit, duke sjelle për pasojë fillimin e diskutimit të kapitujve deri më tani të padiskutuar, punonjësit e MEPJ-së duhet të jenë të aftë të bëhen pjesë aktive e diskutimit të problematikave që do ndeshen. Ndaj do ketë nevojë për njohës të politikave të mjedisit, të bujqësisë, të energjetikës dhe rrjedhimisht, edhe të ngarkuarit e MEPJ-së që do ndjekin diskutimin e kapitujve duhet të jene për nga formimi i tyre, më afër këtyre profileve profesionale.

13.1 Rekomandimi: MEPJ dhe DAP të ndryshojnë kriteret e punësimit, duke mos e kufizuar profilin e studimeve të përfunduara nga kandidatët që konkurrojnë për t'u punësuar, në ato të parashikuara deri më tani, por të zgjerojnë spektrin e profileve profesionale të rekrutueshme.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: Për të bërë ndryshime në kriteret e punësimit duhet të ndryshojë struktura/përshkrimet e punës. Në vijim do të rishikohet mundësia e ndryshimit të përshkrimeve dhe ndryshimit të kriterëve në bashkëpunim me strukturën përkatëse në MEPJ dhe me DAP. Rekomandimi është marrë në konsideratë dhe nëse do të ketë vende vakante në vijim në sektorë që mbulojnë mjedisin, bujqësinë, energjetikën do të zgjerohet fusha e njohurive.

Statusi zbatimit: I pazbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Punësimet e bëra në vitin 2018, pas lirimimit dhe largimit të 22 punonjësve, më së paku janë të dyshimta, pavarësisht raportimit të bërë nga DAP për procesin e shkrirjes së MIE-s.

14.1 Rekomandimi: MEPJ veçanërisht në rastet kur për punësime të caktuara ka reagime nga ana e opinionit publik, duhet të gjejë format e përshtatshme për të bërë transparencë publike mbi përzgjedhjen e kandidatëve.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: Nën punësit civilë që janë liruar nga bashkimi i dy ministrive (ish-MIE) në vitin 2017/18, kanë qenë në nivel drejtor drejtorie apo përgjegjës sektori, të cilët nuk mund të sistemoheshin në MEPJ pasi pozicionet drejtor /përgjegjës janë pozicione me grada diplomatike pra janë diplomat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

karriere. Vende vakante në MEPJ me status të nëpunësit civil nuk ka patur gjatë periudhës së ristrukturimit. Ish-nëpunësit civil të ish-MIE, janë dëshmshpërblyer konform legjislacionit për shërbimin civil si dhe kanë pasur mundësi që të aplikojnë në vendet vakante të shpallura nga DAP, për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë në vijimësi. Për sistemimin e tyre në administratën publike në pozicione të barasvlershme në rastet kur në institucionin përkatës nuk ka vende të barasvlershme (drejtor/shef sektori) duhet të ketë një vendimarrje nga DAP si njësi përgjegjëse për sistemimin e tyre në pozicione vakante në institucione të tjera të administratës. Punësimet në shërbimin civil, bëhen komform legjislacionit në fuqi. MEPJ bën kërkesë pranë DAP për shpallje të vendeve vakante dhe e gjithë procedura deri në përzgjedhjen e kandidatit fitues ndiqet nga DAP.

Referuar shpjegimeve të institucionit, nuk është qartësuar procedura mbi transparencën publike mbi përzgjedhjen e kandidatëve nga ana e MEPJ. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i pazbatuar*.

Statusi zbatimit: *I pazbatuar*.

15. Gjetje nga auditimi: Në katër vitet e periudhës së auditimit, MEPJ ka raportuar vetëm në njërin vit, atë 2019, lidhur me trajnimet e stafit. Kjo nuk do të thotë, se trajnime nuk ka pasur gjatë periudhës në fjalë. Por sigurisht përderisa trajnimet nuk janë evidentuar nga MEPJ dhe nuk janë bërë pjesë e raportimit të përvitshëm ndaj Kuvendit të Republikës, do të thotë se kjo formë e ngritjes profesionale nuk është trajtuar si prioritet i politikave institucionale dhe nuk është reflektuar me seriozitetin e nevojshëm në raportimet e saj

15.1 Rekomandimi: MEPJ të bashkëpunojë me ASPA-n dhe çdo trajnues tjetër të mundshëm, me synim që çdo vit të përgatitet një program i detajuar trajnimesh, në përputhje me nevojat reale të proceseve dhe të stafëve të dedikuara në koordinimin e procesit të integritetit dhe të përfshijë në raportin e përvitshëm që i dërgon Kuvendit, një informacion të detajuar për trajnimet e zhvilluara.

Afati: Në vijimësi

MEPJ:MEPJ e ka ngritur nevojën e trajnimeve të dedikuara të stafit të vet dhe të administratës shtetërore për çështjen e integritetit evropian në një marrëdhënie të dedikuar institucionale me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Gjithashtu ASPA-s i është krijuar mundësia prej MEPJ të lidhet me homologët e saj në vende të BE-së për të krijuar module trajnimi për negociatat dhe për të siguruar lektorë ekspertë. Një thirrje e dedikuar për ekspertizë sektoriale të kapitujve të acquis është avancuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për aspektet e negociatave.

Statusi zbatimit: *Pjesërisht dhe në proces zbatimi*.

16. Gjetje nga auditimi: Nuk ka si të quhet “... proporcional me qëllimin për të cilin është ngritur...”, mospjesëmarrja në trajnim në Shkollën Verore Evropiane, në kushtet kur MEPJ ka punësuar punonjës të rinj, që nuk kanë asnjë përvojë në çështjet e integritetit, të cilët duhej të ishin detyrimisht pjesëmarrës në këtë shkollë.

16.1 Rekomandimi: MEPJ të vlerësojë seriozisht pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve të saj, duke mos bojkotuar aktivitetet trajnuese, kur pjesëmarrja është e mundshme.

Afati: Në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MEPJ: MEPJ e ka parësore ngritjen e kapaciteteve të stafit të saj. Si pjesë e administratës publike i gjithë stafi është marrës i trajnimeve të ASPA-s, dhe/ose të trajnimeve të tjera të ofruara prej asistencave teknike. Është shfrytëzuar gjithashtu edhe pjesëmarrja në shkollën e IE prej Kuvendit.

Statusi zbatimit: *Në proces zbatimi.*

17. Gjetje nga auditimi: Ndryshe nga formati i përfaqësimit (1+6) i përcaktuar më herët (Ambasadori dhe 6 diplomatë), numri i diplomatëve në Misionin e RSH-së në BE, në vitin 2019 është përgjysmuar, duke e çuar përfaqësimin diplomatik, nga formati një plus gjashtë, në një plus tre.

17.1 Rekomandimi: Të plotësohen vendet vakante pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian me diplomate të tjerë.

Afati: *Menjëherë*

MEPJ: Rekomandimi është marrë në konsideratë dhe misioni është plotësuar me staf.

Statusi zbatimit: *I zbatuar.*

18. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni i dërguar nga MEPJ vihet re, se Ambasadorja S. J. është në detyrë, që nga data 3 tetor 2014. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, parashikon në neni 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

18.1 Rekomandimi: MEPJ të sigurojë pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian qëndrueshmërinë e stafit diplomatik, duke mos toleruar mungesa të tij.

Afati: *Në vijimësi*

19.1 Rekomandimi: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadores së Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, znj. S.J.

Afati: *Menjëherë*

MEPJ: Rekomandimet janë marrë në konsideratë dhe për Ambasadorët që u ka mbaruar afati 3-vjeçar në detyrë, DBNJ ka evidentuar rastet konkrete dhe vene ne dijeni titullarët.

Statusi zbatimit: *Në proces zbatimi.*

20. Gjetje nga auditimi: Pra nga pesë përfaqësi, gjatë periudhës në auditim, konstatohen mungesa në katër prej tyre. Kemi përgjysmim të stafit diplomatik, në rastin e Misionit tonë në BE, sikurse vënë në dukje pak më sipër, ndërkohë që në Slloveni vendi ynë përfaqësohet nga një Ambasador dhe asnjë diplomat. Në Francë dhe Gjermani po ashtu ka pasur mungesa

20.1 Rekomandimi: Të bëhet plotësimi i vendit vakant me një diplomat në Ambasadën e RSH-së në Francë dhe me një diplomat në Ambasadën e RSH-së në Slloveni, si dhe të plotësohen të gjitha mungesat në staf diplomatik, kudo që ato janë krijuar ndërkohë.

Afati: *Menjëherë*

MEPJ: Rekomandimi është marrë në konsideratë nga MEPJ dhe Ambasadat janë plotësuar me staf.

Statusi zbatimit: *I zbatuar.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

21. Gjetje nga auditimi: Paralelisht vihet re se Ambasadori A. K. është në detyrë që nga data 16 shkurt 2014. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

- Paralelisht, nga të dhënat e përcjella nga MEPJ, vihet re se Ambasadori P. Q. është në detyrë, që nga prill 2014. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

- Po ashtu, konstatohet se Ambasadori D. T. është në detyrë që nga data 26 shkurt 2013. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

21.1 Rekomandimi: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Gjermani, z. A. K.

22.1 Rekomandimi: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni, z. P. Q.

23.1 Rekomandimi: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Francë, z. D. T.

Afati: Menjëherë

MEPJ: Rekomandimet janë marrë në konsideratë dhe për Ambasadorët që u ka mbaruar afati 3-vjeçar në detyrë, DBNJ ka evidentuar rastet konkrete dhe vënë në dijeni titullarët.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

24. Gjetje nga auditimi: Raporti diplomatik javor, nuk ka asnjë rubrikë, e aq më pak një rubrikë të dedikuar që t’u referohet kontributeve që aktiviteti i përfaqësive diplomatike i jep procesit të integritetit. Nuk ka një rubrikë që të informojë specifikisht dhe çdo javë MEPJ-në lidhur me:

- Partneritetet e mundshme në kuadër të IPA-ve dhe shprehje interesi në këtë plan;

- Mundësitë e bashkëpunimit të administratave të vendit pritës me ato homologe të vendit tonë, në kuadër projektesh të ndryshme;

- Shprehje interesi për dhënie ekspertize nga ana e njohësve të procesit të integritetit në vendet pritëse, të gatshëm për te na asistuar, etj.

24.1 Rekomandimi: MEPJ të standardizojë një format raporti javor diplomatik të ndarë në rubrika, ku të parashikohen edhe rubrika të dedikuara problematikave të procesit të integritetit, plotësimi i të cilave të jetë i detyrueshëm nga stafet e përfaqësive.

Afati: Brenda tremujorit

MEPJ: MEPJ nuk ka një format raporti javor, por përfaqësitë në shtetet e BE-së furnizojnë herë pas here me qëndrime të vendeve ku janë akredituar apo me çështje të tjera të BE-së.

Statusi zbatimit: I pazbatuar.

25. Gjetje nga auditimi: Askund në faqet zyrtare të ambasadave nuk ka nënfaqe apo rubrikë dedikuar informacionit që ofrohet nga shteti shqiptar lidhur me procesin e integritetit, apo shprehjen, nga ana e shtetit shqiptar, e interesit të bashkëpunimit me administrata qendrore dhe lokale vendase, me OJF, ekspertë, etj. Ndërkohë që MEPJ ka një faqe zyrtare të formatuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

ndryshe dhe ofron informacion lidhur me procesin, veçanërisht tani pasi është asistuar nga GIZ, lidhur me përmirësimin e komunikimit për çështjet e integritetit në BE.

25.1 Rekomandimi: MEPJ të standardizojë faqet zyrtare të përfaqësive të RSH-së në vendet anëtare të BE-së, duke përfshirë një nënfaqe (rubrikë) me një përmbajtje që pasqyron hap pas hapi procesin e integritetit dhe nevojat e vendit tonë lidhur me këtë proces.

Afati: Brenda tremujorit

MEPJ: MEPJ ka një faqe web të dedikuar për integrimin evropian që përditësohet vazhdimisht. Do të vlerësohet nëse linku tek kjo rubrikë e faqes së MEPJ mund të shtohet në faqet zyrtare të përfaqësive të RSH në vendet anëtare të BE-së

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

26. Gjetje nga auditimi: Duke pasur parasysh se transparenca në komunikimet publike duhet të jetë një kriter i përhershëm pune, si dhe duke pasur parasysh se procesi i çeljes së negociatave do të jetë i gjatë dhe i artikuluar në gjurmët e diskutimit të 33+2 kapitujve, vlerësohet se do të jetë i nevojshëm krijimi i një baze të dhënash publike, mbi ekspertët e akredituar për të asistuar shtetin shqiptar në procesin e integritetit. Kjo bazë të dhënash duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga çdokush dhe vijimisht e përditësuar me prurje të reja ekspertesh, vendas dhe të huaj.

26.1 Rekomandimi: MEPJ të formatojë dhe mbajë aktiv një Regjistër Kombëtar të Ekspertëve në Çështjet e Integritetit, lehtësisht të aksesueshem nga publiku dhe të përditësuar vijimisht, sipas nevojave të procesit të integritetit.

Afati: Brenda tremujorit dhe në vijimësi

MEPJ: Nuk u pa më si domosdoshmëri pas 2018, duke qenë se në atë kohë filloi të ngrihej edhe struktura negociuese. Presupozohet që kompetenca e negociatave gjendet brenda GNP-ve. Kjo do të rivlerësohet me nisjen e negociatave dhe faktikisht përgjatë periudhës screening të Komisionit, ku do të shihet edhe kompetenca brenda GNP për kapitujt.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

27.1 Rekomandimi: MEPJ në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të ndërmarrë hapa për përcaktimin e tarifave për konsulentat e ekspertëve të integritetit, si dhe të paraqesë propozimet e saj për çeljen e zërave buxhetore, për marrjen e këtij shërbimi.

Afati: Brenda fundit të vitit

MEPJ: Për nevojat e konsulentave për negociatat është krijuar edhe Platforma e Partneritetit që funksionon në dy nivele, tryezat në çdo kapitull negociues dhe Bordi i përbërë nga përfaqësues të administratës dhe të aktorëve jo shtetërore. Tryezat e partneritetit të Platformës së Partneritetit janë krijuar me synimin që të angazhojnë edhe ekspertizën përtej administratës shtetërore. Ekspertiza përtej administratës në negociatat mendohet se do të thithet prej tyre. MEPJ do të sigurojë ekspertizën edhe duke angazhuar asistencë teknike të BE dhe bilaterale, duke angazhuar fonde të huaja dhe duke vënë si përfitues institucionet që do kryejnë negociatat.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

28. Gjetje nga auditimi: Ruajtja me fanatizëm dhe valorizimi në të gjitha dimensionet e veta, të profesionalizmave të cilët kultivohen e maturohen pranë njësive koordinuese të procesit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

integritetit duhet të jenë pjesë e politikave institucionale, në të mirë realizimit efektiv të objektivave. Pikërisht këtë nuk kanë pasur parasysh gjatë procesit të bashkimit të dy ministrive.

28.1 Rekomandimi: Në cilindo rast ndryshimesh të strukturave të njësive të dedikuara në koordinimin e procesit të integritetit, MEPJ të jetë e vëmendshme dhe të mos mjaftohet me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil, nr. 152/2013, por të angazhohet në shmangien e largimit të çdo punonjësi, në respekt të kriterit financiar për strukturën dhe në respekt të kriterëve të performancës për punonjësit, në mënyrë që të mos krijohen mangësi në staf të profesionalizuar.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: Rekomandimi është marrë në konsideratë

Statusi zbatimit: I pazbatuar.

29. Gjetje nga auditimi: Strukturat homologe me të cilat Drejtoria e Fondeve të BE-së bashkëpunonte dhe pas shkrirjes së MIE-s, vijonin të ishin të ndryshme për programet kombëtare të IPA-s dhe ato të bashkëpunimit Territorial, çka sjell dy linja drejtimi dhe koordinimi të ndryshme dhe të pavarura nga njëra-tjetra, duke e bërë ndarjen në dy Drejtori, një opsion të nevojshëm për rritjen e efektivitetit të koordinimit të asistencës financiare të BE-së. Moszbatimi i kriterit të modelit më të mirë, të aplikuar nga strukturat homologe edhe në këtë fazë të ndryshimeve të strukturave nga pikëpamja organizative, vijon të çënojë rëndë efektivitetin e koordinimit të asistencës financiare të BE-së. Bile, ky problem organizativ u shfaq me shkrirjen e dy ministrive, meqë më parë në MIE dy drejtoritë ishin të ndara. Kjo zgjedhje organizative e papërshtatshme ndikon negativisht në kapacitetet administrative dhe në efektivitetin e koordinimit.

- Nga ana tjetër për një absurd që lidhet me nominalizma strukturash dhe jo mision dhe funksione të ushtruara konkretisht prej tyre, Sektori i të Drejtës Evropiane mbetet pjesë e Drejtorisë së të Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare, pavarësisht se si mision ka kontrollin e transpozimit të projekt akteve me legjislacionin e BE-së të hartuara dhe dërguara për konsultim nga ministritë e linjës. “Kjo ndarje krijonte një shkëputje të pajustificuar të politikave (Drejtorja e BE) nga legjislacioni (Sektori i të Drejtës Evropiane në DDNE), ndërkohë që ato janë e njëjta gjë: p.sh. procesi i raportimit për një kapitull të caktuar përfshin pikësëpari ecurinë e transpozimit të legjislacionit të atij kapitulli, si dhe kapacitetet institucionale për zbatimin e legjislacionit të transpozuar. Nga ana tjetër, në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare nuk kishte asnjë lidhje funksionale midis Sektorit të të Drejtës Ndërkombëtare dhe Sektorit të të Drejtës Evropiane”.

- Sikurse përmendur edhe më lart, nga evidenca audituese rezulton se: “.... Zgjerimi i portofolit të Ministrisë (MEPJ) solli sigurisht një rritje të numrit të proceseve të punës, intensifikim të tyre dhe mbingarkesë për nivelet e larta hierarkike”. Gjithë spektri i njësive të MEPJ, që koordinojnë procesin e integritetit, tashmë pas Urdhrit të Kryeministrit nr. 138, datë 21.10.2019, duke filluar nga zbatimi i tij, do raportojnë tek Sekretari i Përgjithshëm dhe tek zv. Ministri për Evropën, gjithnjë nëse nuk ndodhin ndryshime për efekt të zgjedhjes së Kryenegociatorit. Aktiviteti i koordinimit të procesit të integritetit me të gjithë ngarkesën e vet krijojnë një trysni të papërballueshme për një përcjellje efektive të tij nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili mbart mbi përgjegjësinë e tij funksionimin e gjithë dikasterit dhe të gjithë Shërbimit të Jashtëm Diplomatik. Përmasat dhe volumi i punës që duhet evaduar prej tij, rrezikon që ndjekja e koordinimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

procesit, të jetë tejet e vështirë e ndofta dhe e pamundur mbajtja e ritmit të agjendave në ndonjë rast. Duke pasur parasysh se ritmi i zhvillimeve nuk lejon vonesa, si dhe kërkon një thellim në aspekte të caktuara të këtij aktiviteti koordinues, vlerësohet i nevojshëm krijimi i një Drejtorie të Përgjithshme. Nga njëra anë, Sekretari i Përgjithshëm do lirohej nga një ngarkesë e përballueshme me risk në efektivitet, duke iu dedikuar gjithë masës tjetër të detyrimeve funksionale të tij. Nga ana tjetër, bashkimi i Drejtorisë së Bashkimit Evropian, i Drejtorisë për Koordinimin e Programeve IPA Kombëtare dhe Rajonale dhe Drejtorisë për Bashkëpunim Territorial nën vartësinë e një

Drejtori të Përgjithshëm, do i jepte një fizionomi më unitare njësive të MEPJ të angazhuara me koordinimin e procesit të integritetit dhe do të rriste efektivitetin e tyre koordinues.

29.1 Rekomandimi: MEPJ të vlerësojë mundësinë e propozimit për miratimin të një akti rregullator nga ana e qeverisë, i cili të parashikojë krijimin e një Drejtorie të Përgjithshme, e cila të ketë në vartësinë e saj: Drejtorinë e Bashkimit Evropian, Drejtorinë për Koordinimin e Programeve IPA Kombëtare dhe Rajonale, si dhe Drejtorinë për Bashkëpunim Territorial

Afati: Brenda tremujorit të ardhshëm

MEPJ: Në vijim të formimit të qeverisë së ardhshme në shtator dhe përgjegjësisë shtetërore të MEPJ.

Statusi zbatimit: I pazbatuar.

30. Gjetje nga auditimi: Referuar sa na është vënë në dispozicion nga MEPJ, në vijim të disa kërkesave të përsëritura të Grupit të Auditimit, për periudhën objekt auditimi, si MIE, si MPJ, ashtu edhe MEPJ nuk na rezulton të kenë pasur rregullore për organizimin dhe funksionimin e tyre të brendshëm. Mungesa e një akti rregullator të brendshëm, sikurse rregullorja mbi funksionimin dhe organizimin e MEPJ, është në shkelje të ligjit. Neni 29 e Ligjit 90/2012 parashikon: “Rregulloret e brendshme”

1. Këshilli i Ministrave miraton rregullore brenda kuadrit të legjislacionit të përgjithshëm përkatës, për standardet e përbashkëta të menaxhimit në institucionet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore, procedurat e punës dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive administrative dhe institucionet e administratës shtetërore.

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

3. Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme. Sipas dispozitave kalimtare të ligjit, rregullorja duhej të ishte miratuar brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra maksimumi në 2014.

30.1 Rekomandimi: Miratimin nga MEPJ të rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm.

Afati: Brenda qjashtëmujorit të ardhshëm

MEPJ: Në vijim të formimit të qeverisë së ardhshme në shtator dhe përgjegjësisë shtetërore të MEPJ

Statusi zbatimit: I pazbatuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

31. Gjetje nga auditimi: NJQV nuk kanë ngritur struktura të Njësive të Integritimit Evropian (NJIE), brenda strukturave të saj administrative ekzistuese, në përputhje me kërkesat ligjore të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pika 1.

31.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër, të marra masa për ngritjen e strukturës së integritimit evropian pranë Bashkisë Shkodër, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 450, datë 26.7.2018.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Shkodër: Bashkia Shkodër duke qenë një rajon kufitar, me një traditë të hershme të shkëmbimeve dhe bashkëpunimit ekonomik, aktualisht në fokus të disa programeve evropiane të bashkëpunimit ndërkufitar, ka parashikuar në strukturën e saj organizative sektorin e planifikimit strategjik dhe statistikave si sektorin përgjegjës për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve të Bashkimit Evropian. Në pozicionin e punës së këtij sektori janë specifikuar detyrat e nëpunësve civil që kanë të bëjnë specifikisht me bashkërendimin dhe koordinimin e procesit evropian. Rrjedhimisht këto detyra janë të materializuara edhe në përshkrimet e punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese. Në mbështetje të nismave të tilla, me datë 05.12.2016 është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit për projektin “Bashkitë për Evropën”, financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian ndërmjet Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrisë së Integritimit Evropian, 61 bashkitë e Shqipërisë të përfaqësuara nga shoqata për Autonominë Vendore dhe Shoqata e Bashkive. Në zbatim të kësaj marrëveshje, palët bien dakord që të bashkëpunojnë më qellim forcimin e kapaciteteve të bashkive për çështjet e BE. Bashkia Shkodër e mbështeti këtë nismë, duke qenë se përgjegjësitë e përcaktuara në këtë marrëveshje janë vazhdim i punës së sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Statistikave. Ndonëse marrëveshja e mirëkuptimit për projektin ‘Bashkitë për në Evropë’ u nënshkrua me datë 05.12.2016, vetë projekti ‘Bashkitë për në Evropë’ u lancua në Konferencën Kombëtare me datë 11 tetor 2017, në Bashkinë Lushnje, me ftesën e Ambasadores së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Znj. R.V. Prandaj vonesa në ngritjen e zyrës së çështjeve të BE-së nuk i adresohet diferencës në kohë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, në datën e ngritjes së urdhrit për caktimin e koordinatorit dhe zv. koordinatorit, pasi:

1. Implementimi i projektit startoi nga Delegacioni i Bashkimit Evropian me datë 11 tetor 2017, në Bashkinë Lushnje. Pas lancimit të projektit, me kërkesën e stafit të projektit filloi puna njëherazi për 61 bashkitë në vend me nxjerrjen e urdhrit për ngritjen e grupit të punës dhe ngritjen e zyrës së çështjeve të BE-së pranë secilës bashki. Në përgjigje të kësaj kërke, Bashkia Shkodër ngriti Urdhrin nr. 840, datë 27.10.2017, për caktimin e koordinatorit dhe zv. koordinatorit, detyrat e të cilëve ishin përcaktuar nga vetë projekti për 61 bashkitë në vend. (bashkëlidhur gjeni përshkrimin e punës për stafet e 61 bashkive në vend).
2. Këto dy nëpunës civil (koordinatori dhe zv. koordinatori) kanë mbuluar edhe më përpara procesin e ‘integritimit evropian’ në Bashkinë Shkodër.
3. Këndi i BE në Bashkinë Shkodër u inaugurua me datë 21 tetor 2017.

Me mbështetjen e projektit “Bashkitë për Evropën”, Këshilli i Ministrave me vendim nr. 450, datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integritimit Evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore përcaktoi përgjegjësitë e strukturës së integritit evropian për bashkërendimin e strukturave administrative dhe përfaqësimin e bashkisë në marrëdhënie me strukturat e qeverisjes qendrore përgjegjëse për integrimin evropian, me qëllim realizimin e funksioneve të veta apo të deleguara në kuadër të procesit të integritit evropian dhe të zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces. Prandaj duke qenë se përgjegjësitë e përcaktuara në projektin “Bashkitë për në Evropë” por edhe VKM 450, datë 26.07.2018 janë vazhdim i punës së sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Statistikave, me Vendimin e kryetarit të Bashkisë Shkodër, nr. 210, datë 28.09.2018 është bërë ndryshimi i emërimit të sektorit të planifikimit strategjik dhe statistikave nga Sektori i Planifikimit dhe Statistikave në Sektori i Planifikimit, Statistikave dhe Koordinimit të Projekteve të Integritit Evropian. Në zbatim të VKM nr. 450, datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integritit Evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit të Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore, ne kemi integruar në mënyrë të përmbledhur detyrat e përcaktuara në VKM në buxhetin e vitit 2019 dhe programin buxhetor afatmesëm 2019-2021, së bashku me fishat e tjera që kanë ekzistues që kanë si tematikë integrimin evropian. Kjo gjë është përdorur si model suksesi nga projekti Bashkitë për Evropën dhe është marrë si model për edhe për bashkitë e tjera në vend. Në respektim të rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të KLSH, Bashkia Shkodër me Vendim nr. 316, datë 05.07.2021 bëri një ndryshim në vendimin nr. 02 datë 05.01.2021 "Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, në këtë kuadër u miratua me Vendim 341, datë 09.05.2021 rregullorja e brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. (Bashkëlidhur gjeni Vendim nr. 316, datë 05.07.2021)

Statusi zbatimit: I zbatuar.

32. Gjetje nga auditimi: MEPJ (dhe ish-MIE) nuk e ka ndjekur procesin e ngritjes së NJIE pranë NJQV, në kundërshtim me VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, pika 3, germa a.

32.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marra masa për ngritjen e strukturës së integritit evropian pranë Bashkisë Vlorë, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 450, datë 26.7.2018.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Vlorë: Me vendim nr.26, datë 08.06.2020, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve Vartëse-2020, është miratuar Drejtoria e Integritit Evropian dhe Investimeve të Huaja. Kjo drejtori ka në përbërje të saj një drejtor dhe dy specialistë.

Statusi zbatimit: I zbatuar.

33. Gjetje nga auditimi: MEPJ (dhe ish-MIE) nuk konstatohet të ketë mbështetur NJQV në përcaktimin e fushave, prioritetëve dhe/ose çështjeve ku duhet të orientohet kërkesa e tyre për asistencën e Bashkimit Evropian, në kundërshtim me VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, pika 3, germa c.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

33.1 Rekomandimi: Nga Ministri dhe Drejtoria e BE në MEPJ, në bashkëpunim me AMVV dhe Ministrinë e Brendshme, të merren masat detyruese ndaj NJQV për ngritjen e strukturave të NJIE brenda strukturave të tyre administrative ekzistuese.

Afati: Brenda datës 31.12.2020

MEPJ: MEPJ nuk ka asnjë tagër të detyrojë mbi qeverisjen vendore dhe nuk është ministria përgjegjëse për menaxhimin e saj. Por bazuar në përgjegjësinë shtetërore të koordinimit për IE dhe të tagrit që i jep VKM 450/2018, MEPJ ka pasur një fokus të veçantë për këtë detyrë. Pas letrës së Ministrit të Punëve të Jashtme në detyrë për kryebashkiakët në të 61 bashkitë e vendit me 1 qershor 2020, MEPJ ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Brendshme, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Delegacionin e BE për situatën e ngritjes së NJIE nëpër bashkitë e vendit. Duke e konsideruar një aspekt të rëndësishëm të procesit të integritetit që përfshin zbatimin e MSA dhe negociatat e ardhshme, por për të cilën nuk ka përgjegjësi e vetme, MEPJ është në kërkim të informacionit mbi institucionalizimin e Njësive të IE në bashkitë e vendit. Raportimet për këtë i kemi marrë deri në mars 2021, ku na rezulton se vetëm Bashkia Vorë nuk kishte deri atëherë as njësi e as person të dedikuar. Në vijim do të kemi një komunikim të dedikuar për gjendjen e strukturave sapo kjo të na certifikohet nga AMVV.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

34. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion rreth Bashkimit Evropian dhe procesit të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit në BE. Nisur nga numri i lartë i azilkërkuesve shqiptarë në Evropë gjatë viteve të fundit dhe migracionit të paligjshëm, si dhe ngritjes së problematikës në instancat më të larta të Bashkimit Evropian si një nga kushtet që vendi duhet të plotësojë me qëllim çeljen e negociatave, në asnjë nga faqet zyrtare të këtyre bashkive nuk është publikuar informacion në lidhje me këtë proces, duke u vënë theksi tek penalizimet e këtij fenomeni.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së (IPA etj.). Konkretisht qytetarët e Shkodrës dhe Vlorës, nuk kanë mundësi të informohen në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së dhe procedurat që duhet të ndjekin për aplikimin për këto programe, përveç paraqitjes pranë zyrave të Njësive të Integritetit të bashkive respektive.

- Informacioni i publikuar nga bashkitë Vlorë dhe Shkodër, nuk ka formë dhe përmbajtje të unifikuar, në kundërshtim me pikën 2/ë, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

34.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së në faqes zyrtarë të Bashkisë Shkodër, me informacionin e plotë rreth proceseve integruese të Shqipërisë në BE, programet e ndryshme të financimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit, si dhe marrjen e masave që ky informacion të jetë në formë dhe përmbajtje të unifikuar me Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Shkodër: Ky rekomandim është përmbushur nga Bashkia Shkodër⁶

Statusi zbatimit: I zbatuar.

35. Gjetje nga auditimi: Këndi i BE i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Bashkisë Vlorë, nuk është në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për projektin “Bashkitë për në Evropë”, si dhe me pikën 2/e, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës së bashkive, lidhur me procesin e integritetit evropian.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë janë shprehur se kryejnë plotësimin e matricës së Vlerësimit të Performancës së Bashkive në mënyrë periodike, por në faqe zyrtare të këtyre bashkive, nuk u gjet asnjë publikim në lidhje me këto raporte.

35.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës i Bashkisë Shkodër, lidhur me procesin e integritetit evropian.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Shkodër: Ky rekomandim është përmbushur nga Bashkia Shkodër⁷

Statusi zbatimit: I zbatuar.

36.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për publikimin në Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër, të gjithë aktivitetet të lidhura me proceset integruese të kryera nga Bashkia Shkodër, si dhe informacionit të plotë lidhur me këto aktivitete.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Shkodër: Ky rekomandim është përmbushur nga Bashkia Shkodër, por sjellim në vëmendje që për shkak të ngarkesës së faqes web të bashkisë Shkodër është e pa mundur që të gjitha fotot të publikohen në web. Prandaj pothuajse të gjitha aktivitetet Bashkia Shkodër i publikon në rrjetet sociale të saj⁸.

Statusi zbatimit: I zbatuar.

37. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion rreth Bashkimit Evropian dhe procesit të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit në BE. Nisur nga numri i lartë i azilkërkuessve shqiptarë në Evropë gjatë viteve të fundit dhe migracionit të paligjshëm, si dhe ngritjes së

⁶ http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkimi_Evropian_dhe_Projektet_180_1.php

⁷ http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_ne_proceset_e_integritetit_evropian_1294_1.php

⁸ <http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

problematikës në instancat më të larta të Bashkimit Evropian si një nga kushtet që vendi duhet të plotësojë me qëllim çeljen e negociatave, në asnjë nga faqet zyrtare të këtyre bashkive nuk është publikuar informacion në lidhje me këtë proces, duke u vënë theksi tek penalizimet e këtij fenomeni.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së (IPA etj.). Konkretisht qytetarët e Shkodrës dhe Vlorës, nuk kanë mundësi të informohen në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së dhe procedurat që duhet të ndjekin për aplikimin për këto programe, përveç paraqitjes pranë zyrave të Njësive të Integritetit të bashkive respektive.

- Informacioni i publikuar nga bashkitë Vlorë dhe Shkodër, nuk ka formë dhe përmbajtje të unifikuar, në kundërshtim me pikën 2/ë, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

37.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, me informacionin e plotë rreth proceseve integruese të Shqipërisë në BE, programet e ndryshme të financimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit, si dhe marrjen e masave që ky informacion të jetë në formë dhe përmbajtje të unifikuar me Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Vlorë: Bashkia Vlorë ka publikuar në mënyrë periodike të gjitha aktivitetet e realizuara në lidhje me BE.

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni shoqërues, për rrjedhojë ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

38. Gjetje nga auditimi: Këndi i BE i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Bashkisë Vlorë, nuk është në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për projektin “Bashkitë për në Evropë”, si dhe me pikën 2/e, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës së bashkive, lidhur me procesin e integritetit evropian.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë janë shprehur se kryejnë plotësimin e matricës së Vlerësimit të Performancës së Bashkive në mënyrë periodike, por në faqe zyrtare të këtyre bashkive, nuk u gjet asnjë publikim në lidhje me këto raporte.

38.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës i Bashkisë Vlorë, lidhur me procesin e integritetit evropian.

Afati: Brenda datës 30.09.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Bashkia Vlorë: Bashkia Vlorë ka publikuar në mënyrë periodike të gjitha aktivitetet e realizuara në lidhje me BE. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni shoqërues, për rrjedhojë ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

39.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për publikimin në Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, të informacionit të plotë në lidhje me aktivitetet zhvilluara nga Bashkia Vlorë për proceset integruese të Shqipërisë.

Afati: Brenda datës 30.09.2020

Bashkia Vlorë: Bashkia Vlorë ka publikuar në mënyrë periodike të gjitha aktivitetet e realizuara në lidhje me BE. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni shoqërues, për rrjedhojë ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

40. Gjetje nga auditimi: MEPJ nuk ka publikuar një kalendar të plotë të trajnimeve që parashikon të kryejë. Bashkia Vlorë nuk ka organizuar dhe marrë pjesë në trajnime të kryera për proceset

e integruese të Shqipërisë në BE.

40.1 Rekomandimi: MEPJ në fund të çdo viti të kryejë publikimin e listës së aktiviteteve trajnuese që parashikon të kryejë gjatë vitit, si dhe të marrë masa për vënien në dijeni të NJQV për këto trajnime.

41.1 Rekomandimi: MEPJ të marrë masa që për trajnimet që parashikon të kryejë, të marrë në konsideratë edhe nevojat konkrete të NJQV.

Afati: Brenda datës 31.12.2020 dhe në vijimësi

MEPJ: Rekomandimet do të merren në konsideratë. Por MEPJ nuk kryen vetë aktivitete trajnuese, por duke qenë koordinatori kombëtar i IE, ka tagër të kërkojë nga kushdo ofron trajnime një komponent për pushtetin vendor. ASPA, në dijeninë tonë, ofron trajnime edhe për pushtetin lokal. Në rast se këto trajnime do t'i ofrojnë asistencat e huaja teknike do të ketë një komunikim të dedikuar me NJQV-të.

Statusi zbatimit: I pazbatuar.

42. Gjetje nga auditimi: Bashkitë Shkodër dhe Vlorë, me gjithë mangësitë e konstatuara, nuk rezultojnë të jenë drejtuar MEPJ për informim dhe asistencë në lidhje me proceset integruese.

42.1 Rekomandimi: MEPJ në bashkëpunim me AMVV, të marrë masa për vendosjen e urave të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe NJQV, me qëllim mbështetjen, koordinimin dhe monitorimin forcimin e kapaciteteve të bashkive për përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian të Shqipërisë.

Afati: Brenda datës 31.12.2020 dhe në vijimësi

MEPJ: Në rast se këto trajnime do t'i ofrojnë asistencat e huaja teknike do të ketë një komunikim të dedikuar me NJQV-te.

Statusi zbatimit: I pazbatuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

43. Gjetje nga auditimi: Mungesa e informacionit për NJQV-të mbi partnerët e suksesshëm, sikurse dhe mungesa e informacionit nga ana e MEPJ-së mbi arsyet e mosuksesit të NJQV-ve në aplikimet për projekte IPA, është tregues i një komunikimi jo efektiv dhe mosangazhimi në nivelin e duhur nga ana e MEPJ-së.

43.1 Rekomandimi: MEPJ të sigurojë vënien në dispozicion të aplikantëve për projekte IPA, për çdo program, të një baze të dhënash mbi partnerët e mundshëm.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: Nuk është në tagrin e MEPJ-së të publikojë një listë partnerësh pasi kjo do të çonte në shkelje të parimit të barazisë në aplikimet për thirrje. Nuk është e mundur që MEPJ të udhëzojë se cilin partner duhet të zgjedhë një bashki apo jo, pasi do të ndërhynte në kompetenca që nuk i takojnë. Në çdo rast të shpalljeve të thirrjeve për projekt – propozime MEPJ kryen dhe zhvillon ditë informuese ku ftohen përfaqësues të autoritete lokale dhe OJF, gjithashtu MEPJ organizon forumet e partneritetit dhe trajnime mbi mënyrën e aplikimit për projekte. Përveç forumeve të partneritetit (këto forume rol kryesor kanë mundësimin e NJQV dhe OJF-ve për të lidhur partneritete të ndryshme) që MEPJ në bashkëpunim me partnerët për programet specifike organizon, në çdo rast lista e partnerëve të mundshëm ju vihet në dispozicion sipas kërkesës dhe interesit secilit autoritet lokal. Gjatë thirrjeve të fundit për projekt-propozime MEPJ ka siguruar dhe ka insistuar që partneriteti me një autoritet lokal të jetë i detyrueshëm në udhëzimin për aplikantë, duke forcuar kështu rolin e NJQV për të qenë pjesë e aplikimeve.

MEPJ pretendon se nuk ka tagër të publikojë listë partnerësh, por në lidhje me rekomandimin ka kryer ditë informuese dhe ka insistuar që partneriteti me autoritetet lokale të jetë i detyrueshëm. Për rrjedhojë konsiderohet i zbatuar pjesërisht dhe jo i plotë.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

44.1 Rekomandimi: MEPJ të kërkojë dhe sigurojë informacion periodik dhe të përditësuar nga Sekretariatet Teknike të Programeve dhe bashkitë, lidhur me ecurinë e pjesëmarrjes së NJQV-ve në aplikime dhe zbatime projektesh IPA.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: Nuk ka ndonjë detyrim ligjor mbi llogaridhënien e NJQV për ti raportuar MEPJ për numrin e aplikimeve që ata kryejnë pranë Autoriteteve Kontraktuese DBE apo Autoritet Menaxhues. Ky proces është i pavarur dhe roli i MEPJ është koordinues dhe informues në këtë rast. Aplikimet për projekte nuk bëhen pranë MEPJ-së por në sistemet e ngritura nga Komisioni Evropian dhe Autoritetet Menaxhuese të programeve. Sigurisht MEPJ në bashkëpunim me Sekretariatet teknike mbledhin informacion të përgjithshëm për aplikantët për të pasur statistika mbi trendin e aplikimeve. Sikurse përmendur më lart, gjatë thirrjeve të fundit për projekt-propozime MEPJ ka siguruar dhe ka insistuar që partneriteti me një autoritet lokal të jetë i detyrueshëm në udhëzimin për aplikantë, duke forcuar kështu rolin e NJQV.

Në lidhje me zbatimin e projekteve, MEPJ është e informuar vazhdimisht për problematikat që hasin jo vetëm NJQV por të gjithë përfituesit e projekteve. Komunikimi me Sekretariatet Teknike për performancën e përfituesve është i vazhdueshëm.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

45. Gjetje nga auditimi: Mbulimi i kuotës së bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit do të ndikonte pozitivisht në performancën e partnerëve shqiptarë dhe do të rriste përqindjen e përthithjes së donacionit të BE. Kjo gjë aktualisht nuk bëhet.

45.1 Rekomandimi: KKIPA të insistojë në të gjitha nivelet e diskutimit dhe të vendimmarrjes për miratimin e një akti normativ, i cili parashikon mbulimin e kostos së bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit.

Afati: Deri në fund të vitit

MEPJ: Me iniciativë të KKIPA në MEPJ dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u ngrit grupi i punës i cili hartoi VKM-në mbi mbulimin e bashkëfinancimit dhe para financimit. Drafti i kësaj VKM-je u dërgua për mendim në Ministrinë e Linjës nga MFE si institucioni përgjegjës për miratimin dhe menaxhimin e këtij fondi rezervë, dhe bashkëpropozuese MEPJ. KKIPA nuk është pjesë e strukturës së MEPJ nga muaj Maj i vitit 2020. VKM –ja është akoma në proces për miratim.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

46. Gjetje nga auditimi: Procedura aktuale e rimbursimit të TVSH ka rezultuar mjaft problematike dhe janë shumë të pakta rastet kur ajo i rikthehet zbatuesit të projektit, pavarësisht legjislacionit në fuqi, dhe specifikisht Ligjit 37/2015, Neni 28, pika 2. Në germën c, të këtij neni dhe pike, thuhet: “Përfashtimi i parashikuar në paragrafin “b” fiton efektet e kryhet parimisht, me përjashtim “ex ante”. Kur kjo është teknikisht dhe/ose praktikisht e pamundur, përjashtimi kryhet përmes rimbursimit/zbritjes së shumave”. Ndaj ajo që kërkohet, për këtë problem, është vetëm një respektim aktesh normative në fuqi (sipas kriterit të rangut të burimeve të së drejtës) dhe jo një zgjidhje mbi bazën e kriterëve të tjera (politike, sociale, etj.).

46.1 Rekomandimi: KKIPA të ushtrojë gjithë autoritetin e tij, duke bashkëpunuar me MFE për zbatimin rigoroz të Ligjit 37/2015 (neni 28, pika 2), i cili parashikon edhe përjashtimin paraprakisht nga TVSH (në germën b) të çdo prokurimi/shpenzimi që bëhet në kuadër të projekteve të financuara nga BE, nëpërmjet pajisjes me një certifikatë specifike nga Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

MEPJ: Është miratuar Udhëzim Nr. 34, datë 5.12.2019 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili shpjegon procedurën e rimbursimit të TVSH-s.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht

47. Gjetje nga auditimi: Vonesat e MFE-së në çeljen e llogarive bankare të dedikuara, kanë sjellë vonesa dhe pasoja në zbatimin e projekteve IPA. Po ashtu dhe zbatimi jo koherent i kriterëve të nevojshme, për çeljen e llogarive ka ndikuar në vonesa të pajustificueshme.

47.1 Rekomandimi: KKIPA të ushtrojë gjithë autoritetin e tij, duke kërkuar që MFE-ja të qartësojë dhe lehtësojë procedurat e çeljes së llogarive bankare për zbatuesit e projekteve IPA, si dhe të unifikojë praktikën në çdo rrethanë.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

MEPJ: Udhëzimi i ri mbi lehtësimin e procedurave për hapjen e llogarive bankare nga MFE është miratuar. Udhëzimi nr. 35. Datë 21.9.2020.

Statusi zbatimit: I zbatuar.

48. Gjetje nga auditimi: Paqartësia lidhur se me cilin sistem rregullash duhet të bëhen prokurimet nga përfituesit e fondeve IPA, rrit pasigurinë e tyre lidhur me ligjshmërinë e aktivitetit financiar që zhvillojnë. Nga ana tjetër, problemin e njohur dhe te pranuar edhe nga ana e MEPJ, mbi konfuzionin e krijuar nga dyzimi i mësipërm, asnjëra nga bashkitë, nuk arriti t’a dokumentojë me një rast konkret

48.1 Rekomandimi: KKIPA të ushtrojë gjithë autoritetin e tij dhe së bashku me MFE-në të angazhohen për te qartësuar pashmangshmërinë e ndjekjes së Rregullores PRAG, nga të gjithë përfituesit e fondeve IPA, si dhe të informojnë të gjitha agjencitë e auditimit për këtë kriter normativ, duke garantuar kështu unifikimin e praktikave, si në zbatimin e programeve, ashtu dhe në auditimin e tyre.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: PRAG është një rregullore e KE e cila rekomandohet të përdoret për prokurimet e fondeve të BE-së, megjithatë kjo rregullore nuk përjashton prokurimin e këtyre fondeve edhe sipas legjislacionit kombëtar të vendit përfitues. Në këtë kontekst, ky është një vendim që merret nga institucioni përfitues dhe jo MEPJ. Komisioni Evropian nëpërmjet Autoriteteve Manaxhuese është në fazë diskutimi dhe konsultimi me vendet përfituese IPA të Ballkanit Perëndimor mbi unifikimin dhe përdorimin e rregullave të prokurimit për fondet e BE.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

50.1 Rekomandimi: KKIPA të garantojë përkthimin në shqip të rregullave PRAG për të mundësuar sigurinë e njohjes të këtyre rregullave, në shërbim të aktiviteteve audituese.

Afati: Në vijimësi

MEPJ: PRAG është një dokument pune i cili rishikohet çdo vit nga Komisioni Evropian. Gjuha e punës gjatë proceseve që mbulon ky dokument (prokurim, kontraktim) është gjuha angleze, për shkak se aplikohen rregullat e kontrollit dhe auditimit nga Komisioni Evropian. Nuk është në tagrin e KKIPA të përkthejë këto rregulla.

Statusi zbatimit: I pazbatuar

51. Gjetje nga auditimi: Mungesa e një politike mbajtjeje stafi, për strukturat e menaxhimit dhe koordinimit IPA pranë NJQV-ve ndikon në uljen e kapaciteteve profesionale pranë tyre, duke krijuar situata vështirësie dhe pamundësie për hartimin dhe zbatimin e projekteve IPA.

51.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të konsolidojë arkivin e aktivitetit që zhvillon në kuadër të pjesëmarrjes në programet IPA.

Afati: Brenda tremujorit

Bashkia Shkodër: Ky rekomandim është përmbushur nga Bashkia Shkodër.⁹

Statusi zbatimit: I zbatuar.

⁹ http://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/Bashkimi_Evropian_dhe_Projektet_180_1.php



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

52.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të konsolidojë arkivin e aktivitetit që zhvillon në kuadër të pjesëmarrjes në programet IPA.

Afati: Brenda tremujorit

Bashkia Vlorë: Bashkia Vlorë ka publikuar në mënyrë periodike të gjitha aktivitetet e realizuara në lidhje me BE.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

53.1 Rekomandimi: MEPJ në konsultim të ngushtë me MFE-në, të asistojnë DAP-in në hartimin e një dokumenti dedikuar politikave të mbajtjes së stafit të strukturave të menaxhimit dhe koordinimit të IPA-ve, si dhe KKIPA njëkohësisht, të ushtrojë gjithë autoritetin e tij dhe të insistojë në të gjitha nivelet e diskutimit dhe të vendimmarrjes, me objektiv miratimin e këtij dokumenti nëpërmjet një akti normativ nga Këshilli i Ministrave.

Afati: Deri në fund të vitit

MEPJ: Zyra Mbështetëse e KKIPA/ Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale IPA, pranë MEPJ-së, e ka ngritur çështjen e mbajtjes së stafit të strukturave IPA, nëpërmjet zbatimit korrekt të legjislacionit të shërbimit civil, kryerjes së analizës së ngarkesës në punë, në mënyrë që të mos mbingarkohet stafi, të sigurohen kushte të favorshme për trajnime dhe rritje profesionale. Gjithsesi, roli i ZM KKIPA është i kufizuar përkundrejt rolit të MFE (ZKA), DAP dhe KM.

Statusi zbatimit: Zbatuar pjesërisht.

V KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Shkodër, nuk e kanë përmbushur detyrimin e zbatimit të afatit 6-mujor të raportimit në KLSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Shkodër në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezulton se nga 53 masa të rekomanduara (masa organizative), janë pranuar nga subjekti 53 masa ose 100 %. Nga 53 masa të pranuarat: janë zbatuar plotësisht 14 masa, ose 26.42 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 16 masa ose 30.19%, janë në proces zbatimi 7 masa ose 13.21% dhe janë pa zbatuar 16 masa ose 30.18%. Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 26%, gjë e cila tregon se subjektet nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve

Për sa më sipër **rikërkojmë** që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Shkodër, të marrin masa të zbatojnë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Gjetje nr.2: MEPJ nuk ka marrë hapa konkret dhe efektiv lidhur me hartimin e PKIE dhe bashkëpunimin mes strukturave të integritit, pasi nuk ka një metodologji/Udhëzues të miratuar për hartimin e këtij plani.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr.2: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme sipas kërkesave VKM nr. 32, datë 19.01.2018, “Për përcaktimin e funksioneve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturave të shërbimit të jashtëm në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ngrejë një grup pune që të hartojë dhe më pas të miratohet metodologjia dhe/ose udhëzimi për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtarë për Integritetin Evropian.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr.3: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë hartimit dhe rishikimit vjetor të PKIE-së, nuk mban parasysh rekomandimet e dhëna nga shërbimet e Komisionit Evropian.

Rekomandimi nr.3: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përkatësisht Drejtoria e BE-së, Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial, të hartojnë një plan konkret pune për të arritur objektivat lidhur me procesin e Integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Afati :Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr.4: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka hartuar një rregullore për funksionimin dhe organizimin e saj.

- Drejtoritë të cilat janë pjesë e këtij procesi nuk kanë të përcaktuara dhe miratuara detyrat funksionale.

Rekomandimi nr.4: MEPJ, të ngrejë një grup pune për të hartuar një rregullore të brendshme funksionimi dhe organizimi, ku të jenë të mirë-përcaktuara detyrat dhe funksionet e gjithsecilit, dhe të miratohet nga struktura përgjegjëse e ministrisë.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr.5: Bashkia Vlorë nuk ka një strukturë përgjegjëse për integritetin, edhe pse kjo ka qenë një kërkesë e hershme dhe e rëndësishme, kjo jo vetëm për rëndësinë që sjell ky proces.

Rekomandimi nr.5: Bashkia Vlorë të krijojë një grup pune, i cili të hartojë rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e institucionit, si dhe më pas të procedohet me miratimin e saj.

Afati: Deri në Dhjetor 2021

Gjetje nr.6: Vihet re që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përkatësisht Bashkia Vlorë nuk ka pasur bashkëpunim me Qeverisjen Qendrore, si dhe nuk ka kërkuar asnjëherë nga MEPJ që të marrë të dhëna dhe të informohet lidhur me këtë proces.

Rekomandimi nr.6: Bashkia Vlorë të marrë iniciativa në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, të informojë MEPJ, si dhe sa herë të jetë e nevojshme të kërkojë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informacion të detajuar për të qenë sa me përditësuar me procesin.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje nr.7: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për procesin e integritetit ka dërguar ftesa për takim apo aktivitete që janë organizuar vetëm për vitin 2018, dhe për asnjë periudhë tjetër.

- Rritja e bashkëpunimit midis strukturave të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është një kërkesë e parashikuar në PKIE, e cila nuk ka gjetur zbatim dhe rezultate të dukshme, për vitet 2016-2019.

- MEPJ nuk ka marrë asnjë hap për të informuar strukturat përkatëse, për të siguruar pjesëmarrjen përfaqësuesve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në forumet strukturat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

konsultuese për procesin e integritetit evropian dhe të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces.

Rekomandimi nr.7: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si institucioni përgjegjës kryesor për koordinimin dhe informimin ndërinstitucional, të marrë hapa konkret dhe të ndërveprojë me Njësitë e Qeverisjes Vendore, si dhe të kërkojë periodikisht si dhe kur është e nevojshme informacion për procesin e integritetit.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje nr.8: Bashkia Vlorë, ka mangësi në realizimin e një raportimi efektiv lidhur me procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk kërkon që ky detyrim për raportim të plotësohet nga NJQV.

Rekomandimi nr.8: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të nxisë qeverisjen vendore të zbatojë kërkesat nga Bashkimi Evropian, duke qenë organi kompetent për koordinimin e PKIE, duke ushtruar detyrat funksionale, atë të llogaridhënies dhe llogari-marrjes nga strukturat përgjegjëse për integritetin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Afati: Në vazhdimësi

Gjetje nr.9: Përfshirja e punonjësve të njësive të dedikuara integritetit në Grupet Ndërinstitucionale të punës, bën të nevojshëm sintonizimin edhe profesional e formativ të tyre me këto grupe. Në një kohë kur çelja e negociatave është hapi më i afërt i procesit, duke sjelle për pasojë fillimin e diskutimit të kapitujve deri më tani të padiskutuar, punonjësit e MEPJ-së duhet të jenë të aftë të bëhen pjesë aktive e diskutimit të problematikave që do ndeshen. Ndaj do ketë nevojë për njohës të politikave të mjedisit, të bujqësisë, të energjetikës dhe rrjedhimisht, edhe të ngarkuarit e MEPJ-së që do ndjekin diskutimin e kapitujve duhet të jenë për nga formimi i tyre, më afër këtyre profileve profesionale.

Rekomandimi nr.9: MEPJ dhe DAP të ndryshojnë kriteret e punësimit, duke mos e kufizuar profilin e studimeve të përfunduara nga kandidatët që konkurrojnë për t'u punësuar, në ato të parashikuara deri më tani, por të zgjerojnë spektrin e profileve profesionale të rekrutueshme.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr.10: Punësimet e bëra në vitin 2018, pas lirimit dhe largimit të 22 punonjësve, më së paku janë të dyshimta, pavarësisht raportimit të bërë nga DAP për procesin e shkrirjes së MIE-s.

Rekomandimi nr.10: MEPJ veçanërisht në rastet kur për punësime të caktuara ka reagime nga ana e opinionit publik, duhet të gjejë format e përshtatshme për të bërë transparencë publike mbi përzgjedhjen e kandidatëve.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr.11: Në katër vitet e periudhës së auditimit, MEPJ ka raportuar vetëm në njërin vit, atë 2019, lidhur me trajnimet e stafit. Kjo nuk do të thotë, se trajnime nuk ka pasur gjatë periudhës në fjalë. Por sigurisht përderisa trajnimet nuk janë evidentuar nga MEPJ dhe nuk janë bërë pjesë e raportimit të përvitshëm ndaj Kuvendit të Republikës, do të thotë se kjo formë e ngritjes profesionale nuk është trajtuar si prioritet i politikave institucionale dhe nuk është reflektuar me seriozitetin e nevojshëm në raportimet e saj.

Rekomandimi nr.11: MEPJ të bashkëpunojë me ASPA-n dhe çdo trajnues tjetër të mundshëm, me synim që çdo vit të përgatitet një program i detajuar trajnimesh, në përputhje me nevojat reale të proceseve dhe të stafeve të dedikuara në koordinimin e procesit të integritetit dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

përfshijë në raportin e përvitshëm që i dërgon Kuvendit, një informacion të detajuar për trajnimet e zhvilluara.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr.12: Nuk ka si të quhet “... proporcional me qëllimin për të cilin është ngritur...”, mospjesëmarrja në trajnim në Shkollën Verore Evropiane, në kushtet kur MEPJ ka punësuar punonjës të rinj, që nuk kanë asnjë përvojë në çështjet e integritetit, të cilët duhej të ishin detyrimisht pjesëmarrës në këtë shkollë.

Rekomandimi nr.12: MEPJ të vlerësojë seriozisht pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve të saj, duke mos bojkotuar aktivitetet trajnuese, kur pjesëmarrja është e mundshme.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr.13: Ndryshe nga formati i përfaqësimit (1+6) i përcaktuar më herët (Ambasadori dhe 6 diplomatë), numri i diplomatëve në Misionin e RSH-së në BE, në vitin 2019 është përgjysmuar, duke e çuar përfaqësimin diplomatik, nga formati një plus gjashtë, në një plus tre.

Rekomandimi nr. 13.1: MEPJ të sigurojë pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian qëndrueshmërinë e stafit diplomatik, duke mos toleruar mungesa të tij.

Afati: Në vijimësi

Rekomandimi nr. 14.1: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadores së Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, znj. S.J.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr. 15: Paralelisht vihet re se Ambasadori A. K. është në detyrë që nga data 16 shkurt 2014. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

- Paralelisht, nga të dhënat e përcjella nga MEPJ, vihet re se Ambasadori P. Q. është në detyrë, që nga prill 2014. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

- Po ashtu, konstatohet se Ambasadori D. T. është në detyrë që nga data 26 shkurt 2013. Ligji 23/2015 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 26: “Funksioni i kreut të misionit diplomatik është, si rregull, 3 vjet”.

Rekomandimi nr.15.1: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Gjermani, z.A. K.

Rekomandimi nr.16.1: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni, z. P. Q.

Rekomandimi nr.17.1: Nisjen nga ana e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të procedurës së lirimit nga detyra të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Francë, z. D. T.

Afati: Menjëherë

Gjetje nr.18: Raporti diplomatik javor, nuk ka asnjë rubrikë, e aq më pak një rubrikë të dedikuar që t’u referohet kontributeve që aktiviteti i përfaqësive diplomatike i jep procesit të integritetit. Nuk ka një rubrikë që të informojë specifikisht dhe çdo javë MEPJ-në lidhur me:

- Partneritetet e mundshme në kuadër të IPA-ve dhe shprehje interesi në këtë plan;
- Mundësitë e bashkëpunimit të administratave të vendit pritës me ato homologe të vendit tonë, në kuadër projektesh të ndryshme;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020"

- Shprehje interesi për dhënie ekspertize nga ana e njohësve të procesit të integritetit në vendet pritëse, të gatshëm për te na asistuar, etj.

Rekomandimi nr. 18.1: MEPJ të standardizojë një format raporti javor diplomatik të ndarë në rubrika, ku të parashikohen edhe rubrika të dedikuara problematikave të procesit të integritetit, plotësimi i të cilave të jetë i detyrueshëm nga stafet e përfaqësive.

Afati: Brenda tremujorit

Gjetje nr.19: Askund në faqet zyrtare të ambasadave nuk ka nënfaqe apo rubrikë dedikuar informacionit që ofrohet nga shteti shqiptar lidhur me procesin e integritetit, apo shprehjen, nga ana e shtetit shqiptar, e interesit të bashkëpunimit me administrata qendrore dhe lokale vendase, me OJF, ekspertë, etj. Ndërkohë që MEPJ ka një faqe zyrtare të formatuar ndryshe dhe ofron informacion lidhur me procesin, veçanërisht tani pasi është asistuar nga GIZ, lidhur me përmirësimin e komunikimit për çështjet e integritetit në BE.

Rekomandimi nr.19.1: MEPJ të standardizojë faqet zyrtare të përfaqësive të RSH-së në vendet anëtare të BE-së, duke përfshirë një nënfaqe (rubrikë) me një përmbajtje që pasqyron hap pas hapi procesin e integritetit dhe nevojat e vendit tonë lidhur me këtë proces.

Afati: Brenda tremujorit

Gjetje nr.20: Duke pasur parasysh se transparenca në komunikimet publike duhet të jetë një kriter i përhershëm pune, si dhe duke pasur parasysh se procesi i çeljes së negociatave do të jetë i gjatë dhe i artikuluar në gjurmët e diskutimit të 33+2 kapitujve, vlerësohet se do të jetë i nevojshëm krijimi i një baze të dhënash publike, mbi ekspertët e akredituar për të asistuar shtetin shqiptar në procesin e integritetit. Kjo bazë të dhënash duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga çdokush dhe vijimisht e përditësuar me prurje të reja ekspertesh, vendas dhe të huaj.

Rekomandimi nr.20.1: MEPJ të formtojë dhe mbajë aktiv një Regjistër Kombëtar të Ekspertëve në Çështjet e Integritetit, lehtësisht të aksesueshem nga publiku dhe të përditësuar vijimisht, sipas nevojave të procesit të integritetit.

Afati: Brenda tremujorit dhe në vijimësi

Rekomandimi nr.21.1: MEPJ në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të ndërmarrë hapa për përcaktimin e tarifave për konsulentat e ekspertëve të integritetit, si dhe të paraqesë propozimet e saj për çeljen e zërave buxhetore, për marrjen e këtij shërbimi.

Afati: Brenda fundit të vitit

Gjetje nr.22: Ruajtja me fanatizëm dhe valorizimi në të gjitha dimensionet e veta, të profesionalizmave të cilët kultivohen e maturohen pranë njësive koordinuese të procesit të integritetit duhet të jenë pjesë e politikave institucionale, në të mirë realizimit efektiv të objektivave. Pikërisht këtë nuk kanë pasur parasysh gjatë procesit të bashkimit të dy ministrive.

Rekomandimi nr. 22.1: Në cilindo rast ndryshimesh të strukturave të njësive të dedikuara në koordinimin e procesit të integritetit, MEPJ të jetë e vëmendshme dhe të mos mjaftohet me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil, nr. 152/2013, por të angazhohet në shmangien e largimit të cilit do punonjësi, në respekt të kriterit financiar për strukturën dhe në respekt të kriterëve të performancës për punonjësit, në mënyrë që të mos krijohen mangësi në staf të profesionalizuar.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr.23: Strukturat homologe me të cilat Drejtoria e Fondeve të BE-së bashkëpunonte dhe pas shkrirjes së MIE-s, vijonin të ishin të ndryshme për programet kombëtare të IPA-s dhe ato të bashkëpunimit Territorial, çka sjell dy linja drejtimi dhe koordinimi të ndryshme dhe të pavarura



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

nga njëra-tjetra, duke e bërë ndarjen në dy Drejtori, një opsion të nevojshëm për rritjen e efektivitetit të koordinimit të asistencës financiare të BE-së. Moszbatimi i kriterit të modelit më të mirë, të aplikuar nga strukturat homologe edhe në këtë fazë të ndryshimeve të strukturave nga pikëpamja organizative, vijon të çënojë rëndë efektivitetin e koordinimit të asistencës financiare të BE-së. Bile, ky problem organizativ u shfaq me shkrirjen e dy ministrive, meqë më parë në MIE dy drejtoritë ishin të ndara. Kjo zgjedhje organizative e papërshtatshme ndikon negativisht në kapacitetet administrative dhe në efektivitetin e koordinimit.

- Nga ana tjetër për një absurd që lidhet me nominalizma strukturash dhe jo misione dhe funksione të ushtruara konkretisht prej tyre, Sektori i të Drejtës Evropiane mbetet pjesë e Drejtorisë së të Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare, pavarësisht se si mision ka kontrollin e transpozimit të projekt akteve me legjislacionin e BE-së të hartuara dhe dërguara për konsultim nga ministrinë e linjës. “Kjo ndarje krijonte një shkëputje të pajustificuar të politikave (Drejtoria e BE) nga legjislacioni (Sektori i të Drejtës Evropiane në DDNE), ndërkohë që ato janë e njëjta gjë: p.sh. procesi i raportimit për një kapitull të caktuar përfshin pikësëpari ecurinë e transpozimit të legjislacionit të atij kapitulli, si dhe kapacitetet institucionale për zbatimin e legjislacionit të transpozuar. Nga ana tjetër, në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare nuk kishte asnjë lidhje funksionale midis Sektorit të të Drejtës Ndërkombëtare dhe Sektorit të të Drejtës Evropiane”.

- Sikurse përmendur edhe më lart, nga evidenca audituese rezulton se: “.... Zgjerimi i portofolit të Ministrisë (MEPJ) solli sigurisht një rritje të numrit të proceseve të punës, intensifikim të tyre dhe mbingarkesë për nivelet e larta hierarkike”. Gjithë spektri i njësive të MEPJ, që koordinojnë procesin e integritetit, tashmë pas Urdhrit të Kryeministrit nr. 138, datë 21.10.2019, duke filluar nga zbatimi i tij, do raportojnë tek Sekretari i Përgjithshëm dhe tek zv. Ministri për Evropën, gjithnjë nëse nuk ndodhin ndryshime për efekt të zgjedhjes së Kryenegociatorit. Aktiviteti i koordinimit të procesit të integritetit me të gjithë ngarkesën e vet krijojnë një tryzni të papërballueshme për një përcjellje efektive të tij nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili mbart mbi përgjegjësinë e tij funksionimin e gjithë dikasterit dhe të gjithë Shërbimit të Jashtëm Diplomantik. Përmasat dhe volumi i punës që duhet evaduar prej tij, rrezikon që ndjekja e koordinimit të procesit, të jetë tejet e vështirë e ndofta dhe e pamundur mbajtja e ritmit të agjendave në ndonjë rast. Duke pasur parasysh se ritmi i zhvillimeve nuk lejon vonesa, si dhe kërkon një thellim në aspekte të caktuara të këtij aktiviteti koordinues, vlerësohet i nevojshëm krijimi i një Drejtorie të Përgjithshme. Nga njëra anë, Sekretari i Përgjithshëm do lirohet nga një ngarkesë e përballueshme me risk në efektivitet, duke iu dedikuar gjithë masën tjetër të detyrimeve funksionale të tij. Nga ana tjetër, bashkimi i Drejtorisë së Bashkimit Evropian, i Drejtorisë për Koordinimin e Programeve IPA Kombëtare dhe Rajonale dhe Drejtorisë për Bashkëpunim Territorial nën vartësinë e një Drejtori të Përgjithshëm, do i jepte një fizionomi më unitare njësive të MEPJ të angazhuara me koordinimin e procesit të integritetit dhe do të rriste efektivitetin e tyre koordinues.

Rekomandimi nr. 23.1: MEPJ të vlerësojë mundësinë e propozimit për miratimin të një akti rregullator nga ana e qeverisë, i cili të parashikojë krijimin e një Drejtorie të Përgjithshme, e cila të ketë në vartësinë e saj: Drejtorinë e Bashkimit Evropian, Drejtorinë për Koordinimin e Programeve IPA Kombëtare dhe Rajonale, si dhe Drejtorinë për Bashkëpunim Territorial

Afati: Brenda tremujorit të ardhshëm



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Gjetje nr.24: Referuar sa na është vënë në dispozicion nga MEPJ, në vijim të disa kërkesave të përsëritura të Grupit të Auditimit, për periudhën objekt auditimi, si MIE, si MPJ, ashtu edhe MEPJ nuk na rezulton të kenë pasur rregullore për organizimin dhe funksionimin e tyre të brendshëm. Mungesa e një akti rregullator të brendshëm, sikurse rregullorja mbi funksionimin dhe organizimin e MEPJ, është në shkelje të ligjit. Neni 29 e Ligjit 90/2012 parashikon: “Rregulloret e brendshme”

1. Këshilli i Ministrave miraton rregullore brenda kuadrit të legjislacionit të përgjithshëm përkatës, për standardet e përbashkëta të menaxhimit në institucionet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore, procedurat e punës dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive administrative dhe institucionet e administratës shtetërore.

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

3. Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme. Sipas dispozitave kalimtare të ligjit, rregullorja duhej të ishte miratuar brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra maksimumi në 2014.

Rekomandimi nr. 24: Miratimin nga MEPJ të rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm.

Afati: Brenda gjashtëmuajorit të ardhshëm

Gjetje nr. 25: MEPJ (dhe ish-MIE) nuk konstatohet të ketë mbështetur NJQV në përcaktimin e fushave, prioritetëve dhe/ose çështjeve ku duhet të orientohet kërkesa e tyre për asistencën e Bashkimit Evropian, në kundërshtim me VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, pika 3, germa c.

Rekomandimi nr. 25: Nga Ministri dhe Drejtoria e BE në MEPJ, në bashkëpunim me AMVV dhe Ministrinë e Brendshme, të merren masat detyruese ndaj NJQV për ngritjen e strukturave të NJIE brenda strukturave të tyre administrative ekzistuese.

Afati: Brenda datës 31.12.2021

Gjetje nr. 26: Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion rreth Bashkimit Evropian dhe procesit të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit në BE. Nisur nga numri i lartë i azilkërkuësve shqiptarë në Evropë gjatë viteve të fundit dhe migracionit të paligjshëm, si dhe ngritjes së problematikës në instancat më të larta të Bashkimit Evropian si një nga kushtet që vendi duhet të plotësojë me qëllim çeljen e negociatave, në asnjë nga faqet zyrtare të këtyre bashkive nuk është publikuar informacion në lidhje me këtë proces, duke u vënë theksi tek penalizimet e këtij fenomeni.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, informacion në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së (IPA etj.). Konkretisht qytetarët e Shkodrës dhe Vlorës, nuk kanë mundësi të informohen në lidhje me programet e ndryshme të financimit të BE-së dhe procedurat që duhet të ndjekin për aplikimin për këto programe, përveç paraqitjes pranë zyrave të Njësive të Integritetit të bashkive respektive.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUdhËN nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

- Informacioni i publikuar nga bashkitë Vlorë dhe Shkodër, nuk ka formë dhe përmbajtje të unifikuar, në kundërshtim me pikën 2/ë, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Rekomandimi nr. 26: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, me informacionin e plotë rreth proceseve integruese të Shqipërisë në BE, programet e ndryshme të financimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit, si dhe marrjen e masave që ky informacion të jetë në formë dhe përmbajtje të unifikuar me Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore.

Afati: Brenda datës 30.09.2021

Gjetje nr.27: Këndi i BE i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe Bashkisë Vlorë, nuk është në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për projektin “Bashkitë për në Evropë”, si dhe me pikën 2/e, të VKM nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë nuk kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës së bashkive, lidhur me procesin e integritetit evropian.

- Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vlorë janë shprehur se kryejnë plotësimin e matricës së Vlerësimit të Performancës së Bashkive në mënyrë periodike, por në faqe zyrtare të këtyre bashkive, nuk u gjet asnjë publikim në lidhje me këto raporte.

Rekomandimi nr. 27.1: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për plotësimin e Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës i Bashkisë Vlorë, lidhur me procesin e integritetit evropian.

Rekomandimi nr. 28.1: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Njësia e Integritetit Evropian, të marrin masa për publikimin në Këndit të BE-së të faqes zyrtare të Bashkisë Vlorë, të informacionit të plotë në lidhje me aktivitetet zhvilluara nga Bashkia Vlorë për proceset integruese të Shqipërisë.

Afati: Brenda datës 30.12.2021

Gjetje nr. 29: MEPJ nuk ka publikuar një kalendar të plotë të trajnimeve që parashikon të kryejë.

-Bashkia Vlorë nuk ka organizuar dhe marrë pjesë në trajnime të kryera për proceset e integruese të Shqipërisë në BE.

Rekomandimi nr. 29.1: MEPJ në fund të çdo viti të kryejë publikimin e listës së aktiviteteve trajnuese që parashikon të kryejë gjatë vitit, si dhe të marrë masa për vënien në dijeni të NJQV për këto trajnime.

Rekomandimi nr. 30.1: MEPJ të marrë masa që për trajnimet që parashikon të kryejë, të marrë në konsideratë edhe nevojat konkrete të NJQV.

Afati: Brenda datës 31.12.2021 dhe në vijimësi

Gjetje nr. 31: Bashkitë Shkodër dhe Vlorë, me gjithë mangësitë e konstatuara, nuk rezulton ti jenë drejtuar MEPJ për informim dhe asistencë në lidhje me proceset integruese.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Rekomandimi nr. 31.1: MEPJ në bashkëpunim me AMVV, të marrë masa për vendosjen e urave të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe NJQV, me qëllim mbështetjen, koordinimin dhe monitorimin forcimin e kapaciteteve të bashkive për përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian të Shqipërisë.

Afati: Brenda datës 31.12.2021 dhe në vijimësi

Gjetje nr. 32: Mungesa e informacionit për NJQV-të mbi partnerët e suksesshëm, sikurse dhe mungesa e informacionit nga ana e MEPJ-së mbi arsyet e mosuksesit të NJQV-ve në aplikimet për projekte IPA, është tregues i një komunikimi jo efektiv dhe mosangazhimi në nivelin e duhur nga ana e MEPJ-së.

Rekomandimi nr. 32.1: MEPJ të sigurojë vënien në dispozicion të aplikantëve për projekte IPA, për çdo program, të një baze të dhënash mbi partnerët e mundshëm.

Rekomandimi nr. 33.1: MEPJ të kërkojë dhe sigurojë informacion periodik dhe të përditësuar nga Sekretariatet Teknike të Programeve dhe bashkitë, lidhur me ecurinë e pjesëmarrjes së NJQV-ve në aplikime dhe zbatime projektsh IPA.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr. 34: Mbulimi i kuotës së bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit do të ndikonte pozitivisht në performancën e partnerëve shqiptarë dhe do të rriste përqindjen e përthithjes së donacionit të BE. Kjo gjë aktualisht nuk bëhet.

Rekomandimi nr. 34.1: KKIPA të insistojë në të gjitha nivelet e diskutimit dhe të vendimmarrjes për miratimin e një akti normativ, i cili parashikon mbulimin e kostos së bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit.

Afati: Deri në fund të vitit

Gjetje nr. 35: Procedura aktuale e rimbursimit të TVSH ka rezultuar mjaft problematike dhe janë shumë të pakta rastet kur ajo i rikthehet zbatuesit të projektit, pavarësisht legjislacionit në fuqi, dhe specifikisht Ligjit 37/2015, Neni 28, pika 2. Në germën c, të këtij neni dhe pike, thuhet: “Përjashtimi i parashikuar në paragrafin “b” fiton efektet e kryhet parimisht, me përjashtim “ex ante”. Kur kjo është teknikisht dhe/ose praktikisht e pamundur, përjashtimi kryhet përmes rimbursimit/zbritjes së shumave”. Ndaj ajo që kërkohet, për këtë problem, është vetëm një respektim aktesh normative në fuqi (sipas kriterit të rangut të burimeve të së drejtës) dhe jo një zgjidhje mbi bazën e kriterëve të tjera (politike, sociale, etj.).

Rekomandimi nr. 35: KKIPA të ushtrojë gjithë autoritetin e tij, duke kërkuar nga MFE-së zbatimin rigoroz të Ligjit 37/2015 (neni 28, pika 2), i cili parashikon edhe përjashtimin paraprakisht nga TVSH (në germën b) të çdo prokurimi/shpenzimi që bëhet në kuadër të projekteve të financuara nga BE, nëpërmjet pajisjes me një certifikatë specifike nga Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje nr. 36: Paqartësia lidhur se me cilin sistem rregullash duhet të bëhen prokurimet nga përfituesit e fondeve IPA, rrit pasigurinë e tyre lidhur me ligjshmërinë e aktivitetit financiar që zhvillojnë. Nga ana tjetër, problemin e njohur dhe te pranuar edhe nga ana e MEPJ, mbi konfuzionin e krijuar nga dyzimi i mësipërm, asnjëra nga bashkitë, nuk arriti t’a dokumentojë me një rast konkret

Rekomandimi nr. 36.1: KKIPA të ushtrojë gjithë autoritetin e tij dhe së bashku me MFE-në të angazhohen për të qartësuar pashmangshmërinë e ndjekjes së Rregullores PRAG, nga të gjithë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

përfituesit e fondeve IPA, si dhe të informojnë të gjitha agjencitë e auditimit për këtë kriter normativ, duke garantuar kështu unifikimin e praktikave, si në zbatimin e programeve, ashtu dhe në auditimin e tyre.

Rekomandimi nr. 37.1: KKIPA të garantojë përkthimin në shqip të rregullave PRAG për të mundësuar sigurinë e njohjes të këtyre rregullave, në shërbim të aktiviteteve audituese.

Afati: Në vijimësi

Gjetje nr. 38: Mungesa e një politike mbajtjeje stafi, për strukturat e menaxhimit dhe koordinimit IPA pranë NJQV-ve ndikon në uljen e kapaciteteve profesionale pranë tyre, duke krijuar situata vështirësie dhe pamundësie për hartimin dhe zbatimin e projekteve IPA.

Rekomandimi nr. 38: Bashkia Vlorë të konsolidojë arkivin e aktivitetit që zhvillon në kuadër të pjesëmarrjes në programet IPA.

Afati: Brenda tremujorit

Rekomandimi nr. 39.1: MEPJ në konsultim të ngushtë me MFE-në, të asistojnë DAP-in në hartimin e një dokumenti dedikuar politikave të mbajtjes së stafit të strukturave të menaxhimit dhe koordinimit të IPA-ve, si dhe KKIPA njëkohësisht, të ushtrojë gjithë autoritetin e tij dhe të insistojë në të gjitha nivelet e diskutimit dhe të vendimmarrjes, me objektiv miratimin e këtij dokumenti nëpërmjet një akti normativ nga Këshilli i Ministrave.

Afati: Deri në fund të vitit

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

ANEKSE

Aneksi 1
Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : **“Mbi ndotjen e menjëhershme të Jonit dhe Adriatikut”**

Në 000/lekë

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		N r.	Vlera lekë	N r.	Vlera	N r.	Vlera	Nr .	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										N r.	Vlera	N r.	Vlera	N r.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	N r.	Vlera	N r.	Vlera
1	Masa organizative	9	-	8	-	1	-	89 %	-	1	-	0	-	5	-	-	-	2	-	-	-
2	Masa shpërblimdëmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Masa për eliminimin e paligjshmërive ..	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Për eliminimin e efekteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		9	-	8	-	1	-	89 %	-	1	-	0	-	5	-	-	-	2	-	-	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Aneksi 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : **“Mbi Efektivitetin e Politikave në Lëvizjen Migratore”**

Në 000/lekë

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuar											
		Nr.	Vlerë në lekë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	Masa organizative	23	-	20	-	3	-	87 %	-	2	-	-	-	18	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Për eliminimin e efekteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		23	-	20	-	3	-	87 %	-	2	-	-	-	18	-	-	-	-	-	-	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Aneksi 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : **“Mbi Eficiencën e Energjisë”**

Në 000/lekë

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimi		Statusi i rekomandimeve të pranuara											
		N r.	Vlerë a lekë	N r.	Vlerë ra	N r.	Vlerë ra	Nr.	Vlerë ra	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										N r.	Vlerë ra	Nr.	Vlerë a	N r.	Vlerë ra	Arkëtuar	Mbjetja	N r.	Vlerë ra	N r.	Vlerë ra
1	Masa organizative	42	-	42	-	-	-	100 %	-	9	-	-	-	13	-	-	-	20	-	-	-
2	Masa shpërblimëdëni	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4	Për eliminimin e efekteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
5	Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
6	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
TOTALI		42	-	42	-	-	-	100 %	-	9	-	-	-	13	-	-	-	20	-	-	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN NGA 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Aneksi 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë: “Efektiviteti i Procesit të Deinstitutionalizimit dhe Decentralizimit të Shërbimeve Shoqërore me Fokus Fëmijët Jetim”

Në 000/lekë

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr	Vler a lekë	N r	Vle ra	N r	Vle ra	Nr.	Vle ra	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										N r.	Vle ra	Nr.	Vler a	N r.	Vle ra	Arkët uar	Mbe tja	N r.	Vle ra	N r.	Vle ra
1	Masa përmirësim ligjor	4	-	4	-	-	-	100 %	-					2				2			-
2	Masa organizative	15	-	15	-	-	-	100 %	-	8				7							-
TOTALI		19	-	19	-	-	-	100 %	-	8	-	-	-	9	-	-	-	2	-	-	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR PERIUDHËN Nga 30.06.2020
DERI NË 31.12.2020”

Aneksi 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë: **“Efektiviteti i Koordinimit Ndërinstitucional në Kuadër të Procesit të Integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për Periudhën 2016-2019”**

Në 000/lekë

N r.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuar											
		N r.	Vlerat e lekë	N r.	Vlerat	N r.	Vlerat	Nr.	Vlerat	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										N r.	Vlerat	Nr.	Vlerat	N r.	Vlerat	Arkëtuar	Mbjetja	N r.	Vlerat	N r.	Vlerat
1	Masa organizative	53	-	53	-	-	-	100%	-	14	-	16	-	7	-	-	-	16	-	-	-
2	Masa shpërblimëdmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Për eliminimin e efekteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		53	-	53	-	-	-	100%	-	14	-	16	-	7	-	-	-	16	-	-	-